

ROLI I INSTITUCIONEVE EDUKATIVE-ARSIMORE FORMALE DHE JO FORMALE NË SHOQËRINË E GLOBALIZIMIT

Nazyktere Hasani

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Fakultetin e Shkencave Sociale, me profil Psikologji –Pedagogji, për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Edi Puka

Numri i fjalëve: 60406

Tiranë, Dhjetor 2017

Deklaratë statutore

Unë, kandidatja Nazyktere Hasani deklaroj me përgjegjësi të plotë, se i gjithë informacioni në këtë material është marrë dhe paraqitur në përputhje me rregullat akademike dhe etike, sipas udhëzimeve të Universitetit Europian të Tiranës. Të gjitha citimet u përmbahen kërkesave dhe rregullave për mbrojtjen e doktoraturës.

Nënshkrimi _____

DEDIKIM

Prindërve të ndjerë

Me dashuri të pafundme !

FALËNDERIME

Dëshiroj të falënderoj të gjithë ata që më kanë mbështetur gjatë këtij rrugëtimi, duke më dhënë mundësinë që të arrij të konkretizoj përpjekjet e mia.

Në radhë të parë, dëshiroj të falënderoj udhëheqësin tim shkencor, Prof. Asoc. Dr. Edi Puka, për besimin dhe këshillat e vyera që më ka dhënë përgjatë kësaj pune.

Falënderoj të gjithë ata që ma bënë më të lehtë punën në terren. Në mënyrë të veçantë falënderoj të gjithë nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit e nxënësve të shkollave të mesme, të qytetit të Gjilanit dhe Preshevës, të cilët u bënë pjesmarrës në studim.

Një falënderim i veçantë, gjithashtu, të gjithë koordinatorëve të institucioneve joformale të cilët me gatishmërinë e tyre më ndihmuan në relizimin e intervistave.

Në mënyrë të veçantë falënderoj zotin Besnik Skënderin për ndihmën e tij në përpunimin statistikortë të dhënave.

E falënderoj pa masë familjen time, bashkëshortin Ramadanin, vajzat Ernesën, Elonën , Etritën dhe djalin Ergestin të cilët më mbështetën , përkrahën dhe motivuan gjatë viteve të ndjekjes së studimeve doktorale.

Faleminderit !

ABSTRAKTI

Ky studim eksploron mundësitë dhe perspektivat e ndërveprimit ndërmjet edukimit formal me atë joformal në shkollat e mesme të Kosovës. Studimi ndihmon nxënësit që të diversifikojnë mënyrat e përfitimit të dijeve dhe aftësive praktike e që të fitojnë, të ndërtojnë dhe zhvillojnë kompetencat qytetare në kushtet e globalizimit. Nëpërmjet studimit përcaktohen dhe analizohen efektet, të cilat janë produkt i ndërthurjes së edukimit formal me atë joformal. Studimi analizohen trajtimin e tyre në sinkron për promovimin e aftësive të zhvillimit qytetar në aspektet akademike, individuale, sociale dhe profesionale. Në studim vihet theksi tek karakteristikat dhe të përbashkëtat, midis qasjeve të edukimit në procesin mësimor. Nëpërmjet zbatimit të qasjes së kërkimit të kombinuar, ofrohet një dizajn i hulumtimit të elementeve të kërkimit sasior dhe cilësor, duke përdorur teknika statistikore për mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Studimi zbulon se ekziston një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme ndërmjet arsimit formal dhe joformal në performancën akademike dhe qytetare të nxënësve. Edukimi joformal realizohet nëpërmjet përcaktimit të strategjive efikase, të cilat zbatohen në shkollë, kryesisht në klasë, me qasjet dhe hapësirat që ofrojnë mjediset e të nxënit bashkëkohor. Rekomandimet përcaktojnë nevojën për të fuqizuar shkollat, agjencitë e specializuara dhe OJF me qëllim rritjen e efikasitetit të edukimit formal dhe joformal. Rezultatet e punimit i adresohen niveleve të ndryshme të politikbërjes, të cilat i kushtojnë rëndësi performancës qytetare të nxënësve.

Fjalët kyçe: Edukim formal, edukim joformal, të nxënit gjatë gjithë jetës, edukim qytetar

ABSTRACT

This research examines the opportunities and prospects of interaction of formal education with non-formal schools of Kosovo. The research help students to diversify ways of gaining knowledge and practical skills to acquire, build and develop civic competencies for life in conditions of globalization. Through the research determined and analyzed the effects, which are the product of the combination of formal education with non-formal, synchronous treating them to promote civic skills development in academic aspects of individual, social and professional. The research put the emphasis on the characteristics and commonalities between education approaches in educational process. Through the use of the combined approach, it is offered a research design with elements of quantitative and qualitative research, using statistical techniques for collection and analysis of data. The study reveals that there is a significant relationship between formal education and non-formal academic performance of students. Non formal education of young people is realized through efficient setting strategies, which are implemented in the school and in the classroom mainly, approaches and areas that can provide modern learning environments. Provided recommendations focused the need to strengthen not only the schools, but also the specialized agencies, and NGOs to increase the effectiveness of formal and non-formal education. The results of the research are addressed to governments, which pay attention to students' civic performance.

Key Words: Formal education, Non-formal Education, lifelong learning, civic education

Në deklaratën e Këshillit të Evropës nënvizohet se: “... sistemet arsimore formale të vetme nuk mund t’u përgjigjen sfidave të shoqërisë moderne dhe për këtë arsye përshëndet përforcimin nga praktikat joformale arsimore. Asambleja rekomandon që qeveritë dhe autoritetet përkatëse të vendeve anëtare të njohin arsimin joformal si një partner *de facto* në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ta bëjnë të arritshme për të gjithë. (Këshilli i Evropës, 2000, në Kamil, M, 2007, f. 2).



PËRMBAJTJA E LËNDËS

Abstrakti	v
Abstract	vi
KAPITULLI I: HYRJE	1
1.1 Përshkrimi i studimit	1
1.2 Objektivat e studimit	9
1.3 Variablat e studimit	9
1.4 Rëndësia e studimit	11
1.5 Struktura e punimit	12
II. SHQYRTIMI I LITERATURËS	17
2.1. Përkufizimi i edukimit formal dhe joformal	17
2.2. Shekulli XX –XXI dhe risitë e edukimit	18
2.3. Zbatimi i elementeve të edukimit joformal në atë formal	27
2.4. Kompetencat kyçe në zhvillimin profesional dhe edukimin gjatë tërë jetës	32
2.5. Gërshetimi i tre formave të edukimit	37
2.6. Karakteristikat e të mësuarit formal dhe jo formal	43
2.7. Institucionet edukativo-arsimore formale dhe joformale	51
2.8. Globalizimi i edukimit dhe arsimit i mesëm në Kosovë	53
2.9. Arsimit dhe edukimit i mesëm në Republikën e Serbisë	63
KAPITULLI I III : METODOLOGJIA E STUDIMIT	66
3.1. Parashtrimi i problemit	66
3.2. Hipotezat e studimit	67
3.3. Pyetjet kërkimore	68
3.4. Metodatat e hulumtimit	69
3.5. Pilotimi i pyetësorëve	73
3.6. Mbledhja e të dhënave	74
3.7. Instrumentet e hulumtimit	75

3.8. Popullata dhe kampioni	96
3.9. Besueshmëria dhe vlefshmëria e kërkimit	113
3.10. Kufizimet e studimit	113
3.11. Çështje etike	115
KAPITULLI IV: ANALIZA E TË DHËNAVE	121
4.1. Analiza statistikore e të dhënave sasiore	125
4.2 Rezultatet e analizës cilësore	204
KAPITULLI V: DISKUTIME	214
5.1. Diskutimet e studimit në lidhje me dallimet statistikore të qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve në varësi të variablave të varur.	214
5.2. Diskutimet në lidhje me marrëdhënien ndërmjet variablave në vlerësimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve	218
5.3. Analiza përgjithësuese	221
KAPITULLI VI: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	224
6.1 . Përfundime	224
6.2 Rekomandime	226
BIBLIOGRAFIA	229
ANEKSE	246

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Pasqyra e tetë kompetencave kyçe dhe përkufizimi i tyre.	33
Tabela 2.- Karakteristikat e edukimit formal dhe joformal.....	43
Tabela 3: Karakteristikat e tri formave të mësuarit.....	46
Tabela 4. Karakteristikat e edukimit formal dhe jo formal sipas Simkins, 1977	48
Tabela 5. Koeficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i nxënësve të qytetit të Gjilanit.....	82
Tabela 6. Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i nxënësve të qytetit të Gjilanit82	
Tabela 7. Koeficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i nxënësve të qytetit të Preshevës	83
Tabela 8. Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i nxënësve të qytetit të Preshevës	84
Tabela 9. Koeficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i mësimit nxënësve të qytetit të Gjilanit.....	88
Tabela 10. Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i mësimit nxënësve të qytetit të Gjilanit.....	89
Tabela 11. Koeficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i mësimit nxënësve të qytetit të Preshevës.....	89
Tabela 12. Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i mësimit nxënësve të qytetit të Preshevës	90
Tabela 13. Koeficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i prindërve të qytetit të Gjilanit.....	93
Tabela 14: Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i prindërve të qytetit të Gjilanit	94
Tabela 15: Koeficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i prindërve të qytetit të Preshevës	94
Tabela 16: Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i prindërve të qytetit të Preshevës	95
Tabela 17: Të dhënat e përgjithshme të nxënësve që morën pjesë në studim sipas llojit të shkollës.....	97

Tabela 18: Pjesëmarrja e nxënësve në studim, përkatësia sipas qyteteve	98
Tabela 19: Pjesëmarrja e nxënësve në studim, përkatësia sipas gjinisë	98
Tabela 20: Të dhënat e përgjithshme të mësimdhënësve sipas institucionit	99
Tabela 21: Të dhënat e përgjithshme të mësimdhënësve sipas vendndodhjes	100
Tabela 22: Të dhënat e përgjithshme të mësimdhënësve sipas dikotomisë gjinore	101
Tabela 23: Statistikat përshkruese të mësimdhënësve pjesëmarrës në hulumtim sipas institucionit, vendit dhe gjinisë	101
Tabela 24: Të dhënat e përgjithshme të mësimdhënësve- eksperiencë pune	102
Tabela 25: Vitet e punës së mësimdhënësve pjesëmarrës	104
Tabela 26: Statistikat përshkruese të prindërve pjesëmarrës në hulumtim sipas institucionit, vendit dhe gjinisë	105
Tabela 27: Të dhënat e përgjithshme të prindërve pjesëmarrës në hulumtim sipas llojit të shkollës	105
Tabela 28: Të dhënat e prindërve sipas vendit, qytetit që përfaqësojnë	106
Tabela 29: Të dhënat e prindërve pjesëmarrës në hulumtim sipas gjinisë	107
Tabela 30: Të intervistuarit sipas përfaqësimit të tyre në institucionet joformale	108
Tabela 31: Mesataret, devijimet standarde dhe variancat e qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve në 6 variablat	126
Tabela 32: Vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard të variablit të parë	128
Tabela 33: Paraqitja e mesatares dhe devijimit standard të variablit të dytë	129
Tabela 34: Vlera e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për variablin e tretë	130
Tabela 35: Vlerat e mesatareve dhe devijimit standard për variablin e katërt	131
Tabela 36: Vlerat e mesatareve aritmetike dhe devijimit standard të variablit të pestë	132
Tabela 37: Vlerat e mesatareve aritmetike dhe devijimit standard të variablit të gjashtë .	133
Tabela 38: Vlerat e shtuara të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të nxënësve për të gjitha variablat	135
Tabela 39: Vlerat e mesatares dhe devijimit standard të variablit një të mësimdhënësve	136
Tabela 40: Vlerat e mesatareve dhe devijimit standard për variablin dy të mësimdhënësve	137

Tabela 41: Vlerat e mesatareve dhe devijimit standard për variablin e tretë të mësimdhënësve	138
Tabela 42: Vlerat e mesatareve dhe devijimit standard për variablin e katërt të mësimdhënësve	139
Tabela 43: Vlera e mesatareve dhe devijimit standard të variablit të pestë të mësimdhënësve	140
Tabela 44: Vlera e mesatares dhe devijimit standard për FA6 të mësimdhënësve	142
Tabela 45: Vlerat e shtuara të mesatareve të qëndrimeve të mësimdhënësve për të gjitha variablat	144
Tabela 46: Vlera e mesatareve aritmetike dhe devijimit standard në qëndrimet e prindërve dhe FA1	146
Tabela 47: Vlera e mesatares dhe devijimit standard për variablin dy të prindërve	147
Tabela 48: Vlera e mesatareve dhe devijimit standard për variablin e tretë për prindër...	148
Tabela 49: Vlera e mesatareve dhe devijimit standard për variablin katër të prindërve ...	148
Tabela 50: Vlera e mesatareve dhe devijimit standard për variablin e pestë për prindër..	150
Tabela 51: Vlera e mesatares dhe devijimit standard për variablin e gjashtë për prindër.	151
Tabela 52: Vlerat e shtuara të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të prindërve për të gjitha variablat	153
Tabela 53: Vlerat e koeficientit të korelacionit ndërmjet variablave të nxënësve të Gjilanit	155
Tabela 54: Vlerat e koeficientit të korelacionit ndërmjet faktorëve të nxënësve të Preshevës	157
Tabela 55: Vlerat e koeficientit të korelacionit ndërmjet variablave të mësimdhënësve të Gjilanit	162
Tabela 56: Vlerat e koeficientit të korelacionit ndërmjet variablave të mësimdhënësve të Preshevës	164
Tabela 57: Vlerat e koeficientit të korelacionit ndërmjet faktorëve në qëndrimet e prindërve të Gjilanit	169
Tabela 58: Vlerat e koeficientit të korelacionit ndërmjet variablave në qëndrimet e prindërve të Preshevës	171
Tabela 59: Vlerat e testit Chi-Square për lidhjen gjinore të mësimdhënësve dhe FA1	176

Tabela 60: Vlerat e testit Chi-Square për lidhjen gjinore të mësimdhënësve dhe FA2	177
Tabela 61: Vlerat e Chi-Square për marrëdhënien gjinore të mësimdhënësve dhe FA3 ..	179
Tabela 62: Vlerat e Chi-Square për marrëdhënien gjinore të mësimdhënësve dhe FA4 ..	180
Tabela 63: Vlerat e Chi-Square për marrëdhënien gjinore të mësimdhënësve dhe FA5 ..	181
Tabela 64: Vlerat e Chi-Square në marrëdhënien gjinore të mësimdhënësve dhe FA6....	183
Tabela 65: Vlerat e Chi -Square për lidhjen e eksperiencës në punë të mësimdhënësve dhe FA1	185
Tabela 66: Vlerat e Chi-Square për lidhjen e eksperiencës në punë të mësimdhënësve dhe FA2.....	185
Tabela 67: Vlerat e Chi-square për lidhjen e eksperiencës në punë të mësimdhënësve dhe FA3	186
Tabela 68: Vlerat e Chi- Square për lidhjen e eksperiencës në punë të mësimdhënësve dhe FA4.....	187
Tabela 69: Vlerat e Chi- Square për lidhjen eksperiencë në punë të mësimdhënësve dhe FA5	188
Tabela 70: Vlerat e Chi-Square për lidhjen e eksperiencës në punë të mësimdhënësve dhe FA6.....	189
Tabela 71: Vlerat e Chi- Square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA1	191
Tabela 72: Vlerat e Chi-Square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA2	192
Tabela 73: Vlerat e Chi-Square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA3	193
Tabela 74: Vlerat e Chi-Square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA4	195
Tabela 75: Vlerat e Chi- Square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA5	196
Tabela 76: Vlerat e Chi-square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA6	197
Tabela 77: Vlerat e mesatareve aritmetike , devijimeve standarde dhe koeficientëve të korelacionit në lidhje me gjininë e mësimdhënësve dhe variablae	201
Tabela 78: Vlerat e mesatareve, devijimeve standarde dhe korelacionit në lidhje me gjininë e prindërve dhe variablae	203

LISTA E SHKURTIMEVE

CEC	Commission of the European Communities
KMKE	Komiteti i ministrave të Këshillit të Evropës
UNDP	United Nations Development Programme
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNESCO	United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization
OECD	Organization for Economic Co-operation and Development
BE	Bashkimi Evropian
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
AJF	Arsim Joformal
EJF	Edukim Joformal
EF	Edukim Formal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
LALRK	Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës
RZSRS	Republiçki Zavod za Statistiku Republike Srbije
ERISRS	Enti Republikan i Statistikave të Republikës së Serbisë
SPSS 20	Paketa Statistikore për Shkencat Sociale / varianti 20
FA	Faktori

KAPITULLI I: HYRJE

“Arsimi është arma më e fuqishme të cilën ju mund ta përdorni për të ndryshuar botën”

Nelson Mandela

1.1 Përshkrimi i studimit

Arsimi është një e drejtë e njeriut dhe një instrument i domosdoshëm që individi të realizojë veten, duke qenë edhe një qytetar aktiv në shoqëri. Arsimiti realizohet si një proces që ka një fillim dhe vazhdim. Ai përbën një cikël të pandërprerë, që realizohet nga lindja e gjatë gjithë jetës nëpërmjet tre proceseve kryesore arsimore: (1) arsimi formal, (2) joformal dhe (3) in-formal. Ai u është përshtatur zhvillimeve globale dhe shpie në përfitim të njohurive dhe shkathtësive si dhe luan një rol vendimtar në zhvillimin intelektual, profesional dhe qytetar të individit.

“Arsimi paraqet vlerën e brendshme, e cila u mundëson individëve të realizojnë potencialet e tyre të plota në të gjitha sferat e jetës. Ai ka një rol vendimtar në zhvillimin e tyre intelektual, moral, shoqëror, kreativ dhe fizik, si dhe promovimin e vlerave themelore shoqërore dhe qytetare ...” (Council of the European Union, 2009).

Disa studiues vinë në përfundim se: “Arsimi në funksion të pëparimit të njohurive dhe shkathtësive është i organizuar dhe strukturuar, ... Ai luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e secilit individ, sepse sot njerëzit janë elementë themelor të ndryshimeve” (Kovacević, 2012 :11).

Shumë studiues arsimin e përkufizojnë si një proces dinamik në të cilin ndodh “ formim i njohurive, shkathtësive dhe shprehive, zhvillim i aftësive të individit, formim i sistemit të vlerave dhe rregullave të sjelljes” (Gvozdenović, 2011 :83).

Gjithashtu, arsimin e përkufizojnë si një proces gjatë të cilit arrihen dhe përvetësohen njohuri, shkathtësi dhe aftësi të ndryshme të nevojshme për jetë.

” Ky është një proces pedagogjik e didaktik i menduar ,..... me të cilin individi përvetëson njohuri të përgjithshme dhe të veçanta mbi botën e cila e rrethon, dhe aty zhvillon aftësi intelektuale, zotësi dhe shprehje sociale e praktike, duke formuar një pamje të veten ndaj botës”(Mikanović, 2014:389)

Pastuović, në librin e tij “Arsimi dhe zhvillimi” thekson se arsimi është “ të mësuarit e njohurive dhe shkathtësive psikometrike të organizuara e zhvillim i këtyre aftësive me ndihmën e të cilave zhvillohet të mësuarit e tyre(Pastuović, 2012 :26)”.

Gjithashtu, shumë studiues e vënë theksin në ndikimin e arsimit në motivim”...arsimi ndikon në motivimin për sjellje të caktuar, përmirëson aftësinë e individit për të udhëhequr me sukses disa aktivitete dhe rrit saktësinë e vlerësimit të tij mbi atë se a do të marrë shpërblim për rezultatin e caktuar”(Pastuović, 2012 :133)

Kështu arsimi në vetvete përmban të mësuarit si një proces në zhvillim, ku individi përfiton dije, duke filluar nga njohuritë dhe përvojat fillestare, duke synuar në përsosmërinë e njohurive dhe përvojave për t’ju përgjigjur zhvillimit të individit në mjedise hapësinore dhe intervale kohore të ndryshme.

Të mësuarit është një veprimtari që e ka shoqëruar njerëzimin gjatë gjithë historisë së tij. Njerëzit mësojnë në forma të ndryshme gjatë gjithë jetës. Krahas të mësuarit në institucionin e shkollës, janë ndjekur edhe format e tjera të të mësuarit; si të mësuarit jo formal dhe informal. Njerëzit mësojnë vazhdimisht, kudo dhe në çdo kohë, që prej lindjes, proces që vazhdon gjatë gjithë jetës. Çdo ditë fitojnë njohuri, përvoja dhe aftësi, kompetenca për jetën. Individët mësojnë në shkollë dhe në jetë. Ata trajnohen nëpër kurse për t’u përshtatur në situata dhe ambiente të ndryshme.

Të mësuarit zhvillohet në shtëpi, në vendin e punës, në vende të tjera, prandaj është e rëndësishme dhe domethënëse, që të përsosen mënyrat e të mësuarit, metodat, të përshtatet

të mësuarit formal zyrtar, kurrikular me atë joformal, që përftohet me mënyra të larmishme, për synime të ndryshme.

Studimi i kësaj dukurie sociale ka tërhequr vëmendjen e autorëve dhe subjekteve të interesuara, që në lashtësi. Kjo vërtetohet edhe nga shqyrtimi i evoluimit të mendimit teorik mbi të mësuarit dhe pasurimin e tij me ide e përvoja të reja. Për rëndësinë që ka pasur dhe ka të mësuarit për jetën e individit dhe të shoqërisë njerëzimi ka shtruar një mori pyetjesh, sikurse janë edhe pyetjet se çfarë është të mësuarit dhe si realizohet? Natyrisht që nuk ka përgjigje të prera për këto pyetje. Ato kanë qenë në fokus të njerëzimit, të politikave, filozofive dhe teorive arsimore.

Po ashtu, ka pasur mendime dhe debate edhe për format e të mësuarit, për trajtimin dhe efikasitetin e tyre, cila prej tyre paraqet qasjen konceptuale dhe praktike më të mirë për të mësuar? Çdo teori, politikë arsimore, institucion arsimor dhe joarsimor ofron një pikëvështrim për procesin mësimor dhe si e tillë ajo nuk mund të jetë e përsosur dhe e vetmja.

Peter Lauritzen në intervistën e tij në lidhje me njohjen e edukimit joformal në Evropë thekson se “të mësuarit duhet të posedojë tre komponentë : (1) zhvillim personal; (2) përsosje profesionale ; (3) shkathtësi jetësore dhe qytetari aktive”(Grupa “Hajde Da...,2005 :22).

Ndërkohë që të mësuarit është një çështje komplekse me shumë faktorë dhe aktorë dhe që del jashtë mureve të shkollës, si një proces që vazhdon për gjatë gjithë jetës. Studiuesit e çështjeve arsimore vijnë në një konceptim të përbashkët, sipas të cilit të mësuarit është një ndryshim relativisht i përhershëm në kapacitetin e një individi për të bërë diçka, që nuk e bënte më parë.

Teoricientët e trajtojnë të mësuarit si një ndryshim të qëndrueshëm që ndodh në njohuritë dhe sjelljet e individëve në rrethana të caktuara, si një proces që fillimisht zhvillohet në familje, komunitet dhe në institucionin e shkollës dhe që vazhdon për gjatë gjithë jetës në mjedise të ndryshme komunitare, sociale, të punës, etj. “Të mësuarit është procesme të cilin personi ndryshon disa veti të tij me ndihmën e proceseve të tij kognitive dhe të

dëgjuarit.Të mësuarit e qëllimshëm është edukata. Edukata përfshin arsimin dhe edukimin”(Pastuović, 2012: 26).

Të mësuarit është një ndryshim i qëndrueshëm në performancën njerëzore si rezultat i ndërveprimit me mjedisin. Driscoll M.P. (1994) shprehet se të mësuarit përbën një ndryshim permanent në njohuritë apo sjelljet, në sajë të përvojës. Mayer R.E. (1982) shprehet se të mësuarit përbën një ndryshim afatgjatë në sjellje, ose në aftësinë për t'u sjellë në sajë të përvojës.

Ndërkaq, të mësuarit si pjesë e pandashme e ekzistencës sonë, përbën një proces që zgjat për gjatë gjithë jetës, dhe ka evoluar nga koha në kohë, prandaj dhe duhen zbatuar strategjitë, metodat dhe teknikat përkatëse, që zhvillohen në bashkëpunim dhe përtej institucionit të shkollës. “Të mësuarit gjatë tërë jetës nuk e zëvendëson shkollimin tradicional, që në fillim është konsideruar e mundshme, e për shkak të mungesës së shkollimit të dëshirueshëm; përkundrazi është sistem fleksibil i të mësuarit, i cili mundëson zhvillimin e kompetencave gjatë gjithë jetës”(Pastuović,2008:258).

Dave në lidhje me të mësuarit gjatë gjithë jetës thekson se:”Të mësuarit gjatë gjithë jetës kërkon që arsimi të shikoj në totalitetin e tij. Ai përfshin anën formale, joformale dhe informale të arsimit dhe tenton të integrojë dhe artikulojë të gjitha strukturat dhe fazat e arsimit përgjatë dimensionit vertikal dhe horizontal.”(Dave, 1976 : 35-36).

Edukimi për jetën përmban në vetvete disa aspekte të rëndësishme që janë edukimi profesional, qytetar, si individ i aftë për të ndërtuar jetën individuale dhe sociale. Edukimi përmban gjithashtu ndërtimin e jetës familjare dhe përsosjen e saj, për të marrë pjesë aktivisht në shoqëri si qytetar me vlera dhe standarde bashkëkohore.

Gjithashtu edhe shkollat si institucione edukative në shoqërinë e sotme moderne po pësojnë ndryshime rrënjësore në të gjitha aspektet e jetës dhe punës së tyre. Shkolla, që me krijimin e saj si institucion ka misionin e saj për përgatitjen e nxënësve për jetën.

Ky mision nuk mund të realizohet vetëm nga shkolla. Kjo, sepse shkolla është pjesë e shoqërisë dhe shkolla dhe shoqëria ndikojnë duke paraprirë njëra tjetrën. Shkolla, me edukimin e saj i jep bazën burimore njerëzore dhe impulse të reja shoqërisë. Po ashtu, shoqëria, mbi bazën e koncepteve, prirjeve dhe strukturave sociale si familja, politika, ekonomia, drejtësia, shoqëria civile mundëson përshtatjen dhe zhvillimin e shkollës.

Megjithatë “Shkolla duhet tanimë të jetë, sidomos në të ardhmen, në funksion të nevojave të të gjithë pjesëtarëve të një bashkësie shoqërore pa asnjë diskriminim. Ajo duhet të jetë e hapur për të gjithë në kushte të njejta.”(Potkonjak,2009:7)

Sipas Lalović, shkolla bashkëkohore si qëllim të vetin ka që përfitimim e njohurive dhe shkathtësive, të cilat nxënësit i fitojnë gjat shkollimit të tyre të mund të praktikohen për nevojat e tyre. “Qëllimi i shkollës nuk është vetëm dhënia e njohurive, por pritshmëritë që ajo çka mësohet në shkollë do të zbatohet edhe në jetë“(Lalović,2009:41)

Shkolla si institucion edukativ-arsimor ka funksionin e saj në aftësimin e nxënësve në edukim dhe arsimim në mënyrë të vazhdueshme. “Duke pasur parasysh që shkolla nuk është i vetmi institucion përgjegjës për edukim dhe arsimim, sepse edhe faktorët e tjerë (familja, moshatarët, mjetet e komunikimit masiv..) kanë ndikim,...që kjo të realizohet duhet që me përgjegjësi t’i aftësojë të nxënësit për edukim dhe arsimim permanent” (Ninković, 2009:358-359).

Sikurse trajtohet në vijim edukimi shkollor u konsiderua i pamjaftueshëm, pasi jeta është më e gjerë se shkolla dhe se ai duhej lidhur më së miri me të ardhmen e qytetarëve, të cilët do të mund ta zhvillonin atë me efikasitet edhe pas mbarimit të shkollës. Shkolla është në varësi dhe e hapur me shoqërinë, “..lidhja e shkollës me jetën dhe organizimin e jetës shkollore mbi baza shoqërore është në funksion të zhvillimit të nxënësve, të përditësimit të procesit mësimor-edukativ, krijimin e atmosferës për bashkëpunim..”(Murati, 2004:411).

Gjithashtu, arsimi dhe shkolla si mision të vetin ka integrimin dhe ngritjen e vetëdijës për të afirmuar kulturën tek nxënësit.”Roli i shkollës qëndron në konkretizimin e vlerave kulturore dhe në harmonizimin e veprimeve kulturore individuale dhe kolektive”(Murati,2004 :415).

“Shkolla gjithmonë ka pasur, edhe sot ka, tre role themelore. Prej shkollës pritet që fëmijëve t’u jepen njohuri, që të zhvillojë shkathtësi dhe forcojë kapacitetet intelektuale të tyre si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e qëndrimeve dhe vlerave të dëshiruara të shoqërisë” (Lalović, 2009 : 24).

Sipas Mirović, “ Shkolla është forma e parë e institucionalizimit dhe profesionalizimit të edukimit dhe arsimit, si nevojë kryesore e njerëzve me qëllim të bartjes së traditës kulturore nga të vjetrit tek të rinjtë. Megjithatë, globalizimi këtë të drejtë ekskluzive të shkollës e ka bërë të diskutueshme, sepse arsimi zhvillohet edhe jashtë sistemit shkollor” (Mirović, 2010 :20)

Më tej janë përcaktuar edhe format kryesore të mësimi, sikurse janë të mësuarit formal, jo formal dhe informal. Ky lloj të mësuari shfaqet jo vetëm në jetën e përditshme, por e gjejmë të mishëruar edhe në gjithë procesin mësimor-edukativ që zhvillohet në shkollë dhe në jetë. Për edukimin formal dhe joformal evidentohen arritjet dhe barrierat, që lidhen me kuptime alternative të veprimtarisë së plotë mësimore edukative me projeksion jetën e individit dhe shoqërisë. Kjo ka bërë që çështjet e edukimit të mbeten disi prapa zhvillimeve në fushat e tjera. Prandaj, edhe kjo temë u përzgjedh për të qenë objekt i këtij hulumtimi.

Sikurse vë në dukje Harmer (2007) nxënësi merr bazat në shkollë, por kjo nuk mbaron me kaq pasi nxënësi duhet të vetëzhvillohet përmes përpjekjeve të shumta. “Ju mund të më trajtoni, ju mund të më edukoni, por ju nuk mund të më zhvilloni – unë do të zhvillohem vetë.”

Në institucionin e shkollës kryhet të mësuarit e programuar, si nëpërmjet kurrikulës zyrtare ashtu edhe nëpërmjet asaj që nuk mund të programohet, që është kurrikula e fshehtë, pasi merret me mënyra informale gjatë veprimtarisë së përditshme në shkollë dhe jashtë saj.

Nuk mund të themi se vetëm shkollat ka si funksion të saj edukimin dhe arsimimin e të nxënësve. Nxënësit përvetësojnë njohuritë e fituara në shkollë; fitojnë shkathtësi të nevojshme për jetën dhe marrin një edukim që të jenë qytetarë të ndërgjegjshëm dhe me vlera . Pra, edukimi joformal zë një vend të rëndësishëm në plotësimin e edukimit formal.

Kuka (2012) në studimin e tij thekson se “Arsimi paraqet një proces dinamik me të cilin prodhohen dhe sigurohen njohuritë dhe shkathtësitë individuale. Tre format themelore të arsimit në shoqërinë moderne janë: (1) arsimi formal, (2) arsimi joformal dhe, (3) arsimi informal.”

Një numër i madh studiuesish: Fordham (1993), Loewen (2011), Kuka (2012), Marković (2005), Kovačević (2012), Marjanović (2003) , dhe shumë të tjerë në punimet e tyre kanë analizuar përkufizimet mbi arsimin formal dhe joformal. Në mesin e këtyre studiuesve ndoshta ka dallime në përkufizimet e tyre, mirëpo ata janë të mendimit se:

“Derisa arsimi formal është i lidhur rreptësisht me kornizën shkollore dhe institucionin shkollos, i vendosur sipas rregullave juridike të shkruara, planin dhe programin; ai joformal është fleksibil dhe i kundërt, për çka plotëson boshllëkun e arsimit të parë”(Kovacević, 2012 : 21)

Komisioni Evropian (2001) arsimin formal e përkufizon si lloj të arsimit ku” të mësuarit, i cili zhvillohet në institucionin edukativo-arsimor, është i strukturuar sipas qëllimeve, kohës dhe kërkesave të mësuarit, dhe që shpie në çertifikim”

Gjithashtu “arsimi joformal nënkupton procesin e përhershëm, ku secili individ gjatë jetës formon qëndrimet, vlerat dhe njohuritë, duke bartë nga institucionet arsimore dhe burimet në rrethin e vet, si dhe nga përvojat e përditshme: familja, moshatarët, fqinjët, takimet, biblioteka, mediet, puna, loja etj”(Komiteti i ministrave të Këshillit Evropian, 2010).

Gjithashtu, Etllng për dy format e edukimit thekson se “të dy vënë në dukje të mësuarit e organizuar dhe të qëllimshëm. Të dy përfshijnë strukturat, edukatorë profesional dhe zgjedhjet nga ana e nxënësve. Përgjegjësia për mësim është e përbashkët ndërmjet edukatorëve dhe nxënësve”(Etllng. A, 1993:74).

Edukimi i të rinjve të shkollës së mesme me standardet bashkëkohore në kushtet e globalizmit nuk do të ishte i mundur pa ndërthurur aspekte të formimit individual, social dhe profesional.

Si rezultat arritjet apo mosarritjet do të trajtohen në funksion të përmbushjes së këtyre detyrave. “Epoka bashkëkohore e ka karakterizuar arsimin joformal si një ndër nevojat themelore arsimore të njeriut si dhe si plotësues të arsimit formal dhe atij tradicional.... ..është e domosdoshme reforma e tërësishme e sistemit arsimor, respektivisht inkorporimi i edukimit joformal në arsimin formal”(Kovačević, 2012:65).

Punimi ka bazën teorike dhe mbështetet në përvojat në Kosovë dhe më gjerë. Mbështetja teorike bazohet në kulturën, punimet e autorëve të mëdhenj të çështjeve humane, sociale, pedagogjike si edhe në ato të studiuesve dhe autorëve bashkëkohorë. Po ashtu, tashmë është krijuar edhe një përvojë për sa i përket konceptimit dhe trajtimit në sinkron të aspekteve të ndryshme të edukimit, që mundësojnë formësimin qytetar të nxënësve për jetën.

Baza e aksionit të shoqërisë dhe shkollës, si pjesë e rëndësishme e komunitetit është afirmimi i vlerave në rrafshin individual, social dhe profesional për të jetuar mbi bazën e standardeve bashkëkohore, që zhvillojnë në aspektin qytetar individin dhe shoqërinë në të gjitha strukturat sociale dhe në harmoni me njëra tjetrën.

Në kushtet e reja të zhvillimit qytetar, shkolla ka dhe duhet të ketë një strategji të qartë të zhvillimit arsimor, ku ngërthehet problematika e zhvillimit të identitetit social dhe profesional të rinjve, e ku komuniteti, familja, politika, biznesi, feja, shoqëria civile dhe ajo në tërësi bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë plane dhe projekte për zhvillimin qytetar.

Mbi këtë bazë, të fakteve dhe arritjeve konkrete bëhen analiza të ndërthurura në aspektet individuale, sociale, profesionale. Këtë e kërkon logjika shkencore, bazuar në synime, objektiva, hipoteza, gjetje, përfundime dhe rekomandime koherente, të cilat janë rrjedhojë e konceptimit dhe organizimit të veprimeve ndërvepruese në rrafshet e edukimit formal, joformal dhe informal.

Në kuadrin e formimit qytetar, u zhvilluan dhe metodologjitë përkatëse të këtij zhvillimi si dhe ndërthurja e mënyrave dhe teknikave të edukimit formal dhe joformal. Të mësuarit me mënyra dhe teknika bashkëkohore mbetet një angazhim i përhershëm i gjithë faktorëve dhe aktorëve të interesuar për të përgatitur nxënësit mbi sfidat për jetën, ”që mësimdhënësve

dhe presonelit tjetër arsimor, liderëve rinor dhe trajnerëve t'u ofrohen trajnime të domosdoshme fillestare dhe të qëndrueshme dhe zhvillim në fushën e arsimit për qytetari demokratike dhe të drejta të njeriut.”(KMKE, 2010: 16)

Në togfjalëshat *arsimi formal*, *joformal* dhe *informal* përfshihen në termin arsim, ku duhet saktësuar sepse në vendet e tjera termi edukim *educere* (lat.) apo *education* (ang.) përmbledh edhe arsimin edhe edukimin. Pra, si procesin e zhvillimit që nis që në familje, që shtrihet në komunitet, që zhvillohet nëpërmjet medieve, edukimin fetar etj. edhe atë që kryhet në shkollë nëpërmjet kurrikulës.

1.2 Objektivat e studimit

Nëpërmjet këtij punimi synohet:

1. Të eksplorohehen dallimet e rëndësishme statistikore në qëndrimet e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve në raport me variablat e varura.
2. Të hulumtohet korelacioni ndërmjet variablave të varura në qëndrimet e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve .
3. Të eksplorohehen dallimet e rëndësishme statistikore në rezultatet e faktorëve të qëndrimeve të mësimitdhënësve, prindërve dhe të shoqërisë civile në raport me gjininë dhe eksperiencën në punë.
4. Të eksplorohehen dallimet e rëndësishme statistikore në qëndrimet e mësimitdhënësve, prindërve dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile në raport me variablat e pavarur: gjininë dhe eksperiencën në punë.
5. Të krahasohen qëndrimet e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve të dy vendeve në raport me variablat e varura.

1.3 Variablat e studimit

Variablat ndahen në variabla të varur dhe të pavarur. Variablat e pavarur ndikojnë, përcaktojnë apo presupozohet se ndikojnë variablat e varur (Wallen & Franenkel, 2001:516, 518).

Në librin e tij, autori Murati në lidhje me variablat si elemente të rëndësishme kërkimore thekson se: "...variabli i pavarur është faktori ose situata që zbatohet gjatë kërimit ku studjuesi e kontrollon faktorin që do të shkaktojë një reagim, ndërsaq variabli i varur është sjellje ose reagim, i cili nxitet nga ndikimi i faktorit të pavarur me qëllim matjen"(Murati, 2004:146).

Dijet e nxënësve për jetën varen nga faktorët dhe aktorët që trajtojnë këtë problematikë. Nëse organizimi, planifikimi e zhvillimi i veprimtarive bëhet sipas standardeve bashkëkohore rriten gjasat që edhe nxënësit të mësojnë në mënyrë efikase për të përballur situata të shumta që shtron jeta në veprimtarinë e tyre. Për të marrë një pamje të përgjithshme në qëndrimet e nxënësve mësimdhënësve dhe prindërve mbi ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal në edukimin e nxënësve, në studim janë përfshirë dy variabla të pavarur dhe të varur.

Fokusi i variablave të pavarur përfshin trajtimin komplementar të edukimit në rrafshin formal dhe joformal si instrument për konsolidimin vleror të nxënësit të shkollës së mesme. Në këtë punim variabla të pavarur janë: (1) arsimimi, (2) gjinia e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve, (3) vendndodhja, (4) përvoja e mësimdhënësve në arsim.

Variablat e varur përbëjnë indikatorët, të cilët përfshihen në pyetësorët e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve.

Variablat e varur përfshijnë: (1) bashkëstudimi ndërinstitutional, (2) edukimi komplementar dhe motivimi, (3) përkrahja në mësim për arritjen akademike , (4) zhvillimi personal dhe social, (5) vlerat e punës tek nxënësi , (6) ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional.

1.4 Rëndësia e studimit

Edukimi për jetën përbën një çështje me interes për individin dhe shoqërinë. Edukimi hap perspektiva të gjëra, duke e bërë jetën e njerëzve më të mirë dhe më të realizuar. Ky punim synon të evidentojë në mënyrë shkencore problematikën e edukimit të nxënësve të shkollës së mesme për jetën, duke u ndalur në problematikën kryesore që ngërthen: formimin qytetar, individual, social, profesional..., nëpërmjet përpjekjeve që bën shkolla dhe organizatat sociale për të kultivuar arsimin cilësor, me njohuri, aftësi e kompetenca bashkëkohore për jetën.

Punimi synon të tërheq vëmendjen e shkollës, familjeve, shoqërisë civile, për të ndërthurrur në mënyrë efikase qasjen e edukimit formal me edukimin joformal. Punimi përbën një kontribut në përcaktimin e literaturës bashkëkohore, mbi rëndësinë që ka edukimi për jetën, duke evidentuar karakteristikat e këtij edukimi gjatë procesit mësimor dhe veprimtarive trajnuese dhe edukuese që ushtrojnë institucionet joformale. Në frontet e punës dhe të prodhimit nuk kërkohen thjesht diploma, por njerëz të përgatitur për të marrë përsipër detyra në sektorë të ndryshëm të veprimtarisë së tyre.

Gjetjet dhe përfundimet e punimit vinë në mënyrë logjike dhe koherente bazuar në literaturën përkatëse, zbatimin e metodologjisë kërkimore, analizës së tyre bazuar në instrumentet e matjes dhe vlerësimit të gjendjes. Kjo punë përbën një kontribut për njohjen e kësaj problematike nga faktorët dhe aktorët përkatës dhe njëkohësisht përmirëson gjendjen në shkollë dhe jashtë saj, pasi nxënësit do kuptojnë më mirë kërkesat që shtrohen në kushtet e globalizmit, të cilat edhe i anashkalojnë dhe do të angazhohen në veprimtari konkrete, që mbushin jetën e tyre për sot dhe në të ardhmen, sipas standardeve bashkëkohore.

Trajtimi në sinkron, mbi bazën e strategjive të hartuara nga instancat përkatëse, planet dhe programet e projekteve krijojnë mundësi për ta trajtuar këtë dukuri me synime të qarta dhe objektiva konkrete që i shërbejnë si punës që aktualisht bën nxënësi në shkollë ashtu edhe të mësuarit për gjatë gjithë jetës.

Në këtë këndvështrim, punimi synon të jetë një kontribut jo vetëm në zgjerimin dhe pasurimin e literaturës mbi rëndësinë e sinkronizimit efikas të koncepteve dhe praktikave mbi edukimin formal dhe joformal, por të paraqesë karakteristikat e secilit drejtim si trajtimin holistik, për të pasur produkte në përshtatje me edukimin në shkollë dhe në jetë në kushtet e zhvillimeve globale. Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e paraqitura në punim do t'u vlenin faktorëve dhe aktorëve që operojnë në shkollë dhe institucionet e tjera të interesuara për edukimin arsimor, kulturor, qytetar, profesional të të rinjve që në bankat e shkollës dhe konkretisht në nivelin e shkollës së mesme. Duke u mbështetur, jo thjesht në perceptime, por në studimin rigoroz të kësaj dukurie do të mund të motivoheshin të rinjtë, stafet mësimore dhe aktorë të tjerë për t'i kushtuar më tepër vëmendje disa aspekteve që ndoshta ata nuk i konsiderojnë dhe aq të rëndësishme, por që ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e një klime pozitive në mësim dhe edukimin tërësor të nxënësve.

Institucionet shkollore do të mund të vlerësonin më mirë rolin dhe ndihmesën konkrete që jep komuniteti si për të zgjidhur një varg çështjesh që ka shkolla aktualisht, ashtu edhe për t'i edukuar të rinjtë me punë, si një instrument i domosdoshëm që ata të bëjnë një jetë më të mirë në të ardhmen, duke qenë sa më të vlefshëm edhe për shoqërinë dhe duke ndjekur ritmet e zhvillimit të saj sipas standardeve në kushtet e globalizmit.

Po ashtu, të dhënat e këtij punimi mund të shërbejnë edhe si referencë për studime të mëtejshme në fushën e ndërveprimit të faktorëve formal dhe joformal, që mundësojnë një edukim cilësor, konkret, që përgatit shkollën dhe nxënësit për tu përballur me sfidat e shoqërisë në kohën e sotme dhe në të ardhmen.

1.5 Struktura e punimit

Studimi në mënyrë kronologjike trajton të mësuarit në shkollë dhe në institucionet e tjera, duke evidentuar mënyrën efektive të sendërtimit të urës që lidh të mësuarit në shkollë dhe të mësuarit që realizohet jashtë shkolle. Studimi evidenton avantazhet dhe vështirësitë në

përcaktimin e të mësuarit; çfarë realizohet në institucionet arsimore dhe çfarë realizohet nga institucionet e tjera, nëpërmjet tre llojeve të mësuarit: formal, informal, dhe joformal. Studimi gjithashtu bazohet në dokumentet zyrtare ndërkombëtare dhe lokale që përcaktojnë arsimin dhe strukturën organizative të saj dhe njëherësh numrin e institucioneve dhe faktorëve që ndikojnë në institucionet edukativo-arsimore formale dhe joformale.

Punimi përbëhet nga gjashtë kapituj. Në to trajtohet në mënyrë koherente problematika e përgatitjes së nxënësit për jetën. Çdo kapitull qëndron si një degëzim më vete, ku shpërfaqen sythas e nënndarjeve, të cilat fokusohen në aspekte dhe detaje të problematikës së edukimit për jetën.

Më poshtë përshkruhet shkurt përmbajtja e kapitujve.

Në kapitullin e parë *Hyrje* trajtohet sfondi i studimit, pohimi dhe përmbajtja e edukimit joformal, qëllimi dhe objektivat e studimit, variablat e pavarur dhe të varur, përcaktimi i termave, rëndësia e studimit, etj.

Kapitulli i dytë *Shqyrtim literature* trajton problematikën e literaturës së përdorur, përzgjedhjes së autorëve më në zë, që kanë trajtuar këtë çështje. Aty shtjellohen koncepte dhe teori mbi korrelacionin midis edukimit formal dhe joformal. Aty paraqiten disa modele që shpjegojnë nga pikëpamja teorike dukurinë në fjalë, pastaj trajtohen konceptet mbi edukimin, duke u fokusuar konkretisht tek edukimi joformal, si instrument i rëndësishëm për edukimin e nxënësve të shkollës së mesme për jetën. Më tej punimi vijon me hulumtimin e qëndrimeve institucionale dhe përmirësimin e metodologjive të edukimit me kusht përgatitjen efikase të të rinjve për t'u përballuar me sfidat e jetës. Edukimi joformal është në linjën e edukimit formal dhe informal dhe operon në përshtatje me to, duke krijuar një tablo të plotë të edukimit qytetar dhe si profesionist për jetën në kushtet e globalizmit. Duke shqyrtuar literaturën bashkëkohore dhe duke ju referuar dokumenteve të shumta mbi këtë çështje, mbi bazën e përzgjedhjes së materialeve, studimi krijon një bazë të gjërë konceptuale dhe teorike për të trajtuar problematikën e edukimit për jetën.

Kapitulli i tretë fokusohet tek *Metodologjia e kërkimit*. Në pjesën e parë të këtij kapitulli janë paraqitur dizenjimi i studimit, hipotezat, pyetja kërkimore; metodat e hulumtimit, respektivisht qasja sasiore dhe cilësore. Pjesa e dytë trajton përdorimin e instrumenteve matëse, që janë pyetësorët dhe intervistat gjysmë të strukturuar, që mundësuan mbledhjen e të dhënave si dhe puna me fokus grupe. Po ashtu, është sqaruar hollësisht përcaktimi i popullatës së studimit dhe njëherësh përzgjedhja e kampionit. Në fund të këtij kapitulli trajtohet etika e studimit. Në kapitull shpjegohen metodat e përzgjedhjes së subjekteve të kërkimit, sipas standardeve të kampionimit, që sigurojnë përfaqësim efikas të popullatës. Më tej është shpjeguar se punimi bazohet në qasjen e kombinuar si një qasje efikase, duke shfrytëzuar avantazhet që kanë metoda e kërkimit sasior dhe cilësor.

Po ashtu, punimi është produkt edhe i punës së kujdesshme vërtetuese, në veçanti gjatë fazës së punës në terren, për mbledhjen e të dhënave. Në vijim përshkruhet rëndësia dhe përdorimi i instrumenteve të përdorura në funksion të studimit, sikurse janë pyetësorët, intervistat, vërtetimet, puna me grupe subjektsh: nxënës, mësues, prindër, pjesëtar të shoqërisë civile në fokus. Zbatimi i instrumenteve u parapri nga pilotimi në disa shkolla, duke testuar pyetjet në 1/10 e kampionimit. Duke qenë se krahas anketimit të subjekteve u përdor edhe qasja e kërkimit cilësor, ku studjuesi është pjesë e kërkimit, u bë kujdes që informacioni të merret në mënyrë të natyrshme, duke iu përmbajtur me rigorozitet kritereve të vlefshmërisë dhe besueshmërisë së studimit.

Mbi bazën e të dhënave u bë skedimi dhe u krijua një *database* me të dhënat e grumbulluara, që shërbyen për analizën e parashtruar në punim. Përpunimi dhe analiza e të dhënave u realizuan nëpërmjet paketave të programeve kompjuterike SPSS 20.0 dhe Excel. 13.0. Në mbyllje të kapitullit u evidentua problema etike, që u zbatua në terren, si kusht që respondentët të ndihen mirë dhe të japin në mënyrë të natyrshme dhe të përgjegjshme informacionin e nevojshëm për studim. Në mënyrë të përmbledhur pasqyrohen edhe kufizimet e studimit, të cilat duhen bërë të qarta për lexuesit dhe studiuesit e kësaj problematike.

Kapitulli i katërt *Analiza e rezultateve* përmban analizën në terren për mbledhjen e të dhënave, sipas koncepteve, metodave dhe modeleve të përshkruara më lart. Mbi këtë bazë janë ndërtuar tabela dhe grafikë për shqyrtimin e këtij korrelacioni, duke tërhequr zërat e mësuesve, nxënësve, si dhe të personelit të institucioneve formale dhe joformale, të cilët ofrojnë njohuri mbi këtë problem. Kapitulli përmban analizën statistikore lidhur me pyetësorët për nxënësit, prindërit dhe mësuesit.

Fillohet me një analizë statistikore për pyetësorin e nxënësve, e cila është kryer me anë të disa instrumentëve specifik, siç janë analiza statistikore përshkruese: përqindja, devijimi standard, mesatarja, varianca dhe analiza analitike, e cila përfshin testin e pavarësisë Chi Square, si test jo parametrik për të hulumtuar ekzistencën e marrëdhënieve ndërmjet variablave dhe analizën faktoriale. Crosstabulations është shfrytëzuar për njohjen, klasifikimin dhe për të sintetizuar informacionet rreth popullatës së marrë në studim. Testi i pavarësisë Chi Square është përdorur për të testuar nëse dy variabla cilësore janë të pavarura nga njëri-tjetri, apo jo.

Analiza faktoriale është kryer duke e ditur se variablat e marra në studim janë matur me disa pyetje, atëherë para testimit të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave lind nevoja e kryerjes së analizës faktoriale dhe më pas ndërtimi i ekuacionit të regresionit të shumëfishtë linear. Analiza e variancës na lejon të krahasojmë dy ose më shumë grupe të të dhënave, duke parë kështu ndryshueshmërinë e brendshme në këto grupe me ndryshueshmërinë midis grupeve. Ndërsa testi t, si test parametrik u përdor për të vërtetuar ekzistencën e diferencave ndërmjet grupeve të pavarura dhe rëndësinë në mes dy mesatareve aritmetike, çka në studim na bën të mundur konstatimin e dallimeve në qëndrimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve në lidhje me gjininë, vendin, institucionin dhe përvojën e punës së mësimdhënësve. Hipotezat në këtë studim u testuan në nivelin e besueshmërisë 95% ($p \leq 5$). Gjithashtu, në funksion të kësaj analize është parë edhe “multikolineariteti” midis variablave të pavarura. Më tej vazhdohet me analizën edhe me trajtimin e pyetësorit .

Në këtë kapitull shqyrtohet analiza e të dhënave me metodën statistikore, me programin SPSS, që gjenë zbatim në shkencat sociale, si për të matur problematikën individuale ashtu edhe atë sociale lidhur me dukurinë në fjalë. Aty paraqiten diskutimet mbi gjetjet e punimit, duke i shoqëruar me interpretimet e rezultateve, bazuar në pyetjet kërkimore. Diskutimi i gjetjeve ndjek linjën e pyetjeve dhe përgjigjeve, duke marrë të dhëna nga të dy burimet, përmbajtja e të cilave bazohet në një problematikë të integruar dhe koherente, duke i krahasuar me përgjigjet që jepen nga subjekte të ndryshme, sikurse janë: nxënësit, prindërit, mësuesit, pjesëtar të shoqërisë civile të intervistuar mbi problematikën e përgatitjes arsimore si dhe qëndrime qytetarësh e nxënësish të shkollave të mesme të Kosovës për jetën aktuale dhe sfidat e saj.

Kapitulli i pestë *Diskutimi* përfshin diskutimet lidhur me anketimin dhe intervistat dhe analiza përgjithësuese e tyre.

Në kapitullin e gjashtë *Përfundime dhe rekomandime* paraqiten përfundimet e arritura nga punimi, si rrjedhojë e zbatimit të qasjes së kombinuar dhe trajtimit të edukimit në pamje të ndryshme me fokus të përbashkët të edukimit formal, informal dhe joformal, duke e parë këtë proces si një ndërthurje edukimi, nga pozicioni i edukimit joformal, ndërtuar mbi koncepte e praktika bashkëkohore.

Përfundimet dhe rekomandimet që përvijojnë janë fryt i një analize koherente të studimit, duke ofruar një pasqyrë të gjendjes konkrete, të faktorëve dhe aktorëve, sikurse janë nxënësit, prindërit, mësuesit, pjesëtar të shoqërisë civile. Faktorët dhe aktorët e interesuar ballafaqohen me kërkesat shkencore, për të vënë në efikasitet potencialin e tyre, për të rritur performancën e të rinjve e për të mësuar në aspektin akademik dhe të përpunimit të sjelljeve dhe qëndrimeve, sipas standardeve në kushtet e globalizmit.

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1. Përkufizimi i edukimit formal dhe joformal

Sipas “UNESCO, 1972, arsimi joformal është “aktivitet edukativ i organizuar, jashtë sistemit formal, që ka për qëllim të plotësojë nevojat e përfituesit, por edhe qëllimet e të mësuarit”.

Marković (2005) e përkufizon edukimin formal si “...proces edukativ i cili ndodh brenda sistemit formal arsimor, i strukturuar në mënyrë hierarkike nga shkolla fillore deri në fakultet, i cili në përfundim shpie në arritje të titujve dhe diplomave të caktuara”

Gjithashtu edukimi joformal përkufizohet si “aktivitet edukativ i organizuar dhe i planifikuar që nxit të mësuarit individual dhe shoqëror, arritje të njohurive dhe shkathtësive të ndryshme, zhvillim të qëndrimeve dhe vlerave, të cilat ndodhin jashtë sistemit formal...”(Marković, 2005:10,11)

Një përkufizim tjetër mbi edukimin formal dhe joformal e shohim tek Marjanović, ku edukimin formal e përshkruan si edukim i cili “...mundëson arritjen e njohurive dhe shkathtësive themelore...i strukturuar në mënyrë hierarkike...i ndarë në klasa dhe nivele..mundëson marrjen e diplomave...sipas natyrës së vet është kryesisht jofleksibël dhe nuk i përshtatet nevojave individuale” (Marjanović, 2003: 9).

Vetë edukimin joformal e përkufizon si edukim i cili “...mund të fillohet kurdo në jetë,”rast i dytë”për ata të cilët nuk kanë mundësi për shkollim të rregullt; metodë fleksibile e punës, i përshtatshëm ndaj nevojave të individit” (Marjanović, 2003: 12).

Për Kovačević (2012), edukimi formal është edukim i cili është i “lidhur rreptësisht me kornizat shkollore dhe institucionin shkollë, i vendosur në bazë të rregullave juridike të shkruara, planit dhe programit, ndërsa edukimi joformal është fleksibël dhe i kundërt, për shkak se plotëson boshllëqet e edukimit të parë”.

Studiuesi i njohur i çështjes së edukimit joformal Kuka, lidhur me edukimin formal thekson: “Edukimi formal përkufizohet si edukim institucional dhe nënkupton procesin i cili ndodh brenda sistemit arsimor formal, i përcaktuar qartë me ligj, i legjitimuar, e si rezultat përfundimtar është arritja e njohurive dhe shkathtësive të caktuara “, (Kuka , 2012 :198) .

Gjersa për edukimin joformal thekson se: „Me arsimim joformal përhapen mundësitë njohëse, zgjerohen dhe ndërtohen njohuritë dhe shkathtësitë ekzistuese të arritura nëpërmjet arsimit formal, dhe ku përfitoen ato njohuri, aftësi dhe shkathtësi, të cilët gjatë arsimit formal nuk janë ndeshur” (Kuka,2012:199)

Kovačević arsimin joformal e përshkruan si “..... pjesë e sistemit të të mësuarit për gjatë gjithë jetës, koncept i cili siguron që të rinjtë dhe të rriturit arrijnë dhe zbatojnë shkathtësi , aftësi e njohuri që t’i përshtaten gjithmonë rrethit të ndryshueshëm” (Kovačević,S,2011 :11)

Zaki Dib rreth arsimit formal thekson se”Arsimi formal korrespondon me një model sistematik të organizuar të arsimit, të strukturuar dhe të administruar në bazë të një grupi të caktuar të ligjeve dhe normave, duke paraqitur një program tepër të ngurtë sa i përket objektivave, përmbajtjeve dhe metodologjive.”(Zaki Dib, 1988 : 1).

Ndërsa edukimin joformal e përshkruan si një mundësi të mirë për t’u përgjigjur kërkesave të nxënësve:“Edukimi joformal është i drejtuar tek nxënësi dhe paraqet mundësitë e tanishme fleksibile të përcaktuara fillimisht, si dhe procedurat e miratuara, objektivat dhe përmbajtjen” (Zaki Dib,1988 : 3).

2.2. Shekulli XX –XXI dhe risitë e edukimit

“Arsimi duhet të sigurojë që nxënësit të mësojnë se si të zgjidhin problemet, e jo të dinë se cilët janë zgjidhjet e mundshme, sepse situatat me të cilat njerëzit në jetën e tyre ndeshen secilën herë zhvillohen ndryshe”. John Dewey .

Shekulli 20 karakterizohet nga shfaqja e shumë koncepteve dhe krijimin e zhvillimit e shumë teorive arsimore. Kjo shpjegohet me ndryshimet në shkencë dhe në konceptet demokratike, të cilat mundësuan trajtimin në shumë aspekte të procesit mësimor. "Arsimi i shekullit XX karakterizohet si "model i fabrikës" i themeluar në epokën industriale të shekullit XIX dhe nevojave të punëdhënësit. Arsimi i shekullit XXI është "model global", i cili kënaq nevojat e shoqërisë globale dhe nivelit të lartë teknologjik"(Gashi, 2012:17)

Shoqëria globale në fokus ka nxënësin në qendër, të mësuarit e zgjidhjes së problemeve si edhe hulumtimin dhe fitimin e shkathtësive të nevojshme për jetë."Fokusi i të mësuarit në shekullit XXI është në atë që nxënësit dinë; në atë që ata mund ta bëjnë dhe në faktin se çka ndodh me nxënësin pas detajeve të tjera"(Gashi, 2012:17).

Në mendimin pedagogjik aktual vihet theksi në tre forma të mësuarit që janë: të mësuarit formal, joformal dhe informal, të cilat janë në fokus të këtij punimi.

Konceptimi filozofik i sinkronizimit të formave të mësimit është karakteristikë e mesit të shekullit të XX dhe kryesisht me krijimin e OKB, me politikën e saj tolerante qytetare dhe të UNESCO-s, si organizatë në përbërje të saj që trajton edhe politikat arsimore që ndjekin shtete të ndryshme. Ndërkohë trajtesat e reja shkencore të bazuara në studime serioze sollën një impuls të ri për të rishqyrtuar konceptet tradicionale mbi arsimin. Në këtë kontekst pati risi edhe mbi qasjet e arsimit formal, joformal dhe informal. Gjithsesi studiuesit e çështjeve arsimore bien dakord për ekzistencën, krahas edukimit formal, që realizohet në institucionin e shkollës edhe mënyra të tjera të edukimit sikurse janë edukimi joformal dhe informal, që duke trajtuar si aspekte të ndryshme të fenomenit, sjellin diçka të re në metodologji dhe përmbajtje në lidhje me natyrën e edukimit.

Në kushtet e reja të zhvillimit organizativ ndërkombëtar dhe të zhvillimit marramendës të teknologjisë së informacionit, u vihet në dukje se shkolla jep një set njohurishë dhe aftësishë, por ajo nuk mund të realizojë të gjitha kërkesat që duhet të përmbush qytetari në kushtet e globalizimit. Arsimi për vetë rëndësinë që ka në përgatitjen e brezit të ri për jetën

ka marrë vëmendje në kohë të ndryshme. Arsimi joformal u bë pjesë e diskutimeve mbi politikat e arsimit në fund të viteve 1960 dhe fillim të viteve 1970 në përpjekjen për të trajtuar të mësuarit gjatë gjithë jetës. Deri atëherë, përgjithësisht të mësuarit konsiderohej si një atribut i shkollës, edhe pse në rrafshin teorik ishin hedhur mjaft ide nga reformatorët e arsimit për të mësuarit në një kontekst më të gjërë të lidhur me jetën.

Tight vinte në dukje se konceptet e fundit kanë të bëjnë me zgjerimin e arsimit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, me konceptin e arsimit joformal, ku “pranohet rëndësia e arsimit, të mësuarit dhe të trajnimit që do të bëhet jashtë institucioneve të njohura arsimore”(Tight, 1996: 68)

Në vitet ’70, shekulli XX, arsimi joformal filloi të konsiderohej si forma ideale e arsimit, me efekte të shumta në shoqëri. Konceptimi i ri mbi edukimin shërbeu si pikënisje që planifikuesit dhe ekonomistët në Bankën Botërore të bënë një dallim në mes të arsimit formal dhe joformal” (Fordham, 1993: 2).

UNESCO (1972) vë në dukje arsimin joformal si “aktivitet të organizuar edukativ jashtë sistemit formal, i cili ka për qëllim të kënaqë nevojat e shfrytëzuesit, por edhe qëllimet e të mësuarit”.

Studiuesit Coombs & Ahmed kanë dhënë përkufizimet e tyre rreth dy formave të edukimit. Edukimi formal....., natyrisht është ‘sistem edukimi’ shumë i institucionalizuar, i vlerësuar në mënyrë kronologjike dhe i strukturuar në mënyrë hierarkike, i cili përfshin shkollën fillore dhe arrijtjet më të larta të universitetit (Coombs and Ahmed, 1974: 8).

Edukimi joformal”....është çdo aktivitet edukativ i organizuar, sistematik i kryer jashtë kuadrit të sistemit formal që siguron lloje të zgjedhura të mësimit të nëngrupeve të veçanta në popullatë, të rriturit si dhe tek fëmijët.”(Coombs and Ahmed, 1974: 8).

Ndërsa studiues të tjerë të çështjeve pedagogjike e zhvishnin arsimin joformal nga konceptime superiore, duke e konsideruar si një nënsistem të arsimit. Ashtu sikurse të tjerë e konsideronin si një trajtë inferiore ndaj shkollimit formal. Sipas tyre, “arsimi joformal mund të përshkruhet si një 'e keqe e domosdoshme' e përkohshme në situatat e krizës deri

në shkollimin formal, deri sa arsimi formal të mund të rikthehet në pozicionin efikas (Pigozzi, 1999).

Për të mos folur për pikëpamjet ”ekstremiste” të kritikut austriak, Ivan Illich, mbi de-shkollimin e shoqërisë, si një diskurs radikal mbi mënyrat se si arsimi praktikohet në ekonominë "moderne"(Illich, 1971:1).

Që në hyrje të librit De-Schooling Society, ai përpiket të jap shembuj të asaj që ai e konsideron si natyra e padobishme e edukimit të institucionalizuar, të arsimit universal, duke parashtruar forma alternative të shkollimit. Mënyrat aktuale të organizimit të shkollave, ideologjizimi, krijojnë pabarazi sociale, pasi jo të gjithë nxënësit kanë mundësi të barabarta për shkollim. Kështu fëmijët e varfër ekonomikisht kanë prirjen për të mbetur prapa zhvillimit individual dhe social. Po ashtu, financimi i pamjaftueshëm i shkollave nga shteti nuk ofron cilësinë e shkollimit, çka krijon dekurajim për prindërit, mësuesit dhe nxënësit.

Sistemet formale arsimore përshtateshin më ngadalë ndaj ndryshimeve socio- ekonomike, kjo për shkak të konservatorizmit të shkollës dhe vetë shoqërisë. Në këto rrethana shumë vende, të gjendura në vështirësi ndërmorën politika ekonomike për zgjerimin e arsimit formal.

Gjithsesi, në deklaratën e Këshillit të Evropës nënvizohet: ”... sistemet arsimore formale të vetme nuk mund t’u përgjigjen sfidave të shoqërisë moderne dhe për këtë arsye inkurajohet përforcimi i tyre nga praktikat joformale arsimore.të njohin arsimin joformal si një partner ”de facto” në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe ta bëjë të arritshëm për të gjithë” (Këshilli i Evropës, 2000, cituar nga Kamil, M, 2007, f. 2).

Në fillim shekullin XXI pati një zhvillim në konceptimin dhe praktikat mbi arsimin joformal, çka evidentohet në studimet e Hoppers (2005; 2006; 2007; 2008) dhe nga Rogers, i cili vinte në dukje se tani ka një rinovim të konsiderueshëm të interesit për arsimin joformal në nivel global (Rogers, A, 2004 & Kamil, M, 2007).

Sikurse vë në dukje Rogers,(2004) ende mbeten disa çështje për t'u trajtuar lidhur me arsimin joformal dhe raportin e tij me arsimin formal. Një prej këtyre problemeve është rritja e diversitetit brenda asaj që ne e quajmë arsimin formal, çka nuk është shumë e qartë se çfarë duhet përfshirë dhe përjashtuar në arsimin formal.

Përtej diskutimeve akademike mbi rëndësinë e njërës apo tjetrës formë të arsimit, studiues të çështjeve arsimore shtruan nevojën e hartimit të programeve dhe projekteve të përbashkëta se ku duhet shtrirë njëra dhe ku duhej të fillonte tjetra. Një nga pyetjet që shtrohej dhe duhej të merrte zgjidhje ishte se deri ku duhet të shtrihej veprimtaria e agjencive joqeveritare dhe e organeve të tjera të shoqërisë civile. Të tjerë fokusohen në shfrytëzimin e arsimit joformal për të mësuarit individual, me plane individuale dhe interesa të grupeve të ndryshme të të rinjve; si do të mund të rritej problematika e përfshirjes së vajzave dhe grave në jetën komunitare dhe shoqërore në tërësi.

Me gjithë praktikën dhe konceptimet mbi të mësuarit joformal, ende ka paqartësi dhe moszbatim efikas të mënyrave të mësuarit në shkollë dhe jashtë saj. Përvojat mbi shfrytëzimin e komuniteteve, përfshirja e tyre në shkollë, sikurse është fjala edhe për shkollat e mesme janë me vlera edhe në kushtet e arsimit në Kosovë. Ato mundësojnë në sqarimin e koncepteve, përvojave dhe organizimin e edukimit joformal dhe informal për pjesëmarrjen dhe zhvillimin e përvojave komunitare, për edukimin e të rinjve nëpërmjet punës dhe vlerave, për vazhdimësinë e edukimit të të rriturve për gjatë gjithë jetës.

Interesi për arsimimin efikas të brezit të ri ka qenë dhe mbetet në fokus të organizatave të mëdha prestigjioze, që veprojnë në kuadrin e OKB dhe jashtë saj. Të mësuarit në rrafshin pedagogjik dhe shkencor është një proces që e shoqëron njeriun nga lindja deri në ndërrimin e jetës. Nëpërmjet tij mundësohet zhvillimi i vazhdueshëm i aftësive të një individi, që është njëkohësisht individ dhe pjesëtar i shoqërisë që në kushtet e sotme është bërë globale. Asambleja parlamentare më 15 dhjetor 1999 duke ju referuar raportit të Komitetit të Kulturës dhe Arsimit vë në dukje se të vetme sistemet arsimore formale nuk mund t'i përgjigjen sfidave të shoqërisë moderne dhe për këtë arsye përshëndet përforcimin me praktikën joformale arsimore.

“Me besimin se arsimi formal nuk është më në gjendje që me forcat dhe vlerat e veta të përgjigjet në provokimet “e të mësuarit për jetën”, të kuptojmë që është e nevojshme “forcimii praktikës arsimore joformale”(Këshilli i Evropës,1999 : 4).

Sipas përkufizimit të Forumit Rinor Evropian, arsimi joformal korresponson me një koleksion mjetesh mësimore dhe skema të mësuarit, të cilat shihen si alternativa kreative dhe inovative me sistemet tradicionale dhe klasike të mësimdhënies. Nëpërmjet ndërveprimit personal dhe fleksibilitetit në zgjidhjen e problemeve, të rinjtë mund të diskutojnë çështje të rëndësishme për jetën e tyre si qytetarë në shoqëri dhe të integrojnë njohuritë e tyre. Grupe të ndryshme të njerëzve marrin pjesë në këtë proces, ndërkohë që organizatat joqeveritare përfshihen në veprimtaritë me rininë dhe komunitetin. Nëse njohja nuk është arritur mjaftueshëm, kjo ndodh edhe për shkak të mungesës së besimit në cilësinë e AJF brenda shoqërisë dhe në kuadrin e vetë organizatave rinore.”(General Assembly: 2008).

Sipas Komisionit evropian të mësuarit formal dhe joformal dallohen ndërmjet tyre. Kështu arsimi formal është “të mësuarit, i cili zakonisht shtjellohet në institucionet edukativo-arsimore,i cili është i strukturuar sipas qëllimeve,kohës dhe kërkesave, i cili të çon drejt certifikimit .Të mësuarit formal nga pikpamja e nxënësit është i drejtuar drejt ndonjë qëllimi të caktuar” (Komisioni Evropian, 2001:33).

Ndërsa në lidhje me të mësuarit joformal vë në pah se është“të mësuarit,i cili nuk shtjellohet në institucionet arsimoreapo në shkollat e mesme profesionale, pas së cilës zakonisht nuk jepet certifikatë. Në të njëjtën kohë është sistematik(në pikpamje të qëllimeve,kohëzgjatjes dhe mjeteve të mësimit)” (Komisioni Evropian,2001:33).

Në materialet e Këshilli të Evropës (2001) “të grupit të punës për arsimin joformal”, është përpunuar përcaktimi i edukimit joformal si "pjesëmarrje vullnetare dhe ku programet realizohen nga liderët e trajnuar në sektorët vullnetarë ose shtetëror; duhet të monitorohet dhe të vlerësohet në mënyrë sistematike, dhe ku përvoja e fituar mund të certifikohet. Ajo është e lidhur zakonisht me kërkesat e punësimit dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës që kanë individët. "

Edukimi joformal në Evropë, sipas Këshillit të Evropës (2003), paraqitet në disa forma:

- *qasja duale*, që e ka sistemi austriak dhe gjerman i edukimit, ku i kushtohet rëndësi sistemit formal, duke reflektuar hezitim për edukimin joformal.
- *qasja mediterane* (Greqia, Italia, Spanja dhe Portugalia) me një pozitivitet në integrimin e edukimit formal me joformal
- *qasja e vendeve Nordike* (Finlandë, Norvegji, Suedi dhe Danimarkë), me strategji të avancuara për integrimin e arsimit formal me atë joformal
- *qasja e Kualifikimit Nacional Kombëtar (NVQ)*, (që aplikohet në Mbretërinë e Bashkuar, Uells dhe Irlandën e Veriut), e bazuar në modelin arsimor të vlerësimit dhe trajnimit të kombinuar me të mësuarit jashtë institucioneve formale dhe institucioneve të trajnimit.
- *qasja e sistemit të hapur të diplomave dhe certifikatave* (Franca dhe Belgjika), veçanërisht sistemi i edukimit në Francë, i përket vendeve që aplikojnë metodologji më të zhvilluara dhe strategji vlerësimi që kërkojnë përdorimin e edukimit joformal.

Me gjithë format e larmishme (të cilat në përbëjnë qasje dhe zhvillim përvojash) të sistemeve të edukimit, sistemi arsimor në Kosovë e trajton edukimin të integruar në të gjitha aspektet e shfaqjes së tij. Edukimi joformal është një instrument për të nxitur bashkëpunimin e të rinjve. Të rinjtë vetëdijesohen për rëndësinë e AJF si një mjet komplementar në jetën e tyre. Ata kontribuojnë në njohjen e rëndësisë së AJF për të zhvilluar mjete të reja të vlerësimit që mund të përdoren për të njohur vlerën dhe ndikimin e këtij instrumenti. AJF është një instrument për të zhvilluar praktika dhe metoda të reja në fushën e edukimit, lidhur me demokracinë dhe përfshirjen sociale, duke e stimuluar dhe përhapur atë.

“Arsimi joformal nënkupton pjesmarrje vullnetare. Arsimi joformal karakterizohet nga fleksibiliteti dhe mundësia e përshtatjes së programit, nevojave dhe kërkesave të grupeve konkrete. Edukimi joformal tenton të jetë plotësim i edukimi formal e kursesi zëvendësim i tij”(Lalovič, 2009 : 52).

Sipas Kukës “Arsimi joformal është lloj arsimi i procesit arsimor i cili nënkupton aktivitetet arsimore jashtë institucionale me të cilat arrihen njohuri dhe shkathtësi të caktuara, kurse pjesëmarrja në aktivitete të tilla është vullnetare”(Kuka, 2012 :198) .

Më tej arsimin joformal e përkufizon si një proces në të cilin zgjerohen njohuritë e arritura në arsimin formal. “Me arsimin joformal përhapen mundësitë për të njohur, zgjeruar dhe ndërtuar njohuri dhe shkathtësitë ekzistuese të arritura gjatë arsimit formal, dhe nxënësit përfitojnë ato njohuri, aftësi dhe shkathtësi me të cilat gjatë arsimit formal nuk është ndeshur”(Kuka, 2012 :199).

Në përvojat ndërkombëtare, institucionet dhe të rinjtë gjejnë praktika të mira nga vendet e ndryshme evropiane. Këto praktika mund të përdoren për të promovuar edukimin joformal në ndërtimin e demokracisë dhe përfshirjes së të rinjve në jetën sociale.

Përveçse përbën një vlerë të shtuar, AJF është edhe një mënyrë për të ndihmuar shoqëritë të jenë më demokratike dhe të respektojnë të drejtat e njeriut, në fushën e të mësuarit.

Individët të marrin pjesë në baza vullnetare dhe si rezultat, merr një rol aktiv në procesin e të mësuarit. Ndryshe nga të mësuarit informal, ku mësimi ndodh jo aq në mënyrë të ndërgjegjshme, nëpërmjet AJF individi është përgjithësisht i vetëdijshëm për faktin se po mëson. (Forumi Rinor Evropian, 2003)

Më tej, Forumi Rinor Evropian, evidenton edhe disa karakteristika të këtij lloji të mësuarit, që janë:

- është vullnetar, sepse nxënësit marrin pjesë në aktivitetet e AJF, duke ndjerë dhe detyrimin për përmbushjen e veprimtarive
- është i qëllimshëm sepse aktivitetet janë të dizenuara për të arritur synimet e vendosura
- është pjesëmarrës sepse të rinjtë marrin pjesë aktivisht në hartimin dhe zbatimin e programeve të mësimit
- është i vetëdijshëm sepse nxënësit janë të ndërgjegjshëm për atë që mësojnë

- është një proces i orientuar sepse ajo çka ndodh gjatë procesit mësimor ka rëndësi të madhe, sepse e mundëson nxënësin për të zgjedhur atë që ai dëshiron të mësojë dhe të arrijë.

Vlerësimi i AJF sikurse kërkon dhe Këshilli i BE-së, realizohet duke ndërtuar besimin e të rinjve përmes proceseve transparente të menaxhimit të cilësisë. AJF ndërtohet mbi bazën e disa treguesve që janë burimet në dispozicion të edukimit, edukatorët, përmbajtja dhe procesi i të mësuarit. Aktualisht sot janë plotësuar kushtet e nevojshme për të siguruar cilësi, ndërkohë që palët e interesuara kanë role dhe përgjegjësi të qarta mbi edukimin e të rinjve.

Sipas Prastalo (2010) përfitimi i njohurive dhe shkathtësive të nevojshme për jetë dhe punë arrihet nëpërmjet arsimit joformal çka “nxit zhvillimin personal, sepse me ndihmën e tij zhvillon potencialet e veta, pastaj vinë interesi dhe talenti, mundësia e punësimit, zgjedhja e vendit të punës; e gjitha kjo krijon qytetari aktive, shoqëri civile, demokraci, paqe, barabarësi më të mëdha shoqërore dhe drejtësi” (Prastalo, 2010: 83-84).

Përmes përfshirjes në arsimin joformal, qytetarëve u krijohet një mundësi për të eksperimentuar dhe për të marrë përgjegjësi. Me këto mënyra edukimi ata janë në gjendje të zhvillojnë kureshtjen dhe entuziazmin e tyre; të mësojnë të punojnë së bashku, të negociojnë dhe të praktikojnë vendimmarrje demokratike. Këto elemente përbëjnë hapa të rëndësishëm drejt qytetarisë aktive demokratike. Duke u monitoruar dhe vlerësuar arsimit joformal krijon premisa për të zhvilluar aftësitë personale, sociale dhe profesionale përmes eksperimenteve në një mjedis relativisht të sigurt.

Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të edukimit joformal, të rinjtë mund të marrin përvojë që nuk mund të krahasohet me përvojën formale tradicionale të punës. Aktivitetet që zhvillohen në kuadrin e arsimit joformal përfshijnë vendimmarrjen demokratike, aftësitë pjesëmarrëse, aftësitë për të negociuar dhe për rrjedhojë zhvillimin personal, nëpërmjet cilësive të tilla, si përkushtimi, përfshirja, përgjegjësia, solidariteti, vetëdija demokratike, motivimi, iniciativa, emancipimi, fuqizimi, kreativiteti, respekti, toleranca, vetëdija ndërkulturore, aftësitë kritike, pavarësi intelektuale dhe vetbesimi.

2. 3. Zbatimi i elementeve të edukimit joformal në atë formal

Shoqëria globale po favorizon edukimin joformal dhe se të mësuarit nëpërmjet këtij edukimi po e konsideron si të mësuarit alternativ, të cilin individ mund ta ndjek gjat tërë jetës së tij në drejtim të zhvillimit profesional. Kështu literatura e shfletuar dhe studimet e ndryshme që janë bërë në drejtim të edukimit joformal, tregojnë se nxënësit dhe mësuesit nëpërmjet edukimit joformal e trajnimeve, punëtorive e seminareve të ndryshme fitojnë aftësi, shkathtësi personale dhe sociale, zhvillim të imagjinatës dhe përvetësim të njohurive të cilat mund t'i zbatojnë në jetën e përditshme.

“Disa nga shembujt tipik të arsimit joformal janë: aktivitetet arsimore në kuadër të programeve vëzhguese, kampet rinore dhe shkëmbimi, shkëmbimet afatgjate të vullnetarëve, trajnimet e ndryshme, seminarët dhe kurset, të cilat si qëllim mund të kenë në radhë të parë zhvillimin e disa qëndrimeve dhe vlerave shoqërore....”(Markovič, 2005:11).

Zhvillimi profesional i mësuesve kërkesë e shoqërisë së dijes

Ndër dhjetë karakteristikat e edukimit joformal, Markovič veçon zhvillimin personal dhe profesional si karakteristika të dytë të këtij edukimi që ka dalë si “produkt nga trajnimi i trajnerëve” (Markovič, 2005:12).

Sipas shumë studiuesve, elementet e edukimit joformal mund të barten në edukimin formal duke u zhvilluar mësuesit në mënyrë sistematike në aspektin profesional. nëpërmjet trajnimeve, seminareve dhe punëtorive të ndryshme. Kështu mësuesit bëhen faktorë kyç të zbatimit të elementeve joformal për gjatë procesit mësimor.

Në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesve, Murati thekson se: “zhvillimi profesional ... është pjesë përbërëse e zhvillimit të përgjithshëm pedagogjik dhe arsimor të arsimtarit dhe mund të thuhet se ajo është një “rezervë” shumë e madhe për përpunimin personal të arsimtarit dhe të punës së tij arsimore në shkollë” (Murati, 2009:81).

Autorët Fullan, Elmore dhe Burney (1999) e përshkruajnë zhvillimin e suksesshëm profesional si:

- përqendrim te zbatimet konkrete në klasë të ideve të pergjithshme
- krijim i përvojave të mësuesve me vetë praktikë dhe jo në përshkrime të saj
- dhënie e mundësive për mbështetje dhe bashkëpunim të grupit
- përfshirje e vlerësimit të qëllimshëm dhe gjykimeve për punën e bërë nga profesionistë të aftë'' (Fullan, 2001:386).

Gjithashtu, studiuesi Popović jep një hapësirë të veçantë zhvillimit profesional të mësimeve, ku në mes tjerash thekson se: "Zhvillimi profesional i mësimit mundson arritje, zgjerim dhe thellim të vazhdueshëm të njohurive, zhvillim të shkathtësive dhe aftësive, të cilat janë relevante për sukses të aktiviteteve mësimore dhe jashtë mësimore të nxënësve'' (Popović, 2010:2).

Më tej ai thekson se zhvillimi profesional "...ofron mundësi të arritjes së njohurive dhe shkathtësive me të cilat sigurohet bashkëpunimi cilësor dhe i suksesshëm....Gjithashtu, mundëson përgatitjen për të pranuar ndryshimet sistemore, zbatimin e suksesshëm të tyre dhe pjesëmarrje aktive dhe iniciativë në zbatim të reformës'' (Popović, 2010:2).

Më tej mësimit e përshkruan si një profesionist, i cili i aftëson nxënësit për punë të pavarur dhe punon në motivimin e tyre. "Mësimi si profesionist për fushën e vet paraqet modelin se si duhet menduar, punuar dhe hulumtuar ... aftëson nxënësit për punë të pavarur... përpiqet që të motivojë nxënësit për mësim, gjen rrugët më të mira të të mësuarit për nxënësit e tij dhe zhvillon motivimin e brendshëm'' (Popović, 2010:5).

Studiuesi i çështjeve të rëndësishme mbi edukimin joformal Kovačević, në hulumtimin e tij "Aktivitetet e organizatave ndërkombëtare në zbatim të arsimit joformal në Mal të Zi" ka marrë qendrime të mësimit rreth zhvillimit të tyre profesional dhe se rezultatet e hulumtit tregojnë se "të anketuarit janë plotësisht apo kryesisht të kënaqur me zhvillimin

e tyre personal dhe profesional të arritur nëpërmjet seminareve, kurseve dhe trajnimeve të ngjajshme në kuadër të arsimit joformal.....”(Kovačević, 2012:131).

Zhvillimi i shkathtësive individuale dhe sociale

Shkathtësitë individuale dhe sociale janë elemente të rëndësishme, të cilat duhet t'i ketë çdo individ në shoqërinë globale që të mund t'i plotësojë kërkesat dhe nevojat e tregut të punës.“Janë një numër i madh i shkathtësive sociale, të cilat ndonjë individ duhet t'i ketë dhe t'i zhvillojë,dhe për këtë zhvillim nevojëet arsimit joformal.Në kuadër të metodave të edukimit joformal.....në kuadër të seminareve,trajnimeve,punës në grupe të vogla dhe të mëdha, komunikimi dhe ndërveprimi janë elemente të situatës sociale” (Kovačević, 2012:40).

Studiuesi , Kovačević më tej thekson se “ pas këtyre dy elementeve lidhen një numër i madh i elementeve tjera, si përshembull,aftësia për punë të përbashkët në grup dhe përshtatja e veprimeve individuale, zotësi në udhëheqjen e dialogut, shkathtësi në të dëgjuarit e tjetrit dhe diskutim pro dhe kundër,.....marrja e përgjegjësis për veprimet e veta ” (Kovačević, 2012:40).

Kovačević, shkathtësitë sociale ose kompetencën sociale i përkufizon si “...sjellje specifike të individit,dhe mënyra se si një individ i shfrytëzon të gjitha ato shkathtësi sociale në rrethin shoqëror dhe ndërveprimin shoqëror” (Kovačević, 2012:40).

Shkathtësitë individuale dhe sociale çdo individ duhet t'i zhvillojë nëpërmjet mësimi dhe aktiviteteve të ndryshme,në mënyrë që të jetë i gatshëm të mendojë dhe të zgjidhë problemet sociale.

Kovačević, 2012 në studimin e tij“Aktivitetet e organizatave ndërkombëtare në zbatimin e arsimit joformal në Malin e Zi, të zhvilluar me mësimdhënës rreth zhvillimit të shkathtësive personale dhe sociale, erdhi në përfundim se arsimtarët kryesisht janë të kënaqur me arritjen e të gjitha shkathtësive si: kënaqësia në punë, vetëbesimi, shkathtësitë

komunikative, ngjashmëritë, vetëdija mbi ekzistencën e fenomeneve të caktuara, vetëdërgjegjësimi, vetëreflektimi, mendimi kritik dhe qëndrimi pozitiv.

Në këtë studim “41.2 % e të anketuarve kryesisht ishin të kënaqur me shkathtësitë komunikative të arritura gjat trajnimeve; 40.1% e mësimeve kryesisht ishin të kënaqur me punën dhe vetëbesimin; 36.1 % ishin kryesisht të kënaqur me zhvillimin e vetëdijësimit të tyre mbi ekzistencën e fenomeneve të caktuara dhe 35.7% me mendimin kritik; 32.6% ishin për qëndrimin pozitiv dhe 31.3% për vetëreflektimin ” (Kovačević, 2012: 111).

Ndërkaq 14.9 % e mësimeve kanë theksuar se nuk e kanë arritur qëndrimin pozitiv dhe se 11.0 % e kanë arritur vetëdijen si shkathtësi sociale, kur “vetëdijësimi është aftësi e njohjes së vetvetes dhe identitetit vetjak, pra, që të jemi të vetëdijshëm mbi përparësitë dhe mangësitë tona, nevojat dhe motivimin. Vetëdijësimi është një shkathtësi kryesore, sepse nga ajo varet shkalla e vetkontrollit tonë ” (Kovačević, 2012: 111)

Autori nga ky hulumtim ka ardhur në përfundim se arsimtarët në përgjithësi, janë të kënaqur me zhvillimin e tyre individual, respektivisht në përfitimin e shkathtësive, të cilat i kanë arritur gjatë edukimit joformal, pra gjatë trajnimeve të ndryshme.

Sipas Kovačević, elementet të cilat mund të zbatohen nga edukimi joformal në atë formal nëpërmjet trajnimeve e seminareve të ndryshme janë përdorimi i formave dhe metodave të ndryshme pune gjatë procesit mësimor, punë individuale, grupe; puna e bazuar në projekte, komunikimi etj.

Motivimi për të mësuar

Motivimi për të mësuar është një ndër aspektet e rëndësishme, i cili duhet kultivuar gjatë procesit mësimor. Shoqëria e dijes ka parashtruar para vetës kërkesa të reja ku kërkohet zhvillim i shkathtësive dhe nxitje për rritje të ineresimit më të madh për të mësuar dhe fituar njohuri të cilat janë të nevojshme për jetën dhe arritje të sukseseve të dëshiruara. “Motivimi është forca jonë e brendshme, e cila na lëviz që të realizojmë qëllimet dhe të

kënaqim nevojat tona. Që të arrijmë sukses në cilindo segment të jetës sonë është i domosdoshëm motivimi” (Nikolić,2013:9).

Sipas, Maehr & Meyer “Motivimi është konstrukt teorik i cili shfrytëzohet që të sqarohet inicimi, drejtimi, intensiteti, ekzistenca dhe cilësia e sjelljes,veçanërisht sjellja e drejtuar nga qëllimi i caktuar” (Maehr & Meyer,1997:373).

Shumë studiuesë në hulumtimet e tyre e përqendrojnëvëmendjen e tyre në motivimin e nxënësve për të mësuar“... se nxënësi do të bëhet i motivuar të mësojë,çka do të ketë dobi më të madhe nga të mësuarit,kur sheh qëështë i pranuar nga nxënësit e tjerë në klasë dhe nga mësimdhënësi;....;kur është në gjendje që të realizojë me sukses kërkesat gjatë procesit mësimor dhe kur përjeton sukses në shkollë”(Lalić,2009:37).

Lalić-Vučetićnë studimin e saj “Mundësitë e zhvillimit të motivimit për mësim”ka ardhur në përfundim se “mësimdhënësit e vërejnë fenomenin e motivimit si një mori lidhjeje direkte dhe indirekte ndërmjet metodave mësimore,personalitetit të mësimdhënësve,mënyrës së komunikimit të mësimdhënësve dhe nxënësve”(Lalić-Vučetić, 2016 :8).

Sipas saj, ekzistojnë dallime në qëndrimet e mësimdhënësve dhe nxënësve sa i përket motivimit. Sipas nxënësve për të ardhur deri te motivimi “....mësimdhënësit duhet t’i mësojnë nxënësit se si të mësojnë dhe t’i njohin me teknika të ndryshme të të mësuarit... të sjellin diçka të re dhe të ndryshme ..., ndërsa mësimdhënësit mendojnë se” nxënësit janë më shumë të motivuar për aktivitete të tjera jashtë shkollore ” (Lalić-Vučetić, 2016 :5 :11).

Më tej ajo thekson se “shumica e mësimdhënësve e përshkruajnë motivimin si forca nisëse....orientim në arritje të njohurive dhe shkathtësive në mësimdhëniesi dhe orientim në vetzhvillim të nxënësit, e cila vjen nga jashtë” (Lalić-Vučetić, 2016 :5).

Sipas saj, nxënësit e shohin motivimin në “ nevojën e përsosjes së mësimdhënësve dhe përparimit të praktikës së tij në përputhje me një mori njohurish teorike dhe praktike mbi mundësitë e zhvillimit të motivimit për të mësuar” (Lalić-Vučetić, 2016 :5)

Lalić-Vučetić ka ardhur në përfundim se “Nxënësit vërejnë se në mësimdhënie është e domosdoshme që mësimdhënësit të zbatojnë mënyra të zakonshme dhe të reja pune, çka për nxënësit nënkuptohet angazhim në aktivitete, të cilat do t’u ofrojnë atyremundësi të vënë në dukje kreativitetin, diskutimin, shkëmbimin e mendimeve, si edhe mundësi për të parashtruar pyetje”(Lalić-Vučetić, 2016 :12).

Studiuesja Lalić -Vučetić në hulumtimin e saj të disertacionit të doktoraturës “Veprimet e mësimdhënësve në drejtim të motivimit të nxënësve për mësim” në bazë të rezultateve të fituara, ka ardhur në përfundim se ”...më shumë vëmendje duhet kushtuar e në aftësimin e mësimdhënësve në kuadër të formimit të tyre fillestar dhe gjatë zhvillimit profesional në praktikë, në mënyrë që të mund t’i njohin dimensionet dhe karakteristikat e motivimit për mësim”(Lalić-Vučetić, 2015:307)

2.4.Kompetencat kyçe në zhvillimin profesional dhe edukimin gjatë tërë jetës

Shoqëria globale ka ndikuar që në fushën e arsimit të nxiten shumë reforma dhe politika arsimore për një arsim të gjithanshëm cilësor, efektiv e fleksibël, në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë. Kështu Komisioni Evropian në dokumentin e tij për arsimin (“Key Competences for Lifelong Learning – A European Reference Framework”) ka ofruar tetë kompetenca kyçe që duhet t’i arrijë çdo individ “si pjesë e të mësuarit "gjatë tërë jetës së tij.“Kompetencat janë quajtur kyçe, sepse konsiderohen të nevojshme për të gjithë individët në shoqëri, të bazuar në njohuri dhe parakushtin themelor për arsimim gjatë gjithë jetës”(Instituti për shoqëri hulumtuese, 2006-2007:7).

Rankovič, në lidhje me këtë dokument veçon se “Sipas tij, kompetencat përkufizohen si harmoni e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, dhe kompetencat kryesore janë ato ndërmjet tyre, të cilat secili prej nesh duhet t’i arrijë gjatë arsimit formal të detyrueshëm dhe më tutje i zhvillon gjatë arsimit joformal”(Rankovič, 2007:8)

Më tej thekson se “ Të gjitha kompetencat konsiderohen se në raportin mes tyre janë njësoj të rëndësishme, pamarrë parasysh se secila prej tyre i kontribuon suksesit të

shoqërisë, e cila bazohet në dije. Disa kompetenca përputhen dhe ndërveprojnë njëra me tjetrën” (Ranković, 2007:9).

Tetë kompetencat kryesore që çdo individ duhet t’i arrijë për zhvillim profesional dhe përkufizimi i tyre për arsimim gjatë gjithë jetës që veçohen në dokumentin e Komisionit Evropian paraqiten më poshtë (Tabela 1).

Tabela 1. Pasqyra e tetë kompetencave kyçe dhe përkufizimi i tyre.

Kompetencat kryesore	Përkufizimi i kompetencave kyçe
Komunikimi në gjuhën amtare	Komunikimi është aftësi e hulumtimit dhe interpretimit të të menduarit, ndjenjës dhe faktit në të folur dhe të shkruar (dëgjimi, të shprehurit me gojë, leximit dhe shkrimit), aftësi e përshtatshme e ndërveprimit gjuhësor në distancë të plotë të kontekstit shoqëror dhe kulturor në arsimim dhe përsosje, në punë, në shtëpi dhe në kohën e lirë.
Komunikiminë gjuhë të huaja	Komunikiminë gjuhë të huaja në përgjithësi ndan shkathtësitë kryesore me kompetencë të komunikimit në gjuhën amtare; ajo bazohet në aftësinë që të kuptohen, të shprehin dhe përkthejnë mendimet, ndjenjat dhe faktet në formë gojore dhe të shkruar (dëgjimi, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit), në distancë të përshtatshme të kontekstit shoqëror në punë, në shtëpi, në kohën e lirë, në arsim dhe përsosje, në përputhje me dëshirat dhe nevojat e individit. Komunikimi në gjuhë të huaja kërkon edhe shkathtësi ndërmjetësimi dhe të kuptuarit

	brendakulturave.Shkalla e njohjes së gjuhëve do të jetë e ndryshme për secilën nga katër dimensionet(të dëgjuarit, të folurit, leximi dhe të shkruarit), për secilin nga gjuhët e huaja, e do të dallohen duke marrëparasysh rrethin gjuhësor dhe trashëgiminë e individit.
Kompetenca matematikoredhekompetencatthemelore në shkencë dhe teknologji	Kompetencamatematikore është aftësi e shfrytëzimit të mbledhjes,zbritjes,shumëzimit,pjesëtimit dhe thyesës, në llogaritjet mendore dhe të shkruarit që të zgjidhen një numër problemesh në situatat e përditshme.Theksi vihet më shumë në proces e më pak në vetë përfundimin; më shumë në vetë aktivitetin e më pakë në dije. Të shkruarit shkencor bazohet në aftësinë dhe gatishmërinë e përdorimit të metodologjisë, që të shpjegohet bota natyrore.Me kompetencë në teknologji mendohet të kuptuarit dhe zbatimi i asaj dije dhe metodologjie që të ndryshojë mjedisi natyror në përputhje me dëshirat dhe nevojat e njerëzve.
Kompetenca digjitale	Kompetencadigjitalepërfshin nevojënesigurtë dhe kritike të medive elektronike në punë,në kohën e lirë dhe komunikim.Këto kompetenca janë të lidhura me mendimin logjik dhe kritik,me nivel të lartë të shkathtësive të udhëheqjes së informacioneve dhe me shkathtësi të zhvilluara mirë. Në bazën e nivelit të shkathtësive informatike, komunikative

	përfshijmë përdorimin e teknologjisë multimediatike që të fitohen, vlerësohen, ushqehen, prodhohen, paraqiten dhe shkëmbehen informatat, që të mund të komunikohet dhe të merret pjesë në rrjetet nëpërmjet internetit.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë	Kompetenca e të mësuarit për të nxënë përfshin dispozicionin dhe aftësinë e organizimit dhe rregullimit të vetmësimit individual dhe në grupe. Ajo përfshin aftësinë e të vepruarit, udhëheqjes me kohën e vet, zgjidhjes së problemeve, përvetësimit, përpunimit, dhe vlerësimit të njohurive të reja, zbatim të njohurive dhe shkathtësive të reja në kontekste të ndryshme, në shtëpi, në punë. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë kontribuon dukshëm në udhëheqjen e karrierës së individit.
Kompetenca interpersonale dhe qytetare	Kompetenca interpersonale dhe qytetare ka komponenten aktive dhe pasive; përfshin edhe aftësinë e individit që t'i prekë vetë ndryshimet dhe aftësinë që të pranojë, përkrahë dhe përshtatet me inovacionet të cilat i sjellin rrethanat e jashtme. Kompetenca interpersonale dhe qytetare përfshin marrjen e përgjegjësie për hapat pozitiv apo negativ, zhvillim të vizionit strategjik, qëllimeve të parashtruara dhe realizim i tyre si dhe motivimi që të arrihen.

Kompetenca kulturore	Kompetenca kulturore bazohet në të shprehurit e të kuptuarit të rëndësive së ideve kreative, përvojat dhe emocionet në të gjitha dallimet në media të ndryshme, duke përfshirë edhe të shprehurit muzikor, trupor, letërsinë dhe artet vizuale.
----------------------	---

Burimi: Korniza evropiane e rekomanduar, dhjetor 2004 (Pavić, Z, 2004 : 12-13). Përkthyer për nevojat e Agjencisë për Edukim dhe Arsimim, Zagreb.

Sipas Lalović, “Secila nga kompetencat kyçe apo themelore, është paraqitur si gërshetim i njohurive specifike, shkathtësive dhe vlerave të cilat gjatë shkollimit duhet t’i zhvillojë nxënësi” (Lalović, 2009:45-46).

Në konferencën „Roli i arsimit joformal dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës në zhvillim të kompetencave kyçe“ e mbajtur në nëntor të vitit 2011 në Mal të Zi, është diskutuar rreth arsimit joformal dhe efektit të tij në zhvillim të kompetencave kyçe dhe është arritur në përfundim se “...është e nevojshme të lidhet AJF dhe AF në mënyrë që të kemi të mësuarit veprues; që AJF të sigurojë zhvillim të shkathtësive personale dhe sociale, qëndrimeve, njohurive të cilat shikohen në përsosjen e aftësive komunikative” (Qendra për trajnim dhe arsimim, 2011).

Shumë hulumtime që janë bërë në lidhje me kompetencat kyçe tregojnë se kompetenca e interpersonale dhe qytetare është më pak e zhvilluar dhe se kjo kompetencë është e një rëndësie të veçantë, që të rinjtë të përgatiten për tregun e punës. Një hapësirë të veçantë shumë studiues i japin kompetencës në teknologji informatike, sidomos në teknologjinë e të mësuarit. “kompetencat e mësimeve për teknologji të reja, veçanërisht teknologjinë e të mësuarit, ofrojnë mundësi të reja për përparimin e metodave ekzistuese studimore dhe të mësuarit në kornizën e arsimit global” (Ajanović, Dž & Ajanović, E, 2009:293).

2.5. Gërshetimi i tre formave të edukimit

Sipas Smith, M. K. (2002), arsimi përmbledh arsimin formal, joformal dhe informal. Arritja në filozofinë triptike ishte rrjedhojë e konceptimeve arsimore të Coombs me Prosser dhe Ahmed, që në vitin 1973, kur ata jepnin këto përcaktime:

Arsimi formal përfshin sistemin hierarkik të strukturuar që mbështetet nga shteti dhe që vlerësohet në mënyrë kronologjike që nga shkolla fillore deri në universitet, që përfshin përveç studimeve të përgjithshme akademike një shumëllojshmëri programesh dhe institucionesh të specializuara që punojnë me kohë të plotë për trajnimin teknik dhe profesional të individit. Arsimi formal është gjithmonë i organizuar dhe strukturuar, bazuar në të mësuarit me objektiva. Nga pikëpamja e nxënësit ajo është gjithmonë e qëllimshme: dmth objektivi eksplicit është nxënësi e qëllimi që ai të fitojë njohuri, aftësi dhe kompetenca. Shembull tipik është të mësuarit që zhvillohet në kuadër të trajnimit arsimor dhe të sistemit të trajnimit ose në vendin e punës fillestare që organizohet nga punëdhënësit.

Arsimi joformal përfshin çdo aktivitet të organizuar arsimor jashtë sistemit formal - qoftë kur veprojnë veçmas apo si një veprimtari më e gjerë bashkëpunimi, që synon t'u shërbejë qartë individëve që duan të mësojnë mbi bazën e objektivave të të mësuarit. Të mësuarit joformal përgjithësisht renditet midis dy mënyrave të mësuarit: formal dhe informal. Megjithatë, për shumicën e autorëve, duket qartë se të mësuarit joformal është mjaft i organizuar dhe mund të bazohet në objektivat e të mësuarit. Avantazhi i konceptit të të mësuarit joformal, ndërmjet dy formave formal dhe informal qëndron në faktin se ky lloj të mësuarit mund të kryhet me nismën e individit, ose si një produkt i veprimtarive më të organizuara. Kjo ndodh kur aktivitetet bazohen në objektivat e të mësuarit. Në disa vende pësia e të mësuarit në sektorin e arsimit për të rritur bie në mësimin joformal; në disa të tjeratë mësuarit për të rritur është formal. Parë në këtë mënyrë, të mësuarit joformal krijon një lloj fleksibiliteti midis të mësuarit formal dhe informal.

Disa karakteristika të arsimit joformal janë se ky lloj të mësuarit është dhe duhet të jetë i përcaktuar qartësisht, në mënyrë rigoroze të jetë veprues, duke qenë reciprokisht ekskluziv i institucioneve joarsimore; duhet të shmangë mbivendosjen me arsimin formal. Dallimi midis arsimit formal dhe joformal është kryesisht administrativ. Arsimi formal është i lidhur me shkollat dhe institucionet e trajnimit; arsimi joformal me grupet e komunitetit dhe organizatave të tjera; edukimi informal mbulon atë që mbetet, p.sh. ndërveprimet me miqtë, familjarët dhe kolegët e punës. (Coombs dhe Ahmed, 1974)

Arsimi informal konsiderohet si një proces i vërtetë i të mësuarit që ndodh në jetën e përditshme dhe që e shoqëron njeriun gjatë gjithë jetës, ku çdo individ përfiton qëndrime, vlera, aftësi dhe njohuri nga përvoja e tij dhe të tjerëve, nga ndikimet edukative dhe burime në mjedisin e tij apo të saj, nga familja dhe fqinjët, nga puna dhe loja, nga tregu, bibliotekat dhe masmedia. Të mësuarit informal nuk është i organizuar, nuk ka asnjë objektiv të caktuar në drejtim të rezultateve të të nxënies dhe nuk është i qëllimshëm nga pikëpamja e nxënies.

Shpesh është përmendur si të mësuarit nga përvoja ose vetëm si përvojë. Ideja është se fakti i thjeshtë i ekzistencës, vazhdimisht e ekspozon individin në situata të të mësuarit në punë, në shtëpi apo gjatë kohës së lirë. Ky aktivitet nuk është i strukturuar dhe zhvillohet jashtë sistemit formal. Dallimi kryesor midis arsimit formal dhe informal është fakti se i pari, drejtohet nga shteti dhe nuk është aq vullnetar, madje kryesisht është edhe pasiv, ndërsa rezultatet e edukimit informal në analizë të fundit varen nga veprimi i vullnetshëm individual, që është më së shumti aktiv për fatet e veprimtarisë dhe të jetës së tij.

Gjithsesi, këto përkufizime nuk nënkuptojnë kategori të ndara. Fordham (1993) vë në dukje:

“nëse shikohet kategorizimi nga afër, mund të ketë mbivendosje të konsiderueshme. Për shembull, mund të ketë probleme të rëndësishme rreth kategorizimit të aktivitetit arsimor lidhur me përfshirjen në grupe dhe shoqata; nganjëherë ai mund të jetë informal, në raste të tjera joformal dhe kur grupi është pjesë e një shkolle formale”.

Ashtu sikur trajtohen në këtë punim, ato duhen marrë në sinkron, në funksion të edukimit të rinjve, me mjete dhe forma, programe dhe projekte të ndryshme, që diku janë më vete dhe diku janë të koordinuara, me pikësnyime dhe objektiva të përbashkëta.

Edhe në rastin e edukimit informal, që nuk është i strukturuar, institucionet shoqërore, sikurse janë mediet, familja, feja,..., bëjnë kujdes që të respektohen të drejtat e nxënësve dhe veprimtaria e tyre të mos cenohet, por përkundrazi, të kontribuojë në edukimin e fëmijëve. Programet e tyre nuk monitorohen dhe vlerësohen nga institucione arsimore, por nga standardet e qytetarisë dhe të zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve.

Edukimi është një proces i pandërprerë, që zgjat gjatë gjithë jetës. Sinkronizimi që në shkollë i formave të ndryshme të edukimit qytetar dhe më vonë edhe profesional krijon mundësi për të zhvilluar edukimin gjatë gjithë jetës, për trajnim, për përmirësimin e kualifikimit dhe rikualifikimit profesional, për përmirësimin profesional nëpërmjet institucioneve të edukimit joformal, sikurse janë OJF dhe institucione të tjera të interesuara për zhvillimin në proces të punonjësve të tyre. “Arsimi i tërësishëm përfshin, pra, tri forma të lidhura ndërmjet tyre: arsimin formal, joformal dhe informal.....Arsimi formal, joformal dhe informal ndërmjet tyre gërshetohen, plotësohen dhe kushtëzohen”(Mikanović, 2014:389).

Flitet shumë për të mësuarit në shkollë dhe jashtë saj, por shkolla nuk ka ende përvojë të mjaftueshme për të zbatuar forma të ndryshme edukimi, për të zbatuar procedura dhe metoda efikase. Ndërsa në mësimin e në vlerësimin joformal dhe arsimin formal, këto veprimtari, poashtu trajtohen teorikisht, në kuptimin e rëndësisë që ka puna me nxënësit, por ende nuk po gjenden pika suksesitë qëndrueshme. Prandaj rëndësia që ka trajtimi i kësaj çështjeje jo vetëm me mënyrat e edukimit formal por edhe atij jo formal, vazhdon ende si interes hulumtues teorik apo edhe si praktikë.

Një varg studiuesish në punimet e tyre kanë shpjeguar rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe produktin e bashkëpunimit, sikurse janë (Berger, Luckmann, 1999; Zuzevičiūtė, 2008, Teresevičienė, Zuzevičiūtė, 2008). Ata vënë në dukje se të mësuarit në mënyrë joformale dhe informale përbën pjesën më të madhe të mësuarit, por kjo mbetet

ende në nivelin e diskursit politik, si iniciativë e veçantë, e pazbatuar si praktikë me bazë ligjore. Prandaj, këto mjedise nuk mund të konsiderohen si mjedise për mësim.

Çertifikimi i arritjeve të të mësuarit joformal është një proces gjatë zbatimit të të cilit legjitimohen jo vetëm arritjet individuale të një personi, por edhe sferat e mjedisit të të mësuarit, në mënyrë joformale dhe informale. Përpyekjet janë për të legjitimuar fenomenin dhe produktet e tij.

Duke qenë se tregu i punës ka kërkesa për punonjës të kualifikuar dhe shkolla ka kufizimet dhe dobësitë, që janë evidentuar, atëherë përfaqësuesit e tregut të punës marrin pjesë në trajnimin e të rinjve, duke kontribuar në krijimin e standardeve. “Ata i dinë kërkesat specifike të vendeve të punës dhe mund të përshkruajnë kompetencat në nivelet e nevojshme dhe ndihmojnë në zhvillimin e procedurave të vlerësimit (Stasiūnaitienė, 2006).

Edhe në Kosovë, punëdhënësit duan të marrin më shumë mundësi për të kontribuar dhe të kenë ndikim në sistemin e arsimit formal, që reflektohet dhe në krijimin e panaireve, ku rakordohen interesat e përbashkëta midis sistemit arsimor dhe tregut të punës. Për të kënaqur nevojat e tregut të punës, vetë sistemi arsimor ka nevojë për të zbatuar qasje fleksibile dhe transparencë. Mjedisi mësimor lypset t’i përshtatet politikave të koordinimit të të mësuarit joformal dhe informal, duke vlerësuar arritjet (Zuzevičiūtė, 2008).

Nevoja për të transferuar aftësitë nga tregu i punës në sistemin e arsimit po merret gjithnjë e më shumë në konsideratë. Njohja dhe vlerësimi i arsimit joformal dhe informal është jashtëzakonisht i rëndësishëm për njerëzit që nuk mund të përfundojnë arsimin e lartë për shkak të problemeve financiare, presionit që ushtron tregu i punës, për të thithur të rinjtë mbi bazën e kompetencave profesionale.

Arsimi joformal i jep dimensionit të arsimimit një dimension më fleksibël, pasi krahas koncepteve të teorive dhe metodave mbi arsimin formal zhvillohen edhe aspekte të arsimit joformal. Mjedisi mësimor, jo vetëm në kuptimin retorik, por edhe praktik shtrihet përtej mureve të shkollës, ku krahas institucionit të shkollës dhe piramidës arsimore zyrtare zhvillohen në gjerësi dhe cilësi edhe institucionet e arsimit joformal. Shkolla bëhet realisht

pjesë e komunitet, krijohen hapësira për të zhvilluar konkretisht të mësuarit me bazë kompetencat për jetën. Arsimimi përshtatet me nevojat dhe kërkesat e zhvillimit të faktorëve ekonomiko-social. Individi plotëson gjithnjë e më mirë nevojën për qytetari dhe profesion si dhe kërkesat publike, në kushtet e zhvillimit global që e bën një shoqëri më konkurruese në tregun e gjërë që shtrihet përtej kufijve dhe standardeve të një vendi.

Si rezultat, nevoja për ndërthurje të edukimit formal dhe atij joformal është e një rëndësie të veçantë për nxënësit, mësimdhënësit dhe tërë shoqërisë, e që përbën thelbin e zhvillimit të arsimit dhe zhvillimit individual, social dhe profesional.

Ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i hulumtimeve, të cilat ndërthurjen e edukimit formal me atë joformal e shohin si një mundësi të mirë që të kemi cilësi në arsim.

Nëpërmjet kësaj ndërthurjeje, sikurse nxënësit edhe mësimdhënësit arrijnë dhe përvetësojnë njohuri dhe shkathtësi individuale dhe grupore, çka krijon kushte për përgatitje më të mirë për punën dhe jetën.

Natyrisht, edukimi formal dhe joformal nuk zhvillohen të ndara nga njeri tjetri dhe nuk janë në kundërshtim me njëri tjetrin, pasi, sikurse u shpjegua, shkolla është pjesë e shoqërisë dhe shoqëria, në kushtet aktuale angazhohet për edukimin e nxënësve si qytetarë dhe profesionistë. Ata dallojnë për nga natyra, konceptet, fokusimi, burimet dhe mjetet që përdoren; koha, zbatimi i rregullave dhe normave, përdorimi i metodave dhe teknikave të mësimi, aftësitë organizuese, mënyrat e kontrollit, përgjegjësia, detyrimet e sanksionet.

“Si përshkak të ngjashmërive ashtu edhe përshkak të dallimeve, të cilat ekzistojnë, përshkak të arritjeve teknologjike që sjellin njohuritë e tanishme, është e nevojshme t’i bashkojmë praktikisht, sepse teoritikisht janë të bashkuara në konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës”(Kovačević, 2012: 22).

Më tej vlen të theksohet se me punën e vazhdueshme, shkathtësitë, vetëmësimi dhe me vetë aftësim të njohurive, individi mund të arrijë njohuri dhe shkathtësi shtesë në stërvitjet, seminarët, trajnimet e arsimit joformal dhe me këtë të arsimohet për punë të caktuara apo të aftësohet dhe përparojë në profesionin e tij”(Kovačević, 2012: 22-23).

Ndërthurja e këtyre aspekteve të edukimit është edhe në fokus të këtij punimi, ndaj për të evidentuar punën që bëhet me forma të ndryshme për edukimin e nxënësve të shkollës së mesme në Kosovë. Komisioni Evropian në raportet e tij shqyrton dilemën dhe zgjidh pyetjen: “si të lidhim nevojën për shkallën e lartë të formalizimit të dijeve, të cilat ofrohen dhe arrihen nëpërmjet arsimit joformal me karakterin joformal të vetë arsimit joformal, i cili mbështetet në pjesëmarrjen, vullnetarizmin, por edhe në spontanitetin e tij”(CEC, 2001:17 cituar nga Kovačević, 2012 : 30)

Më tej theksohet se, “ këtu nënkuptohet dëshira që arsimi joformal të inkorporohet në arsimin formal, por edhe frika që arsimi joformal të mos formalizohet dhe me këtë nuk humb specifikat e veta, edhe pse mendohet se “arsimi formal dhe joformal janë komplementarë, se bashkë-ekzistojnë. Elementet e njërit mund të gjenden në tjetrin”(Këshilli i Evropës, 2001:8 cituar nga Kovačević, 2012: 30).

Ndërthurjen e dy formave të të mësuarit; formal dhe joformal, shumë studiues e shohin si nevojë të domosdoshme dhe një mundësi të mirë për një arsim cilësor e efektiv, i cili do të ndikonte në zhvillimin e personalitetit dhe njohurive të cilat janë të nevojshme për jetën. Megjithatë, përkundër shumë dilemave mbi nevojën e kësaj ndërthurjeje shumë studiues të kësaj fushe mendojnë se kjo ndërthurje do të sillte cilësi gjatë procesit edukativ dhe zhvillim të përgjithshëm të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Me anë të kësaj ndërthurjeje, në masë të konsiderueshme do të rritet vetëdija, vetëbesimi, motivimi për punë të pavarur dhe një komunikim më efektiv në mes faktorëve të lidhur me shkollën, por edhe të bashkësisë ku jeton dhe vepron individ.

Në ndërveprim të këtyre dy formave të edukimit, padyshim janë vetë mësimitdhënësit ata të cilët vazhdimisht do të zhvillohen dhe të gjitha njohuritë e trashëguara nga trajnimet,seminaret e ndryshme të fituara nga edukimi joformal, do t'i bartnin gjatë procesit mësimor tek nxënësit. Kështu, me përdorimin e metodave dhe teknikave të ndryshme të punës gjatë procesit mësimor dhe shkathtësive të fituara do të nxisnin nxënësit në punë të pavarur,të zhvillojnë të menduarit kritik, dhe kështu, ata do të motivohen më shumë për punë. Shoqëria e dijes sot kërkon mësimitdhënës, të cilët përparojnë duke u zhvilluar profesionalisht.

2.6. Karakteristikat e të mësuarit formal dhe jo formal

Edukimi formal dhe joformal si dy forma të të mësuarit, njëherazi janë të lidhura dhe dallojnë midis tyre. Në shoqërinë e sotme të zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, ato nuk mund të mbijetojnë njëra pa tjetrën edhe përkundër dallimeve të tyre. Këto dy forma të edukimit kanë karakteristikat e tyre, të cilat nëtërësinë e tyre paraqiten me anë të tabelës më poshtë (Tabela.2).

Tabela 2.- Karakteristikat e edukimit formal dhe joformal.

	Edukimi formal	Edukimi joformal
Prej kujt mësohet?	- nga mësuesi i cili është bartës i dijeve -marrëdhënia e mësuesit dhe nxënësit është një drejtimshe dhe vertikale	- mësohet nga një grup i tërë. marrëdhënie interaktive edukator-pjesëmarrës - marrëdhënia dydrejtimëshe dhe horizontale
Si mësohet?	- në mënyrë të institucionalizuar,shpesh i izoluar nga mjedisi	- nëpërmjet punës, praktikës, përvojës - e themeluar në nevojat konkrete jetësore dhe në kontaktet e afërta me bashkësinë - e themeluar në mësim përvojash
Çfarë mësohet?	- akademikisht i standardizuar - parimisht i përgjithshëm, - dije teorike, - e përcaktuar nga ana e Ministrisë së Arsimit	- dije praktike e zbatuare përshtatur nevojave individuale - zgjedhja është në atë i cili mëson

	- në shkollat profesionale-shkathtësi të nevojshme për punësim	
Sirealizohetdiplomimi?	- e themeluar në sistemin e titullit dhe statusit - diploma zakonisht jepet në fund të kryerjes së suksesshme të vitit apo të tërë shkollës	- çertifikimi merr vlera të veçanta pas diplomimit. - Çertifikatat u shtohen diplomave universitare
Sa zgjat të mësuarit?	- arsimi themelor nga 6-14 vjeç - arsimi i mesëm nga 14-18 vjeç - shkolla e lartë, fakulteti-mbi 18 vjeç - përvetësimi i njohurive është afatgjatë dhe i përgjithshëm	- zgjat tërë jetën - të mësuarit e shkathtësive të veçanta është e shkurtër dhe specifike
Anët pozitive	- idetyruar për të gjithë, në qëllim të arritjes së dijeve themelore apo arritjes së shkathtësive të caktuara - diploma e pranuar	- mund të fillohet kurdo në jetë - “rast i dytë” për ata të cilët nuk kanë mundësi për shkollim të rregullt -metodë fleksibile e punës. I përshtatshëm për nevojat individuale

Anët negative	- jep njohuri të përgjithshme, është e nevojshme të shkohet në specializim, arsimim alternativ apo edukim të posaçëm në mënyrë që ato njohuri të bëhen të përdorshme. - nuk kënaq nevojat e përfituesve; nuk është i përshtatshëm për të gjithë--metodë jo fleksibile e punës - mospranim i diplomave në shumë vende të jashtme	- nuk ka përparësi pranimi formal, por ai joformal
---------------	---	--

Burimi: Marjanovič (2003:11,12)

Studiues të ndryshëm përshkruajnë në mënyrë të veçantë karakteristikat e edukimit formal dhe joformal.

Studiuesi Markovič, lidhur me përshkrimin e karakteristikave të tri formave arsimore thekson se:

“...nuk janë aq të ndara, kështu që ekziston një numër i madh i aktiviteteve të cilat kanë karakteristika të dy apo edhe të tri sektorëve njëkohësisht. Kujtoni se sa arsimim in-formal keni marrë gjatë pushimit në shkollë apo pushimeve për kafe gjatë trajnimeve. A mendoni se a do ta kishit quajtur arsim jo- formal kursin e gjuhës, i cili është kryer jashtë sistemit formal, por me të gjitha karakteristikat e shkollës së vjetër tradicionale? A është arsim formal apo jo formal, trajnimi i mësimdhënësve, i akredituar nga ana e Ministrisë së arsimit, dhe i realizuar nga ana e organizatës, e cila nuk është në sistemin formal të arsimit, në hapësirat e ndonjë shkolle?” (Markovič, 2005:11).

Duke trajtuar problematikën e integritit të tre formave të edukimit formal, joformal dhe informal, Kuka vë në dukje se: “Të tri format e aktiviteteve arsimore të theksuara së bashku përbëjnë tërësinë homogjene, e cila quhet koncept i të mësuarit gjatë gjithë jetës” (Kuka , 2012 : 198).

Gjithashtu Loewen, nxjerr përkufizimet për tri llojet e edukimit duke u mbështetur në karakteristikat e këtyre tri formave të edukimit të paraqitura më poshtë (Tabela. 3).

“Të mësuarit formal organizohet në strukturën e formalizuar në institucione arsimore....qëllimet e të mësuarit janë të përcaktuara, rishqyrtohen dhe çojnë deri te certifikata ose diploma, e cila aftëson për arsim të mëtejshëm ose në punësim. Të mësuarit është i qëllimshëm dhe me vetëdije”(Loewen, 2011 : 12).

Mbi të mësuarit joformal thekson se “zhvillohet në organizatat apo grupet më pak të formalizuara. Kushtet e kornizës, strukturës, kohës e të mësuarit dhe forma e mësimdhënies mund të variojnë dhe rregullorja u përshtatet nevojave të grupeve të caktuara”(Loewen, 2011 : 12).

Ndërsa në lidhje me të zhvilluarit e të mësuarit informal thekson se “zhvillohet nga situata, respektivisht nga zgjidhja e një problemi, prandaj nuk është i qëllimshëm e vetëm nëpërmjet reflektimit sjell deri te procesi i të mësuarit. Ky lloj i të mësuarit është formë e të mësuarit individual dhe i lidhur për individin.” (Loewen, 2011 : 12).

Tabela3: Karakteristikat e tri formave të mësuarit.

	Të mësuarit formal	Të mësuarit joformal	Të mësuarit informal
Procesi i të Mësuarit	Ofertë pedagogjike e udhëzuar e cila është e planifikuar nga jashtë	Ofertë pedagogjike e udhëzuar, e organizuar sipas nevojës	E pa organizuar, në bazë të situatës

Përmbajtja e të Mësuarit	Nga teoria në praktikë	Nga praktika deri te teoria,qasje e situatave jetësore	Njohuri praktike, njohuri e përjetuar
Orientimi nga të dhënat hyrëse apo dalëse	Kryesisht e orientuar nga të dhënat hyrëse	E orientuar me vështirësi nga të dhënat dalëse	T ë dhëna dalëse
Qëllimi	I qëllimshëm	I qëllimshëm	Rrallë i qëllimshëm,iorientuar në zgjidhje të problemeve
Individualiteti	Të mësuarit në grupe të moshave të njejta	Të mësuarit në grupe të moshave të ndryshme	Proces individual i të mësuarit
Fleksibiliteti	Fleksibilitet i panjohur, përmbajtjet e të mësuarit janë të caktuara, mësimdhënia është e lidhur me vendin e shkollës	Fleksibilitet i lartë, përmbajtjet dhe vendi i të mësuarit janë fleksibël	Fleksibilitet shumë i lartë
Çertifikatat	Çertifikat e detyrueshme	Çertifikatat e mundshme	Pa çertifikata
Financimi	Bazohet në rregullat e shtetit, në varësi nga konteksti i shtetit kërkohet pagesa e shkollimit	Ofertat e institucioneve jo qeveritare,me ose pa pagesë	Nuk ështëi nevojshëm financimi

Qasja dhe Vullnetarizmi	Qasja e detyrueshme- detyrë e shkollës, Megjithatë në varësi të venditi kufizuar gjeografikisht,ekonomikisht Vjetërsia e moshës, gjinia, dhe plotësimi i kriterëve formale	Qasje vullnetare dhe me rregullore; ka kalueshmëri të ulët të parashtruar	Vullnetar, i mundshëm për të gjithë njerëzit
-------------------------	---	---	--

Burimi: Babette Loewen, Informalno i neformalno Ucenje-Analiza i perspektive.(Të mësuarit informal dhe joformal-analiza dhe perspektiva).

Gjithashtu Colley,H., Hodkinson,Ph.,dhe Malcom,J në kërkimin e tyre përshkruajnë karakteristikat kryesore të edukimit formal dhe jo formal të paraqitura nga Simkins (1977)në ”Edukimi formal dhe joformal në zvillimin ndërkombëtar”

Tabela 4. Karakteristikat e edukimit formal dhe jo formal sipas Simkins,1977.

	Formal	Jo formal
Qëllimi	Afatgjatë, i përgjithshëm I bazuar kredencialisht	Afat shkurtër,specifik Jo i bazuar kredencialisht
Koha	Cikël i gjatë Përgatitor Kohë e plotë	Cikël i shkurtër I përsëritur Me kohë të pjesshme
Përmbajtja	I fokusuar në të dhëna I standardizuar Klientela e caktuar nga kërkesat hyrëse	I fokusuar në përfundim I individualizuar Kërkesat hyrëse të caktuara nga klientelët

Dorëzim	I bazuar në institucion Mësimdhënësi në qendër I izoluar nga mjedisi Shoqëror Strukturë e ngurtë Resurseintensive	I lidhur me mjedisin Nxënësi në qendër I bazuar në komunitet dhe i orientuar drejt veprimit Strukturë fleksibile Resurse të ruajtura
Kontrolli	I jashtëm Hierarkik	Vetëdrejtues Demokratik

Burimi: Informality and formality in learning: a report for the Learning and Skills Research Centre. (Helen Colley, Phil Hodgkinson, Janice Malcom, 2003: 20,21).

Nëstudimin e tij “Çka është joformale në edukimin joformal” Markovič veçon disa karakteristika nga shumë prej tyre, të cilat kanë dalë nga trajnimi i trajnerëve sipjesëmarrje vullnetare; zhvillimi personal dhe profesional; të mësuarit në grup dhe nga grupi; program i bazuar në nevojat e shoqërisë dhe pjesëmarrësve...” (Markovič, 2005:12).

Në pedagogjinë bashkëkohore, edukimi konsiderohet një proces i pandërprerë, që e shoqëron njeriun për gjatë gjithë jetës. Sinkronizimi që në shkollë i formave të ndryshme të edukimit qytetar dhe më vonë edhe profesional, krijon mundësi për të zhvilluar edukimin gjatë gjithë jetës, për trajnim, për përmirësimin e kualifikimit dhe rikualifikimit profesional, për përmirësimin profesional nëpërmjet institucioneve të edukimit joformal, sikurse janë OJF dhe institucione të tjera të interesuara për zhvillimin në proces të punonjësve të tyre.

“Arsimimi gjatë gjithë jetës nënkupton nivele të ndryshme të mësuarit formal, joformal dhe informal dhe shtrihet në shumë fusha: trajnimin e trajnerëve, shkathhtësitë themelore, integrimin e teknologjive informatike dhe komunikative, fleksibilitetin e sistemit se si ta bëjnë të mësuarit të mundshëm për të gjithë, mobilitetin, edukim qytetar etj” (Stojilovic, 2007: 4).

Flitet shumë për të mësuarit në shkollë dhe jashtë saj, por shkolla nuk ka ende përvojë të mjaftueshme për të zbatuar forma të ndryshme edukimi, për të zbatuar procedura dhe metoda efikase në vlerësimin joformal dhe arsimin informal. Po ashtu, trajtohet teorikisht rëndësia që ka puna individuale me nxënësit, por ende nuk po gjen zbatim rëndësia që ka trajtimi i kësaj çështjeje, jo vetëm me mënyrat e edukimit formal por edhe në ato joformal.

Një varg studiuesish në punimet e tyre kanë shpjeguar rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe produktin e bashkëpunimit, sikurse janë: Berger, Luckmann (1999); Zuzevičiūtė (2008), Teresevičienė, Zuzevičiūtė (2008). Ata vënë në dukje se të mësuarit në mënyrë joformale dhe informale përbën pjesën më të madhe të të mësuarit, por kjo mbetet ende në nivelin e diskursit politik, iniciativave të veçanta, duke mos u zbatuar me bazë ligjore në praktikë. Prandaj, këto mjedise të pa përcaktuara mirë nuk mund të konsiderohen si mjedise të përshtatshme për mësim. Çertifikimi i arritjeve të të mësuarit joformal është një proces i gjatë me zbatimin e të cilit legjitimohen jo vetëm arritjet individuale të një personi, por edhe sferat e mjedisit të të mësuarit, në mënyrë joformale dhe informale. Përpjekjet janë për të legjitimuar fenomenin dhe produktet e tij.

Në kushtet aktuale të demokracisë dhe të mjeteve të shumta teknologjike, arsimi është bërë gjithnjë e më shumë një fushë e hapur për ide dhe përvoja. Edhe në Kosovë, punëdhënësit duan të kenë më shumë mundësi për të kontribuar dhe të kenë më shumë mundësi për të ndikuar në sistemin e arsimit formal, që reflektohet edhe në lindjen e panairëve, ku rakordohen interesat e përbashkëta midis sistemit arsimor dhe tregut të punës.

Për të kënaqur nevojat e tregut të punës, vetë sistemi arsimor ka nevojë për të zbatuar qasje fleksibile dhe transparencë. Mjedi i mësimor lypset t'i përshtatet politikave të koordinimit të të mësuarit joformal dhe informal, duke vlerësuar arritjet (Zuzevičiūtė, 2008). Nevoja për të transferuar aftësitë nga tregu i punës në sistemin e arsimit po merret gjithnjë e më shumë në konsideratë. Njohja dhe vlerësimi i arsimit joformal dhe informal është jashtëzakonisht i rëndësishëm për njerëzit që nuk mund të përfundojnë arsimin e lartë për shkak të problemeve financiare, presionit që ushtron tregu i punës për të thithur të rinjtë mbi bazën e kompetencave profesionale.

Mikanovič mendon se arsimit formal është arsim institucional ku “arsimi formal kryesisht përfshin format e arsimit në institucionet shkollore dhe është i shkruar me plane dhe programe mësimore...Në arsimin formal njohuritë arrihen gradualisht...Arsimi formal nuk është diçka tjetër, por është proces i shkollimit”(Mikanovič, 2014:389).

Megjithkëtë, për arsimin joformal thekson se është “veprim shoqëror i organizuar, i cili kënaq nevojat plotësuese, shtesë dhe alternative të individit për të mësuar....Arsimin joformal mund ta kuptojmë si plotësim të arsimit formal; ai nuk ka nevojë të jetë i lidhur me sistemin formal të arsimit...duhet ta pranojmë si strategji arsimore në shoqërinë e dijes”(Mikanovič, 2014 :389-390).

Studiuesja Pavićević në hulumtimin e saj rreth dallimeve të edukimit formal dhe joformal në mes tjerash veçon se “edukimi formal dhe joformal dallohen sipas disa kritereve: sipas mënyrës së të mësuarit, sipas përmbajtjes së asaj çfarë mësohet, sipas kohëzgjatjes, sipas verifikimit”(Pavićević, 2015:108).

2.7. Institucionet edukativo-arsimore formale dhe joformale

Institucionet edukativo-arsimore formale luajnë një rol vendimtar në edukimin dhe arsimimin e të rinjve dhe si qëllim parësor kanë arritjen e cilësisë dhe përgatitjen e tyre në arritjen e vlerave qytetare duke aplikuar një edukim gjithpërfshirës. Ato në vazhdimësi po u nënshtrohen ndryshimeve, me qëllim të përshtatjes së tendencave aktuale të shoqërisë së globalizimit dhe mësimdhënësit me aftësimin e tyre, si faktor i përmirësimit dhe zbatimit të risive në edukimin dhe arsimimin e të rinjve. “Shkollat si institucione mësimore dhe edukative duhet të shkojnë drejt modernizimit, për edukimin dhe formimin e personalitetit krijues, i cili do të çojë përpara zhvillimin në të gjitha fushat ekonomike-shoqërore, teknike e kulturore që do të punojnë në tregun e lirë....” (Kraja, 2009:105).

Duke pasur parasysh rolin edukativ, arsimor, aftësues dhe shoqëror të shkollës, në shoqërinë e sotme, suksesi i shkollës dhe cilësia në mësim varen nga krijimi i kushteve të favorshme dhe ofrimi i fleksibilitetit për një edukim dhe arsimim cilësor. Sjellja e

inovacioneve, fryma demokratike, gjithpërfshirja, afirmimi i vlerave, motivimi dhe bashkëpunimi i mirëfilltë i faktorëve kyç të jetës dhe punës së shkollës, janë aspekte të rëndësishme për një organizim të mirëfilltë të shkollave bashkëkohore. “Ndryshimet në arsim dhe në institucionin shkollëimponojnë përmbajtje të reja, mënyra dhe modele të reja të punës, organizim dhe qasje të re” (Murati, 2009:74).

Institucionet edukativo-arsimore formale ofrojnë njërën nga format në të cilën zbatohet arsimimi gjatë gjithë jetës dhe gjithpërfshirja.

Institucionet e arsimit joformal janë qendra të rëndësishme edukimi, por jo gjithmonë mund të kënaqin nevojat e shoqërisë dhe të punëdhënësve. Mirëpo këto qendra janë motivuese dhe nxitëse për të rinjtë që të vazhdojnë shkollimin e tyre dhe të bëhen pjesë e shoqërisë. Institucionet joformale janë një mundësi e mirë për të gjithë, prandaj ato ofrojnë një arsimim gjithpërfshirës të mëtijshëm, aftësim të të rinjve për të arritur shkathtësi të nevojshme që të jenë konkurrues të tregut të punës duke afirmuar vlerat dhe qëndrimet e tyre.

Politikat arsimore në shoqërinë e globalizimit janë faktor kyç në organizimin e arsimit të orientuara drejt zhvillimit dhe ndërtimit të një arsimi modern. Qëllimi i politikave arsimore është zhvillimi i arsimit dhe zhvillimi i institucioneve arsimore. Ky zhvillim do të arrihet me zbatimin e reformave të atilla që sigurojnë efikasitet, cilësi në shkolla dhe përmbushje të standardeve duke u mundësuar një përfshirje të gjithanshme dhe barazi. “Politikat arsimore nuk qeverisin më me idenë e njeriut si ardhmëri, por me idenë e prodhuesit – fitimprurësit... Shkolla gjithnjë e më shumë është një organizatë, detyra e së cilës është të punojë me individët dhe t’i sjellë në nivelin e caktuar shkollor, që do të shprehet me diplomë si akt përfundimtar (Legrand, 1993:22).

Sipas mendimit të Ajanovič, “Politika arsimore është e drejtuar në zhvillimin e shkollës kreative-cilësore...” nga shkolla mësonjëtoje” deri te “shkollat e të mësuarit aktiv”. Shikimet bashkëkohore në të mësuarit e nxënësit janë të orientuara që duke hulumtuar të mësojë dhe duke mësuar të hulumtojë” (Ajanovič, 2009 : 286).

Bashkimi Evropian ka përcaktuar qëllim të vetin krijimin e një sistemi cilësor dhe efektiv arsimor me qasje për të gjithë, duke krijuar politika dhe hartuar dokumente të atilla arsimore, në të cilat parashtrohet edhe roli mbështetës dhe inkurajues i BE-së ndaj shteteve anëtare të këtij unioni. Arsimi si një ndër prioritetet zhvillimore të shoqërisë së sotme globale ka zënë një vend të posaçëm edhe në dokumentet ndërkombëtare.

BE me politikat arsimore dhe rolin konstruktiv mbështetës, inkurajues dhe të qëndrueshëm, po bën përpjekje të vazhdueshme për të ndërtuar një të ardhme më të mirë në Kosovë, e sidomos në fushën e arsimit, ku nuk mungojnë mbështetja e projekteve zhvillimore në arsim, në mënyrë që të sigurohet një sistem cilësor arsimor me të drejta të barabarta dhe me pjesëmarrjen e të gjithëve.

Këto politika arsimore të cilat nxisin proceset reformuese si në sistemin e arsimit ashtu edhe në institucionet edukativo-arsimore në Kosovë, pikë referuese kanë marrë dokumentet ndërkombëtare që përcaktojnë të drejtën dhe përfshirjen e barabartë të të gjithëve në arsim.

Kosova me hapa të sigurt dhe me vendosmëri po angazhohet që të ecë drejt rrjedhave arsimore evropiane e globale.

2.8.Globalizimi i edukimit dhe arsimit i mesëm në Kosovë

Me zhvillimin e shpejtë të shkencës dhe teknologjisë informative, shoqëria e sotme është përfshirë nga ndryshime të shumta në të gjitha sferat e jetës, si në atë ekonomik, shoqëror e veçanërisht në ndryshimet e sistemit arsimor dhe ndryshimet në shkollë. “Themeluesi i termit shoqëri e dijes është Daniel Bell(1999), i cili thekson se shoqëria e dijes është produkt ekonomik postindustrial, në të cilin rritet roli i shkencës, hulumtimit, teknologjisë dhe i zhvillimit themelor”(Pastuović, 2012:56).

Shekulli XX karakterizohet si shekull i ndryshimeve të shumta, sidomos në sferën e arsimit dhe kulturës. “Në fushën e arsimit dhe kulturës, ndikimi i globalizimit praqitet

veçanërisht në: (1) ndryshimet e sistemeve të arsimit; (2) ndryshimet në planet dhe kurrikulat mësimore, (3) financimi i punës së përgjithshme të shkollës, (4) ndryshimet në entet sociale, (5) në përgatitjen dhe punën e kuadrit mësimor dhe tjetër në shkollë” (Đordjević, B, 2009 :265).

Ajanović, thekson se sipas studiuesit të fushës së globalizimit Henvi, R. (1994)” ndryshimet themelore të cilat rrjedhin nga qasja e globalizimit në arsim kanë të bëjnë me kulturën e të shkruarit, të kuptuarit e kulturës së popujve të tjerë, të kuptuarit e pozitës së planetit, edukim të larmishëm në botë, njohje e dinamikës globale” (Ajanović, 2009:283)

Globalizimi si një fenomen mjaft i ndërlikuar në tërësinë e vet po ndikon në masë të madhe në proceset reformative arsimore duke u nisur nga procesi i ndryshimit të sistemit arsimor deri te ndryshimet në shkollë.” Kështu, globalizimi i arsimit me të gjitha dilemat dhe problemet, si provokim i të ardhmes ka dimensione të gjëra. Ai presupozon vendosjen e një koncepti botëror, një kornizë globale të sistemit i cili do të nxiste qasje shumëdimensionale të esencës së arsimit...” (Murati, 2004 : 455).

Globalizimi në masë të madhe po luan rol në zhvillimin e arsimit, në krijimin e politikave të reja bashkëkohore, që do të mundësonin një qasje të barabartë e gjithpërfshirëse. Po ashtu, trendi i globalizimit po nxit pjesëmarrjen e më shumë subjekteve, po i imponohet rritjes së përgjegjësisë të institucioneve edukativo-arsimore, gjë që do të ndikonin në përparimin dhe efikasitetin e shkollave drejt plotësimit të objektivave që i kanë parashtruar para vetes për arritje të cilësisë dhe standardeve në arsim.

“Globalizimi i arsimit është pikëpamje arsimore, që rrjedh nga fakti që njeriu bashkëkohor jeton dhe vepron në botën e cila dita ditës është globalizuar... arsimi i nxënësve u siguron qasje në mundësi të ndryshme, por edhe zhvillon kompetencat e reflektimit dhe shkëmbimit të vetqëndrimit...” (Cabezudo, 2008 : 10).

Qëllimet e edukimit global janë të shumta, e disa syresh synojnë “...stimulimin dhe motivimin e nxënësve dhe edukatorëve që tu përafrohen çështjeve botërore nëpërmjet të

mësuarit inovativ dhe pedagogjisë....nxitje të programeve dhe praktikave të edukimit formal dhe joformal,... duke kultivuar frymë” të përgjegjësise globale të qytetarit të botës” (Cabezudo, A, 2008:18).

Shoqëria e globalizimit para vetes ka parashtruar shumë kërkesa në drejtim të zhvillimit profesional të mësimeve, në mënyrë që çdo mësues të marrë njohuri të reja, që nëpërmjet ideve të reja, kreativitetit dhe metodave interaktive të përgatisin nxënësit për jetën dhe të formojnë kompetencat kyçe të nevojshme për zhvillimin e tyre, pastaj ”aftësim për metoda të reja pune në klasë; detyra të reja jashtë klasës;...; aftësim për zhvillim të kompetencave të reja dhe njohurive të reja tek nxënësit; zhvillim të profesionalitetit të tyre dhe teknologjisë informatike-komunikative”(Rozdevšek-Pučko, 2005:81, cituar nga Ajanović (2009:293).

Arsimi i sotëm në Kosovë po përfshihet në trendin e globalizimit, i cili me kërkesat e tij po na shpie drejt formimit të një sistemi modern botëror, duke ofruar standarde për një arsim bashkëkohor. Globalizimi si proces i pashmangshëm në arsim ka bërë që të shtrojmë para vetes nevojat për reforma në shkollë dhe përshtatjes së ndryshimeve globale në arsim. “Fenomeni i shoqërisë globale synon që dallimet në mes të mësuarit dhe punës moderne, institucioneve moderne dhe veprimtaritë e tyre, të jenë të kuptueshme dhe fluide.”(Mirović, 2010 :20).

Globalizimi si fenomen i ri luan një rol vendimtar dhe ndikues në reformat arsimore. Këto reforma kanë kontribuar në zhvillimin e demokracisë, në përgatitjen e të rinjve për jetëndhe punën në këtë shoqëri të dijes edhe përkundër shumë vështirësive dhe kushteve për një përfshirje të shpejtë në proceset globale të arsimit, duke ditur se rrethanat në të cilat punojmë dhe veprojmë në shkollat tona ndryshojnë shumë nga ato të vendeve të zhvilluara. Studiuesi Murati, synimin e reformës shkollore e sheh tek ”inkuadrimi i saj në proceset dhe vlerat demokratike e të qytetërimit perëndimor; që të bëhet konkurues me shkollën evropiane; efikasiteti dhe funksionaliteti i shkollës;.....modernizim të procesit të mësimit dhe të nxënies; përditësim të vlerësimit....”(Murati, 2004 :410).

Kovačević si qëllim të reformës shkollore veçon “.... elementet e rëndësishme të arsimit joformal inkorporohen në vetë sistemin e arsimit formal dhe me këtë e forcojnë dhe plotësojnë”(Kovačević, 2012 :12-13).

Hodžić (2010) rendit disa metoda të mësimdhënies dhe udhëheqjes, të cilat reformat arsimore i kërkojnë: (1) Përmirësimi i shkollave të cilat në mënyrë konstante arrijnë rezultate të dobëta në mënyrë që së pari të mbyllen dhe përsëri të hapen me personel të ri në udhëheqje, me drejtor të jashtëzakonshëm. (2) Krijim”i mentorit për të mësuar” që,në njërin anë ka rol këshillues në raport me nxënësit të cilët mungojnë nga shkolla dhe në anën tjetër rol këshillues për mësimdhënës në punën me nxënës të tillë. (3) Paguhet sipas rezultateve të arritura,që do të thotë se drejtori i shkollës mund të lejojë pagesë më të madhe për mësimdhënës të cilët janë kreativ,dinamik dhe të cilët arrijnë rrezultate të mira. (4) Udhëheqje me shkollat të trajtohet ndryshe,pra personat nga sektori privat mund të parashtrojnë kërkesë që të marrin udhëheqjen në shkollat, të cilat nuk arrijnë rezultate të mira”.

Edukimi global përqaset gjithnjë e më shumë me edukimin qytetar, për të formësuar individin e aftë për të punuar në situata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Po ashtu, në kushtet aktuale janë përcaktuar edhe synimet e standardet e edukimit global, nga ku orientohen dhe përfshihen edhe të rinjtë e Kosovës. Tek Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar, theksohet se“synimi është që zhvillimi i kompetencave për jetën dhe punën të udhëheqë procesin e zhvillimit të sistemit të Kurrikulës dhe përvojave të mësimdhënies dhe të mësimnxënies”(MASHT, 2011: 5).

Arsimi aktual në Kosovë po përfshihet në trendin e globalizimit, që me kërkesat e tij po na shpie drejt formimit të një sistemi modern botëror, duke ofruar standarde për një arsim bashkëkohor. Globalizimi si proces i pashmangshëm në arsim ka bërë që të shtrojmë para vetes nevojat për reforma në shkolla dhe përshtatjes së ndryshimeve globale në arsim. Këto reforma kanë kontribuar në zhvillimin e demokracisë, në përgatitjen e të rinjve për jetën dhe punën në këtë shoqëri të dijes, edhe përkundër shumë vështirësive dhe kushteve për një përfshirje të shpejtë në proceset globale të arsimit, duke e ditur se rrethanat në të

cilat punojmë dhe veprojmë në shkollat tona ndryshojnë shumë nga ato të vendeve të zhvilluara.

Deklarata e të Drejtave të Njeriut e shpallur në dhjetor të vitit 1948, në të cilën përcaktohen të drejtat për arsimim, sipas nenit 26, vë në pah se “ arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”. (Neni 26, pika 1,2 Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut,1948). Përcaktimi dhe zbatimi i bazës ligjore është një element i rëndësishëm e bazik për edukimin në të gjitha aspektet e tij.

Raporti i Këshillit për Arsimin në Këshillit Evropian për Objektivat e ardhshme konkrete të sistemit të arsimit dhe trajnimit (*The concrete future objectives of education and training systems*) i miratuar në shkurt të 2001 në Bruksel, në të cilin parashihet, “rritja e cilësisë dhe efikasitetit të sistemit të arsimit dhe trajnimit në BE, lehtësimi i pranimit të të gjithëve në sistemet arsimore dhe trajnuese dhe hapja e sistemit të arsimit dhe trajnimit ndaj botës më të gjerë”, (CFOETS, 2001), sigurisht, synon të gjejë shtrirjen e duhur edhe në Kosovë.

Kongresi evropian mbi edukimin global, në Mastriht (2002) në deklaratën mbi edukimin global në mes tjerash thekson se “edukimi global është edukim i cili ia hap njerëzve sytë dhe mendjen për realitetin e botës globalizuese dhe i nxit ata që të rivendosin botën me më shumë drejtësi, barazi dhe të drejta të njeriut për të gjithë” (Cabezudo, A , 2016 :64).

Gjithashtu aty theksohet se “edukimi global është kyç për të forcuar haptas përkrahjen e bashkëpunimit zhvillimor. Të gjithë qytetarëve nevojiten njohuritë dhe shkathtësitë, që të marrin pjesë dhe në mënyrë interaktive të kritikojnë shoqërinë tonë globale si qytetarë të fuqishëm të botës”. (Cabezudo,A , 2016 :18) .

Duke jetuar në një shoqëri të hapur e demokratike në Kosovë, mbi bazën e konceptimit ndërkombëtar, janë ndërmarrë një varg aktesh ligjore që rregullojnë sistemin arsimor, të cilat rregullojnë funksionimin e shkollës në sistemin parauniversitar me synim përgatitjen efikase të nxënësve për jetën. Midis tyre mund të përmendim:

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011, ku qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele (Neni 1, LAPR K, 2011).

Ligji për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës shtetërore, i miratuar më 2008. Ky projektligj përcakton rolin e provimit përfundimtar dhe provimit të maturës shtetërore.

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional të Kosovës, i miratuar më mars 2013, si qëllim ka përparimin e këtij segmenti duke qenë në përputhshmëri me kërkesat e shoqërisë së sotme.

Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, gusht 2011, rregullon themelimin, organizimin, vlerësimin dhe financimin e arsimit universitar dhe është në përputhje me Sistemin e Bolonjës, ku sipas këtij ligji” bartësit publik të arsimit të lartë janë universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë. Emërtimi i çdo bartësi publik përcaktohet nga Ministria në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe të kriterëve të publikuara. (Neni 8, LALRK, 2011)

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve, 2005, në nenin 2 mes tjerash thotë se “të mësuarit joformal” bazohet tek programet e mësimit, që dallojnë nga ato të përfshira në përkufizimin e mësimit formal në këtë ligj”(LAARR, 2005).

Po ashtu, qeveritë kanë hartuar dhe po zbatohen strategji efikase, të cilat mundësojnë përgatitjen e nxënësit si qytetar, sikurse është Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017, ku në këtë program zhvillimor, në suaza të misionit është përcaktuar roli i institucioneve arsimore, me qëllim “ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor të gjithë individëve duke kultivuar shprehi të nxënit për gjatë gjithë jetës dhe vlera të qytetarisë demokratike”(SZHAPK 2007-2017, 2007: 9).

Strategjia e Aftësimit Profesional 2012-2014 parasheh “zhvillim të aftësimit profesional”

Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar, 2011. Në këtë Kurrikul, mes të tjerash thuhet se “arsimi në Kosovë ka për qëllim zhvillimin e dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike” (KKAP,2011:15).

Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2010-2015, i miratuar në mars të vitit 2010, trajton gjithëpërfshirjen dhe si objektivi ka përcaktuar se “zhvillimi profesional i personelit edukativo-arsimor për arsim gjithëpërfshirës, përmirësimi i infrastrukturës fizike për shkollën gjithëpërfshirëse dhe ngritja e vetëdijes gjithëpërfshirëse janë aspirata të domosdoshme” (PSOAGJFNVAAPK, 2010:9).

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016, vend të posaçëm i ka kushtuar arsimin joformal. Në mes të tjerash veçojmë: “Janë disa ofrues privat ose institucione jofitimprurëse që ofrojnë trajnime të tilla për të rriturit, si për shembull Qendra aftësuese “Don Bosko”, “Eomen for Eomen International-Kosovë”, Agjencia e Kosovës për Promovimin e Punësimit (AKPP) ...” (PSAK,2011:35-36).

Mbi bazën e legjislacionit përkatës ndërtohet sistemi arsimor formal në Kosovë, që është i hapur, duke u bashkërenduar me arsimin joformal. Sistemi aktual përmban në vete të gjitha institucionet edukative-arsimore duke u nisur nga arsimi parashkollor, fillor, i mesëm i ulët, i mesëm i lartë dhe ai universitar, që synim kryesor kanë edukimin dhe arsimimin e fëmijëve duke praktikuar praktika të reja në aftësimin dhe zhvillimin e shkathtësive, që të jenë konkurrues për tregun e punës.

Natyrisht, shkolla e mesme është në përvijim të strukturave të mëparshme arsimore dhe cilësia e mësimdhënies dhe të nxënies varet edhe prej tyre. Sistemi i tanishëm arsimor ka një strukturë 5+4+3, i cili përfshinë gjashtë nivele të klasifikuara në bazë të klasifikimit standard ndërkombëtarë (International Standard Classification of Education ISCED 97). Struktura formale e këtij sistemi arsimor përbëhet nga edukimi parashkollor, edukimi dhe arsimi fillor, arsimi i mesëm i ulët, i mesëm i lartë dhe arsimi i lartë.

Veprimtaria e këtyre komponentëve të këtij sistemi kryhet në institucionet e arsimit formal parashkollor, institucionet fillore, institucionet e mesme dhe institucionet e arsimit të lartë – universitetet, të cilat mbikëqyren nga MASHT-i dhe administrohen derisa financohen nga Komuna.

Qëllimi i këtij arsimimi, i bazuar në aktet e organizatave prestigjioze ndërkombëtare, në legjislacionin e Kosovës dhe politikat arsimore që ndërmerren, është arsimimi i përgjithshëm që konsiston në zhvillimin sistematik të gjithanshëm të të rinjve dhe përgatitje adekuate për të vazhduar arsimimin e mëtejshëm në zhvillimin e ndjenjës për liri dhe barazi, zhvillim individual, zhvillimin e aftësive të tyre në këtë shoqëri të sotme ekspansive dhe demokratike.

Veprimtaria edukativo-arsimore në përmbajtjen e vet përfshin mësimin i cili realizohet në bazë të planeve dhe programeve mësimore, të përpiluara nga MASHT. Për nxënësit me vështirësi në të nxënë këto institucione edukative-arsimore mundësojnë inkuadrim në procesin mësimor.

Proceset demokratike kanë ndikuar në ndryshimet edhe në arsimin fillor, me synimin drejt një zbatimi të programeve efektive e cilësore; të metodologjive bashkëkohore që nxitin interesimin dhe kureshtjen për mësim tek nxënësit; një përfshirje të prindërve në jetën e shkollës dhe një vlerësim të brendshëm e të jashtëm në përputhje me standardet ndërkombëtare. Po ashtu, në shkollat fillore është duke u zbatuar procesi i vlerësimit të jashtëm- testi i arritjeve pas mbarimit të klasës së pestë dhe të nëntë, i cili filloi në vitin 2002- 2003.

Arsimi i mesëm i lartë i cili i takon nivelit 3, realizohet në shkolla të mesme- gjimnaze publike dhe private dhe në shkolla profesionale të profileve të ndryshme, si shkollat teknike, bujqësore, mjekësore, ekonomike, kimiko-teknologjike dhe shkolla të artit dhe muzikës si dhe shkolla speciale për nxënës me nevoja të veçanta ,nëpërmjet planeve dhe programeve të profileve përkatëse. Shkolla e mesme si një institucion arsimor përgatit të rinjtë për arsimim të mëtejshëm dhe përfitim të dijeve dhe aftësive që të jenë në hap me kohën dhe të jenë pjesë e tregut të punës..

Ky arsimim nuk është i detyruar, por parashikohet të jetë i deturuar; zgjat tre vite dhe përfshin fëmijët e moshës 15 deri 18 vjeç. Arsimi i mesëm është i rregulluar me Ligjin për Arsimin Parauniversitar 2011, ku në mënyrë të qartë rregullon organizimin dhe udhëheqjen e arsimit dhe aftësimit parauniversitar, themelimin e institucioneve arsimore, përgjegjësitë e institucioneve arsimore, ku secili institucion duhet të formojë Këshillin drejtues, Këshillin e nxënësve dhe Këshillin e prindërve.

Shkollimi i mesëm në instancë të fundit kryhet me konceptin e maturës shtetërore, e cila ka nisur të aplikohet në Kosovë që nga viti 2006, dhe organizohet për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të larta. Matura shtetërore është e rregulluar me Ligjin për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës në Kosovë, 2008. Gjithashtu, në disa shkolla të mesme është duke u zbatuar pilotimi i Kurrikulës Bërthamë të Kosovës që nga viti 2013 - 2014. Si rrjedhojë e ndërthurjes së edukimit formal dhe joformal, programet e përgatitjes së nxënësve për jetën po përshtaten gjithnjë e më shumë duke u bërë atraktive, duke e zhvendosur qendrën e rëndësës nga njohuritë teorike në dijet dhe aftësitë për jetën në kushtet e Kosovës dhe më gjërë, me qëllim që nxënësit të përshtaten me tregun e punës dhe standardet e qytetarisë evropiane e më gjërë.

Arsimi dhe aftësimi profesional është një nga segmentet më të rëndësishme të arsimit të mesëm të lartë që ka për qëllim të përgatisë të rinjtë për tregun e punës, duke ofruar mundësi të marrjes së shkathtësive dhe aftësive, në mënyrë që në të ardhmen t'i zbatojnë ato. Po ashtu, përgatitja profesionale është një përvojë që mund dhe duhet të shfrytëzohet më mirë nga shkollat e mesme të arsimit të përgjithshëm, natyrisht duke ruajtur specifikat e secilit profil. Ky arsimim dhe aftësim realizohet në shkollat profesionale publike dhe private. Sipas faqes zyrtare të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës në shënimet mbi shkollat profesionale për vitin 2008 ishin 57 shkolla profesionale të tipave të ndryshme, ndërsa tanimë arsimi profesional organizohet në 61 shkolla, në mesin e të cilave kemi dy qendra të kompetencës.

Tashmë, arsimi profesional është një segment mjaft i rëndësishëm në sistemin arsimor në Kosovë, sepse ky arsimim umundëson të rinjtë të jenë pjesë e kërkesave globale dhe

konkurrues serioz në tregun e punës. Nga ana tjetër, arsimi profesional është një përvojë, që mund të krahasohet, duke përfituar nga njeri tjetri me arsimin e mesëm të përgjithshëm, në të gjitha nënndarjet e tij.

Të dhënat e institucioneve arsimore të mesme të larta, nxënësve dhe personelit arsimor për vitin akademik 2013-2014.

Si rrjedhojë e orientimit nga organizatat prestigjioze, legjislacionit për arsimin, politikave arsimore..... janë fuqizuar edhe institucionet arsimore, duke pasur në fokus përgatitjen e nxënësit për jetën. Nga të dhënat në Statistikat e Arsimit 2013-2014, të dala nga ASK 2014, për vitin shkollor 2013-2014, në këtë vit shkollor janë 131 shkolla të mesme me 3.472 paralele, prej tyre 1.311 paralele në arsimin e mesëm- gjimnaze dhe 2.161 në arsimin profesional. Numri i nxënësve në këtë shkallë të arsimit është 10.0437, prej tyre 44.637 në gjimnaze dhe 55.800 në shkolla profesionale. Numri i mësimitdhënësve është 6023 mësimitdhënës në arsimin e përgjithshëm, dhe 3692 mësimitdhënës në arsimin profesional.

Sikurse në të gjitha vendet e botës edhe në Kosovë një vend të posaçëm zë edhe arsimi privat në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Ky lloj arsimimi në Kosovë përfshin të gjitha nivelet e shkollimit dhe veprimtaria edukativo-arsimore e këtij arsimimi kryhet në institucione parashkollore private, institucione fillore dhe të mesme të ulta private, të mesme të larta private dhe në universitete private. Puna edukativo arsimore organizohet në mbështetje të sistemit publik, me një autonomi të plotë, me mbikëqyrje nga MASHT, që është përgjegjëse për liçencimin e këtyre institucioneve arsimore private, me plotësimin e kërkesave të kërkuara nga ky institucion.

Edukimi i të rinjve bëhet në mënyrë koherente në të gjitha fazat e shkollimit, kjo si për nivelin parauniversitar ashtu edhe atë universitar, me ç'gjë krijohen hapësira të gjëra për edukimin në vijimësi si dhe edukimin e të rinjve. Në arsimin e mesëm të lartë privat funksionojnë 15 shkolla të mesme private me 140 paralele, ku janë të përfshirë 2.601 nxënës dhe 351 mësimitdhënës; në mesin e tyre kemi 95 paralele në gjimnaze me 1832 nxënës dhe 263 mësimitdhënës dhe në shkolla të mesme profesionale 45 paralele, në të cilat

vijojnë mësimin 769 nxënës dhe me 88 mësimdhënës. Universitete private në Kosovë janë rreth 24 (ASK, 2014).

Gjendja e arsimit jo-formal në Kosovë.

Arsimi joformal si segment i rëndësishëm plotësues i arsimit formal luan rol vendimtar në zhvillimin e shoqërisë, por edhe shoqëria si tërësi ndikon dukshëm në të. Ky arsimim rrjedh nga nevoja e kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve globale në mbarë botën, me synimin për një arsimim gjatë gjithë jetës. Arsimi joformal në përmbajtjen e tij u ofron mundësi të rriturve që të aftësohen për punë dhe të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të ndryshme, që çojnë drejt zhvillimit personal të tyre. Arsimit jo formal në Republikën e Kosovës viteve të fundit po i kushtohet vëmendje e posaçme; organizohet edhe në kuadër të shkollave profesionale që ofrojnë programe aftësimi për të rritur.

Gjithashtu, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përpilon kurrikulat për arsimin joformal në gjuhën turke, kroate dhe atë boshnjake për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Në Kosovë ekzistojnë qendra të ndryshme trajnimit dhe aftësimi që ofrojnë arsim joformal si qendrat edukative-sociale, qendra e gjuhëve të huaja, qendra për aftësimin profesional, qendra rinore, qendrat rikrijuese, pastaj shumë organizata joqeveritare (OJQ), që ofrojnë programe të shumta të edukimit dhe trajnimit për të rriturit .

Sipas faqes zyrtare të Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sportit të Kosovës, “në Kosovë, rinia paraqet grupmoshën më të madhe të popullsisë me mbi 35% të moshës 15-24 vjeçare dhe mbi 65% nën moshën 30 vjeçare. Momentalisht sektori rinor në Kosovë, numëron rreth 150 organizata rinore, rrjete rinore me më shumë se 100 organizata dhe 50 qendra të rinisë.”

2.9. Arsimi dhe edukimi i mesëm në Republikën e Serbisë

Arsimi i mesëm në Republikën e Serbisë nuk është i detyrueshëm dhe shkollimi i mesëm zhvillohet në shkollat e mesme. Kështu në Buletinin 579 të botuar nga Enti Republikan i

Statistikave të Republikës së Serbisë, 2014, thuhet se “shkolla e mesme mund të themelohet si gjimnaz (i përgjithshëm dhe i specializuar), si shkollë artistike, si shkollë profesionale apo si shkollë e përzier (shkollë gjimnaz, profesionale apo artistike)” (ERISRS, 2014-RZSRS, 2014: 7).

Shkollimi i mesëm në gjimnaze është 4 vjeçar, ku mësimi organizohet me programe të përgjithshme; ai artistik gjithashtu zgjat katër vite, me organizim e programeve artistike, derisa arsimi i mesëm profesional zgjat tri deri katër vite dhe me mbarimin e shkollimit të mesëm nxënësit i nënshtrohen provimit të maturës. Mësimi organizohet në gjuhën serbe dhe në atë të komuniteteve.

Mbështetur në të dhënat e buletinit të Entit Republikan të Statistikave të Republikës së Serbisë, 2014 për vitin akademik 2013-2014, në arsimin e mesëm ka 498 shkolla të mesme, 10.846 paralele, me 270.356 nxënës, ku punojnë 30.060 mësime nxënës. Me orar të plotë pune janë 17061 mësime nxënës, si dhe ka 48 shkolla të mesme private.

Arsimi i lartë në Republikën e Serbisë mbështetet në Deklaratën e Bolonjës ku Republika e Serbisë është nënshkruese e kësaj Deklarate që nga viti 2003. “Implementimi i procesit të Bolonjës në arsimin e lartë në Serbi në mënyrë formale ka filluar nga viti akademik 2006-2007. Është vendosur një sistem i studimeve në tri cikle. Vlera e një viti studimesh është 60 ECTS pikë”(Jerkovič, 2011 : 187).

Veprimtaria e arsimit të lartë realizohet në institucione të larta si: universitete, fakultete, akademi të studimeve profesionale, shkolla të larta dhe shkolla të larta profesionale. Për implementimin e procesit të Bolonjës më vitin 2005 është miratuar Ligji mbi Arsimin e Lartë.

Në bazë të këtij ligji studime themelore organizojnë institucionet e shkollimit të lartë, të cilat zgjasin tri vite, derisa studime akademike organizojnë universitetet, fakultetet dhe shkollat e larta që zgjasin një apo dy vite, varësisht prej studimeve akademike. Mbështetur në projektin e financuar nga Bashkimi Evropian “Analiza e situatës mbi gjendjen në fushën e arsimit formal dhe joformal”, si dhe papunësia dhe trendet ekonomike në Republikën e Serbisë në vitin 2013” shprehin faktin se në Republikën e Serbisë gjatë vitit 2012-2013

kanë funksionuar 47 shkolla të larta publike dhe 18 shkolla të larta private, 95 universitete dhe fakultete publike, me synimin ndryshimin dhe avancimin e gjendjes.

Arsimi joformal në Republikën e Serbisë

Kohët e fundit po i kushtohet një vëmendje e posaçme edhe pse ende me kuptimin e plotë të fjalës nuk është duke u aplikuar plotësisht. Ky lloj arsimimi është një mundësi e mirë për, zhvillim individual, shoqëror; zhvillim profesional të të rriturve, duke ofruar kushte për arritje të shkathtësive dhe aftësive të tyre profesionale. Në projektin e financuar nga Bashkimi Evropian në Republikën e Serbisë” Analiza e situatës mbi gjendjen në fushën e arsimit formal dhe jo formal, papunësia dhe trendet ekonomike në Republikën e Serbisë në vitin 2013” në Republikën e Serbisë funksionojnë 500 deri 700 institucione që ofrojnë arsim joformal, ku konstatohet se “Serbia është një shembull paradigmatic, ku marrëdhënia ndaj arsimimit të të rriturve edhe sot tregohet me qëndrime pro dhe kundër”(PBE, 2013 : 19).

Arsimin joformal e rregullon Ligji për Arsimimin e të Rriturve (Zakon o obrazovaњe odraslih), i cili është publikuar në “Gazetën Zyrtare Të Republikës së Serbisë”, nr. 55/2013 ("Службеном гласнику РС", бр. 55/2013). Sipas nenit 2 të këtij ligji: “Arsimim joformal i të rriturve në kuptimin e këtij ligji janë proceset e organizuara të mësimi të rriturve në bazë të programeve të veçanta për arritjen e e dijeve, vlerave, qëndrimeve, aftësive dhe shkathtësive të drejtuar në zhvillimin personal të të rriturve, punë dhe aktivitete shoqërore”(LAR, 2013; ZOO, 2013).

Të gjithë të rriturit, të cilët ndjekin arsimin joformal nëpër institucione të ndryshme jo formale tu jepet mundësia që të kualifikohen dhe këto kualifikime të jenë të pranueshme gjatë tërë jetës.

KAPITULLI I III: METODOLOGJIA E STUDIMIT

3.1.Parashtrimi i problemit

Objekti kryesor i këtij studimi është të evidentojë në një plan të përgjithshëm aspektet kryesore të formave të edukimit në procesin mësimor dhe jashtë tij. Sa e motivojnë nxënësin, si ndikojnë këto mënyra edukimi veç e veç edhe në tërësi për të krijuar kuptimin holistik në përshtatje me filozofinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Një aspekt tjetër i studimit janë përpjekjet për të matur se sa efekte ka secila linjë e edukimit si dhe aspektet që duhen përmirësuar për të përsosur këto lidhje, me qëllim zhvillimin efikas të të gjithë procesit mësimor-edukativ. Për arritjen e objektivave të studimit u krye një vërtetim në terren nëpërmjet pyetësorëve dhe grupeve të fokusit, si për mësuesit, ashtu edhe për nxënësit e shkollave të mesme në komunën e Gjilanit dhe në komunën e Preshevës.

Të dhënat e përftuara mundësojnë analizën e kësaj dukurie mbi efikasitetin në procesin mësimor, për të krijuar një set elementesh bazë që mundësojnë të mësuarit, vetë-mësimin dhe vlerësimin e vetë individit si qytetar dhe profesionist në një drejtim të caktuar, si dhe për të deduktuar përfundime mbi strategjitë dhe përmirësimet që mund të jepen mbi këtë dukuri në aspekte të ndryshme.

Synimi: Evidentimi i efektit të ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal në përgatitjen e nxënësve të shkollave të mesme për jetën nëpërmjet studimit të qëndrimeve të nxënësve, mësimdhënësve, prindërve dhe aktorëve të shoqërisë civile të përfshirë në studim.

Trajtimi komplementar i edukimit formal dhe joformal si një instrument që mundëson konsolidimin qytetar të nxënësit në dimensionet e: (1) rritjes së cilësisë akademike, (2)

konsolidimit të vlerave individuale, (3) konsolidimit të vlerave sociale, dhe (4) sendërtimit të vlerave profesionale.

Nëpërmjet konceptit, shkolla si qendër komunitare dhe të ndërthurjes së edukimit formal me atë joformal, mund të realizohen synimet e edukimit të të rinjve për jetën në disa plane; në rrafshin personal të vlerësimit dhe vetëvlerësimit të dijeve; në rrafshin profesional mbi zhvillimin e kompetencave dhe strategjive të mësimdhënies me rrjedhojat përkatese; në kontekstin social, kulturor, politik mbi impaktin që ka shkolla në progresin kombëtar dhe global, në rrafshin qytetar në sinkron me kompetencat e sipërpërmendura të rinjtë të jenë aktiv në përvetësimin e dijeve dhe zbatimin e tyre në situata të ndryshme jetësore.

3.2.Hipotezat e studimit

Përcaktimi i hipotezave, pyetjeve kryesore e variablave, përbëjnë bazat e studimit. Trajtimi i literaturës dhe përvojave si dhe zbatimi i qasjes së kombinuar ka mundësuar trajtimin e problematikës së edukimit në aspektin holistik dhe të detajuar.

Hipotezat e studimit janë:

H₀. Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal nuk ka efekt të konsiderueshëm në edukimin qytetar të nxënësve të shkollës së mesme.

H_a : Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal ka një efekt të konsiderueshëm në edukimin qytetar të nxënësve të shkollës së mesme.

H₀₁-Nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në rezultatet ndërmjet qëndrimeve të nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve.

H_{a1}-Ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në rezultatet ndërmjet qëndrimeve të nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve.

H₀₂- Nuk ekziston korelacion i rëndësishëm statistikor në mes faktorëve në qëndrimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve të dy vendeve.

H_{a2}-Ekziston korelacion i rëndësishëm statistikor në mes faktorëve në qëndrimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve të dy vendeve.

H₀₃- Nuk ekziston marrëdhënie e rëndësishme statistikore gjinore dhe eksperiencë pune në vlerësimet e mësimeve dhe prindërve në raport me variablat e varura

H_{a3}- Ekziston marrëdhënie e rëndësishme statistikore gjinore dhe eksperiencë pune në vlerësimet e mësimeve dhe prindërve në raport me variablat e varura

H₀₄-Nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në qëndrimet e mësimeve, prindërve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në raport me gjininë dhe eksperiencën në punë.

H_{a4}-Ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në qëndrimet e mësimeve, prindërve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në raport me gjininë dhe eksperiencën në punë.

3.3.Pyetjet kërkimore

Si ndikon trajtimi komplementar i edukimit në përgatitjen e nxënësve të shkollës së mesme?

Në funksion të pyetjes kryesore janë detajuar pyetjet bazë të studimit, të cilat janë:

- 1 A ekzistonë dallim i rëndësishëm statistikor në mesataret aritmetike në rezultatet e dalura nga qëndrimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve të dy vendeve në raport me variablat e varura : bashkëstudimin institucional, motivimin, përkrahjen në mësim, zhvillimin individual dhe social, vlerat e punës tek nxënësi dhe ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal?
- 2 A ekziston korelacion në mes faktorëve në qëndrimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve?

- 3 A ekziston marrëdhënie e rëndësishme statistikore në rezultatet e faktorëve të dala nga qëndrimete mësimdhënësve, prindërve në raport me variablat e pavarur gjinia dhe eksperiencia në punë?
- 4 A ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në rezultatet e variablave të varur të dala nga qëndrimet e mësimdhënësve, prindërve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në raport me variablin e pavarur gjinia?

3.4. Metodatat e hulumtimit

Nisur nga postulati se nuk ka metodë shkencore të vetme universale në arritjen e objektivave të këtij studimi është përdorur metoda integrale, që ndërthur elemente të kërimit sasior, pyetësorët me mësues, nxënës dhe prindër me elemente të kërimit cilësor që janë intervistat me drejtues të institucioneve joformale. Kombinimi i metodave *sasiore* me ato *cilësore* sipas Thomas (2003) përbëjnë një qasje të kombinuar. Qasja e kombinuar ndërthur elemente të kërimit sasior, pyetësorët me elemente të kërimit cilësor që janë intervistat me mësues, nxënës e drejtues shkollash. Avantazhet e qasjes së kombinuar i kanë evidentuar studiues të shumtë dhe kjo qasje zbatohet në shumë studime të shkencave sociale ku kërkuesi është pjesë e hulumtimit.

Gjithashtu, Mathews & Ross, theksojnë se “të dyja qasjet mund të përdoren krah për krah njëra-tjetrës, ku secili lloj i të dhënave kontribuon ose për t’i dhënë përgjigje të njëjtës pyetje ose pyetjeve të ndryshme”(Mathews & Ross , 2010 :145).

Përdorimi i këtyre metodave ishte i domosdoshëm dhe me rëndësi për shpjegimin e problematikës së edukimit cilësor të të rinjve për jetën.

Metodologjia e përdorur në këtë punim bazohet në kombinimin e të dhënave parësore me ato dytësore. Literatura e përdorur vjen nga librat dhe kërkimet elektronike, ku evidentohen studime të ngjashme dhe burime të tjera.

Zbatimi i metodologjisë shkencore në punim i referohet metodave, teknikave, rregullave të kërimit, krahasimeve, arsyetimit mbi teoritë, idetë, konceptet, të cilat të marra në mënyrë koherente mundësuan shqyrtimin e temës për të arritur në gjetjet dhe përfundimet përkatëse. Studimi përbën një dizajn të qasjes së kombinuar me elemente të kërimit sasior dhe cilësor, të cilat u përdorën për të mbledhur të dhëna në disa shkolla të mesme të Kosovës, të cilat ushtrojnë aktivitet arsimor në rajone të ndryshme.

Studimi fokusohet në studimin e koncepteve, praktikave, metodave të edukimit formal dhe joformal në ndërthurjen e tyre, për të ndihmuar në zhvillimin e të rinjve, nëpërmjet integritit të natyrshëm dhe sistematik, që kontribuojnë për zhvillim të qëndrueshëm. Në punim kërkohet të shpjegohen konceptime të ndryshme dhe vlera që mësimdhënia dhe nxënia, prindërit dhe aktorë të shoqërisë civile kanë për të dy format e edukimit. Përzgjedhja e instrumenteve të mbledhjes së të dhënave të nevojshme mundësojnë për të kuptuar dhe analizuar përvojat personale, sociale e institucionale mbi të kuptuarit dhe zbatimin e formave të arsimit formal dhe joformal.

Materialet teorike dhe informacioni dokumentar mundësuan qartësimin e problematikës arsimore, që realizohet duke zbatuar në sinkron këto qasje edukimi. Kampionimi sipas Bryman (2001), është një procedurë në të cilën të dhënat mblidhen, fillimisht kodohen, e pastaj analizohen për të përcaktuar në rastin tonë gjendjen e zbatimit të arsimit formal dhe joformal në Kosovë. Në studim janë përdorur pyetësorë dhe intervista gjysmë të strukturuar për të evidentuar nivelin e përjasjes dhe zbatimit të edukimit formal dhe joformal në Kosovë. Analiza objektive dhe koherente mbi bazën e të dhënave ka gjeneruar informacione të dobishme, të cilat përdoren për të kuptuar marrëdhëniet ndërmjet arsimit formal dhe joformal në shkollat e mesme të Kosovës, sa dhe si mund të kontribuojnë këto dy qasje të integruara për zhvillim të qëndrueshëm.

Të intervistuarit ishin të interesuar dhe aktiv në ndërhyrjet për evidentimin e gjendjes konkrete në instituconet e tyre, që u bënë objekt studimi. Përveç intervistave, që u zhvilluan në gjysmën e parë të vitit 2016 me subjekte të ndryshme, kryesisht me aktorë të shoqërisë civile, për të përforcuar disa nga konceptet, u bënë edhe vërtetime, si dhe u bënë biseda me

aktorë të ndryshëm të përzgjedhur individualisht, të cilët janë angazhuar në veprimtaritë mësimore-edukative në ato shkolla. Të gjitha këto instrumente për mbledhjen e informacionit mundësuan mbledhjen e të dhënave prej përgjigjeve të pjesëmarrësve në anketim dhe të dhëna dytësore nga burime të ndryshme. Kësisoj, studimi bën një evidentim të detajuar të perceptimeve dhe praktikave, të koncepteve dhe veprimtarive institucionale që zhvillohen në kuadrin e ndërthurjes së edukimit formal me atë joformal dhe si mund të integrohen këto në mënyrë efikase për të përgatitur të rinjtë për jetën sipas standardeve bashkëkohore.

Zbatimi i koncepteve dhe praktikave të metodologjisë shkencore mundësoi, gjithashtu për të minimizuar ndikimin e paragjytimeve dhe konceptimeve subjektiviste, për të arritur në një produkt, që i përmbahet standardeve dhe kërkesave të një studimi. Metodologjia i përmbahet objektivit kryesor të studimit për të kontribuar në evidentimin e elementeve të përgatitjes joformale dhe perspektivën e zhvillimit të tyre në kushtet aktuale të shkollës dhe shoqërisë. Ashtu sikurse ka shkruar gjeniu i Rilindjes evropiane Leonardo da Vinci “shkencat janë pa vlerë dhe plot gabime nëse nuk lindin dhe nuk testohen nga përvoja, që është nëna e të gjitha sigurive”.

Si instrument matës i përshtatshëm për zbatim është përdorur pyetësori. Përmes pyetësorit janë grumbulluar të dhënat individuale, si perceptimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve. Grumbullimi i të dhënave përmes pyetësorëve na mundësoi zbardhjen e problemit dhe një vështrim kritik të tij. Sikurse qasja sasiore edhe qasja cilësore në këtë studim kishte specifikat e saj, nëpërmjet të cilave u njoh në mënyrë të detajuar problematika e këtij studimi.

Qasja cilësore mundësoi një qasje më të detajuar të problematikës. Pasi “qasjet cilësore i japin mundësi hulumtuesit të eksplorojë konceptet me pjesëmarrësit në hulumtim në mënyrë më të thelluar...” (Matthews & Ross , 2010 :145).

Për këtë studim është përzgjedhur qasje e përshtatshme, me qëllim të mbledhjes së të dhënave në përcaktimin e rolit dhe funksioneve të institucioneve edukativo-arsimore formale dhe joformale në shoqërinë e globalizimit, plotësimin e pyetësorëve nga ana e

mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, si dhe në zhvillimin e intervistave me drejtues të institucioneve joformale. Më poshtë paraqitet përmbajtja e pyetësorit me subjekte të ndryshme nxënës, mësues, prindër dhe pyetjet e intervistës që do të zhvillohet me punonjës të organizatave të shoqërisë civile.

Qëllimi pretendonte që pyetësorët dhe intervistat të jenë në sinkron për të evidentuar punën që bëhet me nxënësit e shkollës së mesme nëpërmjet edukimit formal dhe informal si rrjedhojë e planeve dhe veprimtarive të përbashkëta institucionale nëpërmjet shoqatave, medias, socializimit, rrjeteve sociale, organizimit rinor, librit shkollor dhe jashtëshkollor, teatrit, kinemasë, etj.

Në grumbullimin e të dhënave rol të rëndësishëm luan edhe teknika *kërkimore e intervistës*; sipas Muratit (2004), intervista ka për qëllim kryesor njohjen dhe zbulimin e qëndrimeve të intervistuarve.

Gjithashtu, Matthews & Ross,(2010)vënë në dukje se intervistat janë mjet kryesor dhe mundësi e mirë për të mbledhur informacionet e dëshiruara të hulumtuesit nga ana e pjesëmarrësit. Gjatë intervistave iu kushtua rëndësi e veçantë komunikimit gojor, kjo jo vetëm në aspektin linguistik, por edhe të gjuhës si përmbajtje semantike e mendimit. Ashtu sikurse vënë në dukje studiues të kësaj fushe faktin se“fuqia shprehëse e gjuhës ofron burimin më të rëndësishëm të rrëfimit. Një karakteristikë thelbësore e gjuhës është kapaciteti i saj për të bërë përshkrime, shpjegime dhe vlerësime me një shumëllojshmëri pothuaj të pakufizuar për çdo aspekt të botës, përfshirë veten” (Hammersley & Atkinson,1995:126, cituar nga Matthews & Ross , 2010: 220).

Intervistat mundësuan mbledhjen e informacioneve të nevojshme për studim, mbi bazën e të cilave u analizuan perceptimet dhe gjykimet e të intervistuarve. Intervista gjysmë e strukturuar u përdor në studim edhe për shkak të numrit të vogël dhe përzgjedhës të pjesëmarrësve.

3.5. Pilotimi i pyetësorëve

Duke u fokusuar në problematikën e edukimit formal dhe të metodës së qëndrueshmërisë së pyetësorit dhe të problematikës së EJF, u formuluan edhe disa pyetje, të cilat fillimisht u bënë objekt i pilotimit, duke përdorur kryesisht metodën e intervistës gjysmë të strukturuar, përvojën arsimore dhe literaturën përkatëse. Synimi i pilotimit ishte konfirmimi se problematika e disertacionit është në përshtatje me problematikën që ka shkolla për cilësinë e marrëdhënies. Nëpërmjet pilotimit duhej të konfirmohej edhe struktura e temës, sikurse është nënvizuar, pastaj cilësia e marrëdhënies midis shkollës si institucion formal edukimi dhe institucioneve joformale, që kanë akses në edukimin e nxënësve për jetën si dhe rrjedhojat përkatëse për të përgatitur nxënësin si qytetar në dimensionet individuale, sociale dhe profesionale.

Mbi këtë kornizë konceptuale, nga analiza e punës në fazën e pilotimit u hartuan duke marrë trajtën e plotë edhe pyetjet, që do t'u adresohen subjekteve përkatëse; nxënësve, mësuesve, prindërve dhe punonjësve të shoqërisë civile dhe organizatave rinore. Natyrisht, nuk u lanë jashtë vëmendjes edhe subjekte të tjera, si drejtues të shkollave, punonjës psiko-social, me të cilët u kontaktua për problematikën e studimit.

Anketimi për pilotim u zhvillua gjatë muajit nëntorë 2015 dhe vitit 2016. Problematika e pilotimit përfshiu tre sekuenca kohore; kohën para pilotimit, gjatë dhe pas pilotimit.

Subjektet ishin nga shkollat e mesme të Kosovës (Gjilan) dhe Serbisë (Preshevë).

Kampioni i pilotimit përmbush pak a shumë ato kritere si edhe kampioni i testimit. Në pilotim $N=1/10$ e kampionit shërbeu për fazën testuese të pyetësorëve. Shkollat që ishin më afër u përzgjedhën për t'u realizuar anketimi; u mbajtën parasysh diferencat në moshë, gjini e diversitete kulturore. Pyetjet e pilotimit u vlerësuan prej subjekteve nga 1-5, sipas Shkallës Likert. Pyetësi shërbeu për të marrë të dhëna mbi cilësinë e marrëdhënies bashkëpunuese dhe efektet në jetën e nxënësve në këtë nivel shkollimi.

3.6. Mbledhja e të dhënave

Në mënyrë që të mblidhen të dhëna sa më përfaqësuese u përdorën tre lloje pyetësorësh: pyetësori për mësimdhënësin, për nxënësin dhe për prindërin. Pyetësori është shfrytëzuar si një urë lidhëse në mes hulumtuesit dhe pjesëmarrësve të hulumtimit drejt marrjes dhe matjes së qëndrimeve të tyre. Paraprakisht pyetësori u shpërnda për pilotim, ku morën pjesë 18 nxënësin, 24 mësimdhënësin dhe 18 prindërin si dhe pjesëtarë të shoqërisë civile. Të dhënat e tyre mbetën në kuadrin e kampionimit, duke mos u përfshirë më tej në të dhënat e studimit.

Mbi bazën e pyetjeve për shoqërinë civile e organizatat rinore u organizuan takime me anëtarë të këtyre organizatave dhe u shpjegua natyra e studimit; u pyetën nëpërmjet bisedave të lira, intervista gjysmë të strukturuar për lidhjen ndërinstitutionale; cilësinë e marrëdhënies me shkollën; si përgatitet nxënësi për jetën; çfarë programesh ofrohen; sa realizohen; nëse nuk janë efikase, çfarë pengon; si mund të bëhet kjo lidhje më efikase; si realizohet për formimin individual psikologjik, intelektual, me njohuri, aftësi, shprehi të nxënësit për jetën si zhvillohet në aspektin social; cila është vlera e kësaj lidhjeje; si reflektohet ajo në mjediset sociale të grupeve, klasës, shkollës, komunitetit, familjes; programet, veprimtaritë e përbashkëta shkollë-shoqëri civile apo organizata rinore? Si ka ndikuar kjo lidhje në aspektin profesional; të përgatitjes së nxënësve për të ndjekur universitetin në një profesion të caktuar, si jurist, mjek, ekonomist, inxhinier, etj, apo për t'u futur në botën e punës? Sa efikase është përgatitja që bëhet nëpërmjet edukimit formal dhe joformal në shkollë me atë që kërkohet në punë dhe në jetë, e kështu me radhë.

Nëpërmjet bisedave të lira u bënë takime me drejtues shkollash. Biseda u projektua lidhur me pozicionin e drejtorit të shkollës mbi marrëdhënien ndërinstitutionale shkollë-komunitet, institucione formale dhe joformale si dhe për efikasitetin e ndërveprimit në përgatitjen e nxënësit si qytetar.

Po ashtu, pyetje të tilla iu adresuan edhe prindërve si i shikojnë ata nga statusi i prindit këto marrëdhënie dhe efikasitetin e tyre në shkollë dhe komunitet.

Sipas kësaj metodologjie, iu adresuan pyetje mësuesve, punonjësve të shërbimit social-psikologjik, por secilit nga pozicioni përkatës, të fokusuar tek programet dhe agjendat e ndërthurjes së edukimit formal me atë joformal, në funksion të përgatitjes së nxënësit për jetën, sikurse është cilësia e marrëdhënies dhe produkti në aspektet individuale, sociale dhe profesionale, morale, kulturore, qytetare, për përgatitjen me standardet bashkëkohore për jetën në kushtet e globalizmit.

3.7. Instrumentet e hulumtimit

Produkti i veprimtarisë në shkollë do të matej nëpërmjet disa parametrave, të fokusuar në elemente kryesore të aftësive dhe kompetencave të nxënësit të shkollës së mesme, në kushtet aktuale të ndërthurjes së EF me EJJF. Nga pikëpamja metodike pyetësorët dhe intervistat u ndërtuan në përshtatje me temën, synimet, objektivat, hipotezat, pyetjet kryesore, si më poshtë:

Si instrumente hulumtimi janë përdorur pyetësorët dhe intervistat, të cilat mundësojnë mbledhjen e të dhënave mbi kampionimin. Në mënyrë që të mblidheshin të dhëna sa më përfaqësuese u përdorën tre lloje pyetësorësh: pyetësori për mësime, për nxënës dhe për prindër. Në fazën e pilotimit u përdor edhe puna me grupe.

Informacionet e marra nga grupet e fokusit i shërbejnë studiuesit për t'u thelluar mbi një temë ose mbi një argument të caktuar. Paraprakisht, pyetësori u shpërnda për pilotim, ku u formuan grupe të ndryshme, me pjesëmarrjen e 18 nxënësve, 24 mësuesve dhe 18 prindërve. Të dhënat e mbledhura prej tyre mbetën në kuadrin e pilotimit, duke mos u përfshirë më tej në të dhënat e studimit. Paqartësitë dhe vërejtjet e këtyre pjesëmarrësve u morën parasysh në sendërtimin e formës përfundimtare të pyetësorëve.

Ndërsa, në fazën e dytë të mbledhjes së të dhënave u përdorën, sikurse shpjegohet më lart, si pyetësorët ashtu edhe intervistat, si instrumente të qasjes së kombinuar sasiore dhe cilësore, e që krijojnë mundësi që studiuesi të hulumtojë mbi përgjigjet e respondentëve.

Pyetësorët

Hartimi i pyetjeve të pyetësorëve dhe intervistave u bë me synimin që të dalin si rrjedhojë e sinkronizimit që bëhet midis edukimit formal dhe joformal, duke qenë në koherencë me temën e zgjedhur dhe elementet e tjera si: hipotezat, pyetjet kryesore....deri tek përfundimet dhe rekomandimet.

Në analizën e pyetësorëve evidentohet se si janë lidhjet e shkollës me institucionet e tjera, kjo del nga sasia e pikëve që i japin subjektet e ndryshme, si nxënësit, mësuesit, prindërit pyetjeve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me problematikën e edukimit joformal. Aktualisht, punët e shkollës mbeten përgjithësisht brenda shkollës, prandaj dhe sasia e pikëve që i japin subjektet pyetjeve që lidhen me komunitetin janë relativisht më të pakta. Në kontekstin e pyetjeve, trajtohet problemi i sensibilizimit dhe metodave e mjeteve praktike, konkrete për forcimin e këtyre lidhjeve, që shkolla realisht të jetë në qendër të komunitetit, duke tërhequr vëmendjen e institucioneve të tjera, për vetë detyrën fisnike që ka ajo, përgatitjen e nxënësit për jetë, e cila nuk mund të zhvillohet nëpër laboratorë dhe është më e larmishme dhe komplekse se ajo që zhvillohet brenda mureve të shkollës. Që të arrihet kjo, shkolla duhet të punojë me kujdes me plane të bashkërenduara me institucionet jashtshkollore.

Pilotimi i pyetësorit për subjektet përkatëse: nxënës, mësues, prindër u sendërtua mbi bazën e gjashtë fushave, të cilat përmbanin pyetje të cilat fokusohen tek vendi dhe roli i edukimit paralel për të promovuar një varg karakteristikash, si: kujdesi ndaj nxënësve, motivimi, cilësia e arritjeve shkollore, zhvillimi i shkathtësive individuale, sociale dhe profesionale për jetën si dhe kultivimi i vlerave qytetare.

Pyetësorët u përpiluan, duke u mbështetur në shqyrtimin e literaturës përkatëse, duke iu përmbajtur shkallës Likert, që shpreh vlerësimin prej pesë pikësh, nga 1-5, ku: 1- Nuk pajtohem aspak; 2- Nuk pajtohem; 3- I pavendosur; 4- Pajtohem; 5- Pajtohem plotësisht.

Mbi bazën e vlerësimit të përshkallëzuar që japin të anketuarit, krijohet mundësia për të matur nivelin e dakordësisë apo mosdakordësisë për pyetjen në fjalë, e cila fokusohet në

një pikë të ndërveprimit të edukimit formal me atë joformal. Shkalla Likert ndërtohet sipas një rendi ku numrat e lartë tregojnë shkallën e prononcimit lidhur me pyetjen.

Niveli i matjes ka rëndësi se, dija mbi nivelin e matjes mundëson interpretimin e të dhënave lidhur me variablin. Një masë është nominale; është vetëm e përshkruar dhe vlerat numerike janë vetëm kode të shkurtra për emrat më të gjatë. Duke ditur nivelin e matjes mund të përzgjidhet se çfarë analize statistikore është e përshtatshme në vlerat që janë caktuar. Nëse një masë është nominale, atëherë nuk mund të mesatarizohen vlerat e të dhënave.

Pyetësorët u plotësuan nga nxënësit dhe mësime dhënësit nëpër shkollat e tyre, ndërsa pyetësorët për prindër u dërguan në shtëpi nga ana e nxënësve, për t'u plotësuar nga prindërit, duke u lënë kohën e përshtatshme. Ndërkohë, gjatë kontakteve me prindërit u bë kujdes që të ishin të qartë dhe të jepnin mendimet e tyre ashtu sikurse ata i besonin vërtet.

Përsa i përket karakteristikave të subjekteve, nxënësve, mësime dhënësit dhe prindërve, sikurse përshkruhet në pjesën e parë të pyetësorit, u përqendruam tek problematika e lidhjeve të tyre institucionale, vendi, përvoja dhe gjinia.

Për të marrë qëndrimet vlerësuese të mësime dhënësit, nxënësve dhe prindërve janë përdorur pyetësorë, që u morën nga libri “Priručnik za samovrednovanje i vrednovanje rada škole” (Udhëzues për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e punës së shkollës)(Beograd, 2005), përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Serbisë dhe British Council Serbia and Montenegro si dhe nga autori Kovačević, S. (2012), respektivisht studimi “Aktivnosti medjunarodnih organizacija na primjeni neformalnog obrazovanja u Crnoj Gori (Aktivitetet e organizatave ndërkombëtare në zbatimin e arsimit joformal në Mal të Zi).

Paraprakisht, u kontaktua me autorin e librit Sava Kovaceviq, për t'u kërkuar leja e përdorimit të disa pyetjeve nga studimi i tij. Si rrjedhojë e kontaktit, u mundësua lejimi i përdorimit të pyetjeve, si për pyetësorin ashtu edhe për intervistën. Lidhur me këtë studim u përdorën tre pyetësorë: pyetësori për nxënës, për mësime dhënësit dhe pyetësori për prindër.

Pjesa e parë e pyetësorit për nxënës përmbante karakteristikat demografike. Pjesa e dytë përbëhej prej 18 pyetjeve me aspekte të rëndësishme të jetës dhe punës së shkollës, të ndarë në seksione, si: bashkëstudimii shkollës dhe institucionet joformale, ndërveprimi i EF me EJP, motivimi i nxënësve për të mësuarit akademik dhe për jetën, vlerat që promovohen tek nxënësi në sajë të ndërveprimit ndërinstitutional, kujdesi dhe përkrahja e nxënësve, cilësia në mësim dhe zhvillimi personal, social dhe profesional. Si bazë për këtë pjesë, 15 pyetjet e para u morrën nga libri “Priručnik za samovrednovanje i vrednovanje rada škole” (Udhëzues për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e punës së shkollës) Beograd, 2005, përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Serbisë, ndërsa 3 pyetjet e tjera u përpiluan nga literatura e shfletuar që ka të bëjë me arsimin joformal. Subjektet kishin hapësira për t’u shprehur lidhur me çdo pyetje, me anë të shkallës Likert. Për të përcaktuar nivelin e besueshmërisë, fillimisht u bë pilotimi i pyetësorit me 18 nxënës të 2 shkollave të mesme të qytetit të Gjilanit dhe 2 shkollave të qytetit të Preshevës.

Analiza faktoriale dhe besueshmëria e pyetësorëve të aplikuar

Gjatë këtij studimi, para se të bëhej analiza e të dhënave është bërë analiza faktoriale dhe është vërtetuar besueshmëria e të gjithë pyetësorëve që janë shfrytëzuar për këtë studim.

Besueshmëria e pyetësorit për nxënës kishte koeficientin Alpha Cronbach = 0.808, ku sipas studiusit Cortina, J. M (1993), kuptimi i vlerave të Cronbach’s alpha është se $\alpha \geq 0.9$ vlerësohet shkëlqyeshëm, $0.8 \leq \alpha < 0.9$ vlerësohet mirë, $0.7 \leq \alpha < 0.8$ vlerësohet e pranueshme, $0.6 \leq \alpha < 0.7$ vlerësohet e diskutueshme, $0.5 \leq \alpha < 0.6$ vlerësohet e varfër, $\alpha < 0.5$ vlerësohet e papranueshme. Të dhënat e fituara janë analizuar me anë të programit SPSS 20.0 dhe Excel 13.0.

Analiza faktoriale e pyetësorit për nxënës

Në pyetësorin për nxënës janë fituar gjashtë faktorë në bazë të analizës së faktorit shpjegues (main components, varimaxrotation).

- Faktori i parë nga varen dhe të tjerët është ”bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale”, në të cilin përfshihen këto pyetje:
 - Shkolla në bashkëpunim me organizata të ndryshme që ofrojnë edukim joformal ofrojnë ligjërata me tema të ndryshme që janë parësore për ne, si parandalimi i dhunës në shkolla, ndikimi negativ i substancave narkotike, etj.;
 - Institucionet joformale dhe shkollat punojnë në realizim të projekteve të përbashkëta dhe fushatave vetëdijesuese për nxënës;
 - Bashkëstudimi në mes institucioneve joformale dhe shkollave na jep mundësi të marrim pjesë në aktivitete dhe seksione të ndryshme shkollore dhe jashtë shkollore.
- Faktori i dytë është motivimi për edukim komplementar në të cilin përfshihen pyetje, si:
 - Orët e mësimit plotësues më ndihmojnë që të pasuroj dhe përsosdijet e mia;
 - Shkolla lavdëron rregullisht suksesin e arritur në aktivitetet jashtëmësimore;
 - Së bashku me mësime dhënësin marr pjesë në përpilimin e programeve të aktiviteteve jashtëmësimore në shkollë.
- Faktori i tretë përbëhet nga treguesi “përkrahja në mësim për rritjen akademike” në të cilën përfshihen këto pyetje:
 - Në shkollë na mësojnë se si të nxëmë na trajtojnë teknika të ndryshme të të nxënës;
 - Mësime dhënësit, jashtë procesit mësimor, nëpërmjet mësimit plotësues, ndihmojnë nxënësit që të përparojnë;
 - Nxënësve të talentuar u janë mundësuar forma të posaçme të punës jashtë procesit të rregullt mësimor nëpërmjet mësimit shtesë, seksioneve, punë hulumtuese.
- Faktori i katërt përbëhet nga treguesi “zhvillimi individual dhe social”, që përmban këto pyetje:

- Nxënësit përmes organizatave të tyre përfshihen në zgjidhjen e problemeve të pa tolerueshme të sjelljes së nxënësve në shkollë, siç është agresiviteti, padurimi, jo toleranca, mosrespektimi dhe sjellje të ngjashme me to.
- Pjesëmarrja në aktivitetet jashtëmësimore më mundëson që të kënaq interesat e mia dhe të zhvilloj talentin tim.
- Në shkollë na mësojnë që të kemi besim në dijet dhe aftësitë tona
- Faktori i pestë përbëhet nga treguesi “vlerat e punës tek nxënësi” ku përfshihen këto pyetje:
 - Analizoj idetë e mia dhe të tjerëve, propozimet dhe zgjidhjet në punën grupore dhe ekipore
 - Pranoj ekzistencën e mendimit tjetër nga i imi
 - Jam i vetëdijshëm për ndikimin të cilin moshatarët e mi e kanë njëri për tjetrin dhe ndikimit pozitiv i cili mund të realizohet me shembullin dhe qëndrimin personal
- Faktori i gjashtë përbëhet nga treguesi “ndërthurja e edukimit formal dhe joformal në formimin profesional” ku përfshihen këto pyetje:
 - Njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e marra nëpërmjet edukimit formal dhe atij joformal më ndihmojnë të përgatitem më mirë për jetën
 - Edukimi që marr në institucionet joformale dhe formale më ndihmojnë të aftësohem profesionalisht.
 - Ndërlidhja e njohurive të fituara në edukimin joformal me atë formal më ndihmojnë në arritjen e kompetencave individuale e profesionale.

Edhe problematika e pyetësorëve të tjerë fokusohet rreth gjashtë faktorëve, të përcaktuar në studim, ku vlerësimi u bë sipas shkallës Likert, me përgjigje prej 1-5, që i korrespondojnë përgjigjet: 1- nuk pajtohem aspak e deri tek 5- pajtohem plotësisht.

Besueshmëria e pyetësorit të nxënësve

Për pyetësin e nxënësve është testuar edhe besueshmëria e shkallëve. Analiza faktoriale shpjeguese konfirmoi dimensionin e secilës shkallë.

- Te mesatarja e shkallës “bashkëstudimi i shkollës dhe institucionet jo formale” tek pyetësi i nxënësve të Gjilanit ($M=6.7784$, $DS=2.75467$, $V=7.588$) nuk kemi ndonjë ndryshim, statistikisht domethënës me mesataren e shkallës së pyetësit të Preshevës ($M=7.6508$, $DS=2.45703$, $V=6.037$). (Tabela 2,4).
- Krahësimet statistikore treguan se tek pyetësi për nxënësit e qytetit të Gjilanit në shkallën e “motivimit për edukimin komplementar” kemi: mesatarja e vlerave ($M=7.6035$), devijimi standard ($DS=2.26341$) dhe varianca ($V=5.123$). Prej nga del se nuk ka ndryshime statistikore të ndjeshme me atë të qytetit të Preshevës ($M=7.5608$, $DS=1.81681$, $V=3.301$).
- Tek shkalla “përkrahja në mësim për rritjen akademike”, mesatarja e shkallës tek pyetësi i nxënësve të Gjilanit ($M=8.6764$, $DS=2.70860$, $V=7.336$) në mënyrë të vlefshme ndryshon me atë të shkallës së pyetësit të nxënësve të Preshevës ($M=9.9048$, $DS=2.60960$, $V=6.810$).
- Mesatarja e shkallës “zhvillimi personal dhe social” në pyetësin e nxënësve të Gjilanit ($M=6.5860$, $DS=2.38245$, $V=5.676$) ndryshon në mënyrë domethënëse me mesataren e shkallës së pyetësit të nxënësve të Preshevës ($M=7.1058$, $DS=2.39890$, $V=5.755$).
- Mesatarja e vlerave të shkallës “vlerat e punës tek nxënësi” për pyetësin e nxënësve të Gjilanit ($M=5.94461$, $DS=2.060452$, $V=4.245$) nuk ndryshon statistikisht në mënyrë domethënëse me mesataren e shkallës së pyetësit të nxënësve të Preshevës ($M=5.42857$, $DS=1.598346$, $V=2.555$).
- Mesatarja e vlerave të shkallës “ndërthurja e edukimit formal dhe joformal në formimin profesional” pyetësi i nxënësve të Gjilanit ($M=7.3236$, $DS=2.54611$, $V=6.483$) ndryshon statistikisht në mënyrë të vlefshme nga mesatarja e shkallës së pyetësit të nxënësve të Preshevës ($M=8.1958$, $DS=2.29680$, $V=5.275$).

Tabela 5. Koeficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i nxënësve të qytetit të Gjilanit

Shkalla	Alpha cronbach	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	Numri i pyetjeve
FA1Bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale	.741	.742	3
FA2Motivimi për edukimin komplementar	.853	.855	3
FA3Përkrahja në mësim përrritjen akademike	.837	.838	3
FA4Zhvillimi personal dhe social	.723	.726	3
FA5Vlerat e punës tek nxënësi	.630	.632	3
FA6Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	.822	.822	3

Tabela 6. Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i nxënësve të qytetit të Gjilanit

Shkallët	Mesatarja	Varianca	Devijimi standard	Numri i pyetjeve
FA1Bashkëstudimii shkollës dhe institucionet joformale	6.7784	7.588	2.75467	3
FA2Motivimi për edukimin komplementar	7.6035	5.123	2.26341	3
FA3Përkrahja në mësim për	8.6764	7.336	2.70860	3

rritjen akademike				
FA4Zhvillimi individual dhe social	6.5860	5.676	2.38245	3
FA5Vlerat qytetare tek nxënësi	5.94461	4.245	2.060452	3
FA6Ndërveprimii edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	7.3236	6.483	2.54611	3

Tabela 7. Koefficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i nxënësve të qytetit të Preshevës

Shkalla	Alpha cronbach	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	Numri i pyetjeve
FA1Bashkëstudimii shkollës dhe institucionet joformale	.722	.713	3
FA2Motivimi për edukimin komplementar	.811	.823	3
FA3Përkrahja në mësim për rritjen akademike	.689	.684	3
FA4Zhvillimi individual dhe social	.857	.853	3
FA5 Vlerat qytetare tek nxënësi	.678	.681	3
FA6 Ndërveprimii edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin	.835	.836	3

profesional			
-------------	--	--	--

Tabela 8. Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i nxënësve të qytetit të Preshevës

Shkalla	Mesatarja	Varianca	Devijimi standard	Numri i pyetjeve
FA1 Bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve joformale	7.6508	6.037	2.45703	3
FA2 Motivimi për edukim komplementar	7.5608	3.301	1.81681	3
FA3Përkrahja në mësim për rritjen akademike	9.9048	6.810	2.60960	3
FA4Zhvillimi personal dhe social	7.1105	5.789	2.39651	3
FA5Vlerat qytetare tek nxënësi	5.42857	2.555	1.598346	3
FA6Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	8.1958	5.275	2.29680	3

Besueshmëria e këtij pyetësi rezultoi të ketë koeficientin Alpha Cronbach = .808, që vlerësohet se besueshmëria është e mirë dhe pyetësi mund të përdoret.

Case Processing Summary

	N	%
Cases Valid	532	100.0

Excluded ^a	0	.0
Total	532	100.0

a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	N of Items
.808	18

Analiza faktoriale e pyetësorit për mësimdhënës

Pyetësi për mësimdhënës, në pilotim u plotësua nga 24 mësimdhënës të katër shkollave të qytetit të Gjilanit dhe dy shkolla të qytetit të Preshevës.

Pjesa e parë e pyetësorit për mësimdhënës përmbante të dhënat demografike, ndërsa pjesa e dytë përbëhej prej 18 pyetjeve të grupuara në 6 faktorë.

Pjesa e tretë përmbante 5 pyetje që kanë të bëjnë me qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me kontributin e metodave joformale, të cilat korrespondojnë me përgjigjet e tyre.

Pjesa e fundit e pyetësorit përmbante një pyetje të mbyllur që kishte të bëjë me trajtimin e elementeve të edukimit joformal në atë formal.

- Faktori i parë ka të bëjë me “bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin profesional të mësimdhënësve”

- Institucionet joformale dhe shkollat punojnë në realizim të projekteve të përbashkëta dhe fushatave vetëdijësuese për nxënës dhe në zhvillimin profesional të mësimeve.
- Bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim profesional.
- Shkolla në bashkëpunim me institucionet joformale kanë ofruar trajnime dhe seminare të akredituara në drejtim të zhvillimit profesional të mësimeve .
- Faktori i dytë ka si tregues “cilësinë e të mësuarit-motivimi për edukim komplementar” dhe i përkisnin këto pyetje:
 - I nxënësit që në mënyrë të pavarur të arrijnë njohuri dhe shkathtësi plotësuese;
 - I lavdëroj dhe shpërblej arritjet e njohurive dhe shkathtësive plotësuese, që promovojnë të mësuarit në mënyrë të pavarur;
 - Përdor forma , metoda dhe teknika të ndryshme pune gjatë procesit mësimor, sepse nxënësit kanë stil, aftësi dhe interesa të ndryshme të mësimnxënies;
- Faktori i tretë përbëhet nga treguesi “përkrahja në mësim për rritje akademike” në të cilën përfshihen këto pyetje:
 - Mësimeve, jashtë procesit mësimor nëpërmjet mësimi plotësues i ndihmojnë nxënësit që të përparojnë;
 - I përkrah dhe i ndihmoj nxënësit që të organizojnë aktivitete të ndryshme kulturore, artistike, sportive dhe aktivitete të ngjajshme;
- Në faktorin e katërt, për treguesin " zhvillimi individual dhe social" janë këto pyetje:
 - Nxënësit që të zbulojnë dhe zhvillojnë talentet e tyre, duke marrë pjesë në aktivitetet jashtëmësimore që u ofrohen;
 - Nëpërmjet arsimit joformal kam zhvilluar shkathtësi komunikative dhe të punës me individin;

- Në faktorin e pestë, për treguesin "vlerat qytetare tek nxënësi" janë këto pyetje:
 - Nxënësit të respektojnë mendimin e të tjerëve ;
 - Tek nxënësit nxis solidaritetin dhe kujdesjen për njëri tjetrin, veçanërisht në rastet e shfaqjeve etnike, racore, fetare dhe paragjytimeve gjinore;
- Në faktorin e gjashtë evidentohet "qëndrimi i mësimdhënësve lidhur me ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional"
 - Nëpërmjet arsimit joformal kam zhvilluar shkathtësi të udhëheqjes së diskutimit grupor;
 - Nëpërmjet arsimit joformal kam zhvilluar shkathtësi planifikimi, organizimi dhe realizimi sipas kërkesave individuale të nxënësve;
 - Nëpërmjet arsimit joformal kam zhvilluar e rivendosur një atmosferë pozitive për mësim dhe i motivoj nxënësit për punë;
 - Metoda e punës me individin i kontribuon zhvillimit të kompetencave personale dhe profesionale të mësimdhënësit si individ dhe kontribuon zhvillimin dhe ndryshimin tek nxënësi i cili ka probleme;
 - Metoda grupore kontribuon zhvillimin e komunikimit, bisedës, mëson dëgjimin aktiv; mundëson shkëmbimin e përvojave;
 - Përparësitë e trajnimeve janë të shumëllojshme, puna në grupe të vogla, qasje cilësore individuale, teknika të ndryshme, nxitje e njohurive njohëse ,kompetenca shoqërore,zhvillim i imagjinatës ose intelektit...;
 - Trajnimi kontribuon në cilësisë më të mirë të punës me nxënës, që arrijnë nivel shumë të mirë të dijeve dhe zotërojnë shkathtësi në punë;
 - Metodën joformale të punës i kontribuon produktivitetit më të lartë,motivim për mësim si të mësimdhënësve ashtu edhe të nxënësve;
 - Ndërthurja e edukimit formal dhe joformal ndikon në rritjen e performancës dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve;

- Ndërveprimi i edukimit joformal dhe formal ndikon në rritjen e motivimit dhe arritjen e kompetencave individuale dhe profesionale;
- Ndërthurja e edukimit formal dhe joformal ndihmon nxënësit të përgatiten më mirë për jetën, të shprehin dhe zhvillojnë talentin e tyre;
- A mund të trajtohen elementet e edukimit joformal në atë formal?

Përveç analizës faktoriale kërkohet edhe besueshmëria e secilës shkallë. Analiza faktoriale shpjeguese tregon se besueshmëria e shkallëve në këtë pyetësor vlerësohet e pranueshme. Të dhënat deskriptive të shkallëve të pyetësorit për mësimdhënës të qytetit Gjilanit dhe Preshevës tregojnë se nuk ka diferencë statistikore domethënëse në mesataren e shkallëve. (Tabela 10,12).

Tabela 9. Koefficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësori i mësimdhënësve të qytetit të Gjilanit

Shkalla	Alpha cronbach	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	Numri i pyetjeve
FA1 Bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin të mësimdhënësve	.945	.945	3
FA2 Motivimi për të mësuarit akademik	.859	.867	3
FA3 Përkrahja në mësim për rritje akademike	.896	.906	2
FA4 Zhvillimi individual dhe social	.723	.726	2
FA5 Vlerat qytetare tek nxënësi	.905	.906	2

FA6Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në formimin profesional	.894	.894	12
---	------	------	----

Tabela 10. Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i mësimeve të qytetit të Gjilanit

Shkalla	Mesatarja	Varianca	Devijimi standard	Numri i pyetjeve
FA1 Bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin të mësimeve	4.6154	2.359	1.53590	3
FA2 Motivimi për të mësuarit akademik	5.4423	1.899	1.37789	3
FA3 Përkrahja në mësim për rritje akademike	2.7692	1.005	1.00226	2
FA4 Zhvillimi individual dhe social	3.5577	.918	.95821	2
Fa5 Vlerat qytetare tek nxënësi	4.2308	.808	.89914	2
Fa6 Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në formimin profesional	3.6923	1.629	1.27631	12

Tabela 11. Koeficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i mësimeve të qytetit të Presheves

Shkalla	Alpha cronbach	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	Numri i pyetjeve
---------	----------------	--	------------------

FA1 Bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin profesional të mësimeve	.880	.884	3
FA2 Motivimi për të mësuarit akademik	.722	.713	3
FA3 Përkrahja në mësim për rritje akademike	.876	.876	2
FA4 Zhvillimi individual dhe social	.632	.659	2
FA5 Vlerat qytetare tek nxënësi	.788	.790	2
FA6 Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	.869	.869	12

Tabela 12. Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i mësimeve të qytetit të Presheves

Shkalla	Mesatarja	Varianca	Devijimi standard	Numri i pyetjeve
FA1 Bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin profesional të mësimeve	6.1591	4.974	2.23027	3
FA2 Motivimi për të mësuarit akademik	5.0000	1.302	1.14119	3
FA3 Përkrahja në mësim për rritje akademike	3.0082	.902	.94985	2

FA4Zhvillimi individual dhe social	3.3636	.934	.96668	2
FA5Vlerat qytetare tek nxënësi	3.7727	.877	.93668	2
FA6 Ndërveprimi i edukimitformal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	3.8409	1.579	1.25648	12

Besueshmëria e pyetësorit të mësimdhënësve rezultoi të ketë koeficientin Alpha Cronbach = .813 , që është llogaritur në bazë të 24 pohimeve dhe vlerësohet për një besueshmëri të mirë.

Case Processing Summary

	N	%
Valid	96	100.0
Cases Excluded ^a	0	.0
Total	96	100.0

a. Listëise deletion based on all variables in the procedure.

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.813	.792	24

Pilotimi i pyetësorit për prindër dhe besueshmëria e shkallëve që mat faktorët

Pilotimi i pyetësorit për prindër u testua me 18 prindër. Nga të dhënat e dala prej pyetësorit për prindër u bë analiza faktoriale shpjeguese- main components, varimax rotation, nga ku u përfituan 6 faktorë, që fokusohen tek problematika e përcaktuar e ndërveprimit të edukimit dhe rrjedhøjave në aspektet individuale, sociale dhe profesionale.

Ky pyetësor ka një koeficient besueshmërie Alpha Cronbach = .861, çka e vlerëson pyetësorin si të mirë. Më gjerësisht analiza faktoriale paraqitet në aneksin F.

Krahasimi i statistikave deskriptive të shkallëve në pyetësorët e prindërve të Gjilanit dhe Preshevës tregojnë se nuk ka ndryshime domethënëse statistikore të mesatareve të shkallëve (Tabela 13.15) .

Case Processing Summary

	N	%
Valid	317	100.0
Cases Excluded ^a	0	.0
Total	317	100.0

a. Listwise deletion based on all variables in the procedure.

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.861	.866	18

Tabela 13. Koefficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësoni i prindërve të qytetit të Gjilanit

Shkalla	Alpha cronbach	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	Numri items
FA1 Komunikimi i shkollës me prindër	.767	.795	4
FA2 Cilësia e arritjeve shkollore	.746	.754	3
FA3 Kujdesi ndaj nxënësve	.759	.759	3
FA4 Zhvillimi i shkathtësive jetësore	.743	.743	3
FA5 Etika	.727	.744	3

FA6 Dobitë e ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal	.766	.770	2
---	------	------	---

Tabela 14: Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i prindërve të qytetit të Gjilanit

Shkalla	Mesatarja	Varianca	Devijimi standard	Numri i pyetjeve
FA1 Komunikimi i shkollës me prindër	7.9167	8.148	2.85454	4
FA2 Cilësia e arritjeve shkollore	5.1944	3.145	1.77350	3
FA3 Kujdesi ndaj nxënësve	6.1111	3.836	1.95862	3
FA4 Zhvillimi i shkathtësive jetësore	6.5635	3.857	1.95862	3
FA5 Etika	5.9960	3.701	1.92384	3
FA6 Dobitë e ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal	2.9129	1.618	1.27195	2

Tabela 15: Koeficienti alpha cronbach për faktorët tek pyetësi i prindërve të qytetit të Preshevës

Shkalla	Alpha cronbach	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	Numri items
FA1 Komunikimi i shkollës me prindër	.705	.796	4

FA2 Cilësia e arritjeve shkollore	.646	.650	3
FA3 Kujdesi ndaj nxënësve	.822	.822	3
FA4 Zhvillimi i shkathtësive jetësore	.857	.853	3
FA5 Etika	.770	.774	3
FA6 Dobitë e ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal	.732	.733	2

Tabela 16: Statistikat e shkallës për faktorët tek pyetësi i prindërve të qytetit të Preshevës

Shkalla	Mesatarja	Varianca	Devijimi standard	Numri i pyetjeve
FA1 Komunikimi i shkollës me prindër	7.2308	6.524	2.55422	4
FA2 Cilësia e arritjeve shkollore	5.7231	1.985	1.40876	3
FA3 Kujdesi ndaj nxënësve	5.8000	3.319	1.82174	3
FA4 Zhvillimi i shkathtësive jetësore	7.2615	3.884	1.97070	3
FA5 Etika	5.6000	2.838	1.68449	3
FA6 Dobitë e ndërveprimit të	2.4308	.687	.82858	2

edukimit formal dhe joformal				
------------------------------	--	--	--	--

3.8. Popullata dhe kampioni

Popullata përbëhet prej nxënës, mësimdhënës e prindër, të institucioneve edukative-arsimore formale dhe drejtues të qendrave që ofrojnë arsim joformal. Studimi bazohet në një kampion prej 956 pjesëmarrës, nga këta 532 janë nxënës, 96 janë mësimdhënës, 317 janë prindër dhe 11 drejtues të institucioneve joformale. Kampioni u mor nga 6 shkolla, ku 4 prej tyre janë shkolla të mesme në Kosovë të qytetit të Gjilanit; më konkretisht: Shkolla e mesme- Gjinnazi “Zenel Hajdini”, Gjilan; Shkolla e mesme- Gjinnazi natyror “Xhavit Ahmeti”, Gjilan; Shkolla e mesme teknike “Mehmet Isai”, Gjilan; dhe Shkolla e mesme e mjekësisë “Dr. Asllan Elezi”, Gjilan, si edhe 2 shkolla të mesme në Serbi- qyteti i Preshevës: Shkolla e mesme Gjinnazi “Skënderbeu”, Preshevë dhe Shkolla e mesme teknike “Presheva”, Preshevë.

Të dhënat e përgjithshme të pjesëmarrësve në studim

Kjo ndarje nis me analizën deskriptive të përshkrimit të pjesëmarrësve në studim, me karakteristikat e kampionimit, frekuencën, shtrirjen e grupeve pjesëmarrëse sipas qyteteve, shkollave, përqindjet, përkatësinë gjinore, *beckround-i* - lloji i karrierës, trajnimi, edukimi, etj.

Në plotësimin e pyetësorit u përfshinë gjithsej 945 pjesëmarrës, prej tyre 532 nxënës apo 55.70 %, 96 mësimdhënës apo 10.05 % dhe 317 prindër apo 33.19 % , të cilët ishin prindër të nxënësve pjesëmarrës në studim. Shpërndarja e subjekteve- nxënësve, mësuesve, prindërve, aktorëve të shoqërisë civile për kampionim, jepet sipas frekuencës, përqindjes në bazë të shkollave, qyteteve dhe përkatësisë gjinore. Pyetësorët ndahen sipas subjekteve që u adresohen, nxënës, mësues, prindër; shih anekset A, B, C.

Të dhënat e përgjithshme të nxënësve në studim

Tabela 17: Të dhënat e përgjithshme të nxënësve që morën pjesë në studim sipas llojit të shkollës.

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja përmblledhëse
Shkolla e mesme teknike "Mehmet Isai"	63	11.8	11.8	11.8
Gjimnazi "Skënderbeu"	88	16.5	16.5	28.4
Shkolla e mesme teknike "Presheva"	101	19.0	19.0	47.4
Shkolla e mesme e Valid mjekësisë "Dr. Asllan Elezi"	92	17.3	17.3	64.7
Gjimnazi natyror "Xhavit Ahmeti"	83	15.6	15.6	80.3
Gjimnazi "Zenel Hajdini"	105	19.7	19.7	100.0
Total	532	100.0	100.0	

Nga tabela 17, shohim se në studim morën pjesë 532 nxënës, prej tyre (1) 63 nxënës apo 11.8 % pjesëmarrës në studim i përkasin Shkollës së mesme teknike “Mehmet Isai” të qytetit të Gjilanit; (2) 88 nxënës apo 16.5 % Gjimnazit “Skënderbeu”, Preshevë; (3) 101 nxënës apo 19 % Shkollës së mesme teknike “Presheva”, Preshevë; (4) 92 nxënës apo 17.3

% e tyre ishin nxënës të Shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Asllan Elezi” Gjilan; (5) 83 nxënës apo 15.6 % e nxënësve ishin nxënës të Gjimnazit natyrorë “Xhavit Ahmeti” Gjilan, dhe (6) 105 nxënës apo 19.7% e tyre ishin nxënës të Gjimnazit “Zenel Hajdini” Gjilan.

Tabela 18: Pjesëmarrja e nxënësve në studim, përkatësia sipas qyteteve

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja përmblledhëse
Gjilan	343	64.5	64.5	64.5
Valid Preshevë	189	35.5	35.5	100.0
Total	532	100.0	100.0	

Në plotësimin e pyetësorit morën pjesë 343 nxënës apo 64.5% të qytetit të Gjilanit dhe 189 nxënës apo 35.5% të Preshevës. Këto të dhëna janë paraqitur në tabelën 18

Tabela 19: Pjesëmarrja e nxënësve në studim, përkatësia sipas gjinisë

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja përmblledhëse
Femër	281	52.8	52.8	52.8
Valid Mashkull	251	47.2	47.2	100.0
Total	532	100.0	100.0	

Nga tabela 19. shohim se prej numrit të përgjithshëm (532) të nxënësve pjesëmarrës, 281 janë nxënës- gjinia femërore që përbëjnë 52.8 %, ndërsa nxënës- gjinia mashkullore janë 251 apo 47.2 % e tyre.

Të dhënat e përgjithshme të mësimdhënësve sipas institucionit, vendit, gjinisë dhe eksperiencës së punës.

Më poshtë paraqiten statistikën e pjesëmarrjes së mësuesve për kampionim, sipas frekuencës, përqindjes në bazë të shkollave, qyteteve dhe përkatësisë gjinore.

Mësues të cilët plotësuan pyetësin ishin gjithsej 96, prej tyre (1) 18 mësimdhënës apo 18.8 % pjesëmarrës në studim i përkasin Shkollës së mesme teknike “Presheva” të qytetit të Preshevës; (2) 16 apo 16.7 % të Shkollës së mesme teknike “Mehmet Isa”, Gjilan; (3) 13 mësues apo 13.5 % të Gjimnazit “Zenel Hajdini” Gjilan; (4) 11 apo 11.5% mësimdhënës të Shkollës së mesme të mjekësisë “Dr. Asllan Elezi”, Gjilan; (5) 12 apo 12.5% mësimdhënës të Gjimnazit natyrorë “Xhavit Ahmeti” Gjilan, dhe (6) 16 apo 27.1% e tyre ishin mësimdhënës të Gjimnazit “Skënderbeu” Preshevë (Tabela 20).

Tabela 20: Të dhënat e përgjithshme të mësimdhënësve sipas institucionit

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja përmblledhëse
Valid				
Shkolla e mesme teknike "Presheva"	18	18.8	18.8	18.8
Shkolla e mesme teknike "Mehmet Isai"	16	16.7	16.7	35.4
Gjimnazi "Zenel Hajdini"	13	13.5	13.5	49.0

Shkolla e mesme e mjekësisë "Dr. Asllan Elezi"	11	11.5	11.5	60.4
Gjimnazi natyror "Xhavit Ahmeti"	12	12.5	12.5	72.9
Gjimnazi "Skënderbeu"	26	27.1	27.1	100.0
Total	96	100.0	100.0	

Tabela 21: Të dhënat e përgjithshme të mësimdhënësve sipas vendndodhjes

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja përmbledhëse
Preshevë	44	45.8	45.8	45.8
Valid Gjilan	52	54.2	54.2	100.0
Total	96	100.0	100.0	

Ashtu si në përzgjedhjen e nxënësve i është kushtuar rëndësi edhe përzgjedhjes për kampionin e mësuesve me synimin që kampioni të plotësojë kriteret bazë, duke qenë njëkohësisht edhe përfaqësues, natyrisht me veçoritë përkatëse edhe për pjesën tjetër më të madhe të kontingjentit të mësimdhënësve.

Tabela 22: Të dhënat e përgjithshme të mësimdhënësve sipas dikotomisë gjinore

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Përmbledhëse
Valid	Femra	33	34.4	34.4	34.4
	Mashkuj	63	65.6	65.6	100.0
	Total	96	100.0	100.0	

Trajtimi i karakteristikave të mësimdhënësve jepet si në mënyrë të detajuar ashtu edhe në kuptimin holistik si pjesë e dukurisë në tërësi. Kjo me synimin që jo vetëm të evidentohen veçoritë e kampionit, por edhe lidhjet e ngushta me subjektet e tjera: nxënësit, prindërit, aktorët e shoqërisë civile, të cilët duke punuar bashkërisht dhe me synime të qarta mundësojnë përgatitjen efikase të të rinjve të shkollës së mesme për jetën, duke përballuar sfidat e saj të shumta.

Tabela 23: Statistikat përshkruese të mësimdhënësve pjesëmarrës në hulumtim sipas institucionit, vendit dhe gjinisë

	Institucioni ku punoni	Vendi	Vite eksperiencë	Gjinia
N	Morën pjesë	96	96	96
	Munguan	0	0	0
Mean		1.5417	14.6771	1.6563

Gabimi Standard	.05112	.79008	.04873
Mesatarja	2.0000	13.5000	2.0000
Mode (pika e mesme)	2.00	12.00	2.00
Devijimi Standard	.50088	7.74120	.47745
Variance (shpërndarja)	.251	59.926	.228
Rangu (shkalla e shpërndarjes)	1.00	35.00	1.00
Minimumi	1.00	1.00	1.00
Maksimumi	2.00	36.00	2.00
Shuma	148.00	1409.00	159.00

Në kontekstin holistik, një kriter i rëndësishëm në përzgjedhjen e mësuesve për kampion është edhe përvoja e tyre arsimore e shtrirë në vite dhe marrja pjesë e tyre në trajnime të ndryshme dhe kualifikimin, sipas vjetërsisë në punë dhe aftësive profesionale, fakt që i shërben jo vetëm kualifikimit të tyre, por edhe lidhjeve të ngushta me aktorë të shoqërisë civile, për bashkërendimin e veprimtarive, në funksion të përgatitjes së nxënësve për jetën.

Tabela24. Të dhënat e përgjithshme të mësimeve- eksperiencë pune

Valid	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
1.00	2	2.1	2.1	2.1

3.00	1	1.0	1.0	3.1
4.00	3	3.1	3.1	6.2
5.00	7	7.3	7.3	13.5
6.00	2	2.1	2.1	15.6
7.00	1	1.0	1.0	16.6
8.00	5	5.2	5.2	21.8
9.00	4	4.2	4.2	26.0
10.00	7	7.3	7.3	33.3
11.00	1	1.0	1.0	34.3
12.00	11	11	11.5	45.8
13.00	4	4.2	4.2	50.0
14.00	2	2.1	2.1	52.1
15.00	8	8.3	8.3	60.4
16.00	4	4.2	4.2	64.6
17.00	3	3.1	3.1	67.7
18.00	6	6.3	6.3	74.0
20.00	6	6.3	6.3	80.3
22.00	5	5.2	5.2	85.5
23.00	1	1.0	1.0	86.5
24.00	2	2.1	2.1	88.6
25.00	2	2.1	2.1	90.7
26.00	2	2.1	2.1	92.8
27.00	1	1.0	1.0	93.8
30.00	2	2.1	2.1	95.9
32.00	1	1.0	1.0	96.9
33.00	1	1.0	1.0	97.9
35.00	1	1.0	1.0	98.9
36.00	1	1.0	1.0	99.9

Total	96	100.0	100.0	
-------	----	-------	-------	--

Tabela 25: Vitet e punës së mesimdhënësve pjesëmarrës

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Valid				
1-10 vite	32	33.4	33.4	33.4
11-20	45	47	47	66.6
Mbi 20 vite	19	19.6	19.6	100.0
Total	96	100	100	

Të dhënat e përgjithshme të prindërve në studim

Më poshtë jepet tabela përmbledhëse e statistikave të prindërve pjesëmarrës, sipas anketës që ishte përgatitur për ta. Në studim u bë kujdes që, ashtu si me nxënësit dhe mësuesit, të kishte prindër me karakteristika të ndryshme, si niveli arsimor, kulturor, punësimi, gjendja familjare, lidhjet me shkollën, çfarë mendojnë ata për përgatitjen e fëmijëve të tyre për jetën, etj. Natyrisht, iu referuam shkollave që ishin objekt studimi, të cilat u përzgjedhën që të ishin përfaqësuese, sikurse do të trajtohet edhe tek analiza përgjithësuese. Në tabelën më poshtë jepen të dhënat e pjesëmarrësve prindër në studim, duke respektuar kriteret statistikore, të cilat pasqyrohen në të majtë të tabelës.

Tabela26:Statistikat përshkruese të prindërve pjesëmarrës në hulumtim sipas institucionit,vendit dhe gjinisë

	Emri i shkollës	Vendi	Gjinia
N	Morën pjesë	317	317
	Munguan	0	0
Mean		1.2050	1.5300
Gabimi Standard		.02271	.02808
Mesatarja		1.0000	2.0000
Mode (pika e mesme)		1.00	2.00
Devijimi Standard		.40437	.49989
Variance (shpërndarja)		.164	.250
Rangu (shkalla e shpërndarjes)		1.00	1.00
Minimumi		1.00	1.00
Maksimumi		2.00	2.00
Shuma		382.00	485.00

Tabela 27: Të dhënat e përgjithshme të prindërve pjesëmarrës në hulumtim sipas llojit të shkollës

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Gjimnazi natyror "Xhavit"	58	18.3	18.3	18.3

Ahmeti"				
Shkolla e mesme e mjekësisë "Dr. Asllan Elezi"	60	18.9	18.9	37.2
Shkolla e mesme teknike "Presheva"	22	6.9	6.9	44.2
Gjimnazi "Skënderbeu"	43	13.6	13.6	5.77
Shkolla e mesme teknike "Mehmet Isai"	36	11.4	11.4	69.1
Gjimnazi "Zenel Hajdini"	98	30.9	30.9	100.0
Total	317	100.0	100.0	

Në përzgjedhjen e shkollave, sipas kriterit të qytetit ku ndodhen i është kushtuar rëndësi, pasi edhe nga ky vështrim shkollat duhet të plotësonin kriterin e të qenit shkolla përfaqësuese, për studimin në fjalë.

Tabela 28: Të dhënat e prindërve sipas vendit, qytetit që përfaqësojnë

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Gjilan	252	79.5	79.5	79.5
Valid Preshevë	65	20.5	20.5	100.0
Total	317	100.0	100.0	

Ashtu si në rastin e përzgjedhjes së subjekteve të studimit: nxënësve, mësuesve, aktorëve të shoqërisë civile, edhe në përzgjedhjen e subjektit prindër u mbajt parasysh dikotomia gjinore, sipas përkatësisë në femra dhe meshkuj.

Tabela 29: Të dhënat e prindërve pjesëmarrës në hulumtim sipas gjinisë

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Femra	149	47.0	47.0	47.0
Valid Meshkuj	168	53.0	53.0	100.0
Total	317	100.0	100.0	

Sikurse shihet edhe nga tabela më sipër raporti i përfaqësimit gjinor është gati i barabartë, në raportin 47% me 53, me një përfaqësim pak më të lartë të prindërvemeshkuj. Kjo si rrjedhojë e faktit se ata janë më të angazhuar në lidhjet që kanë me shkollën. Ndërsa, sipas perceptimit dhe përvojës së gjatë në mësimdhënie të autores së studimit, femrat kanë një përqindje më të madhe në “prindërim” për sa i përket marrëdhënieve dhe lidhjeve me fëmijët e tyre, brenda mjedisit familjar. Por kjo dukuri do të përbënte një objekt të veçantë studimi.

Të dhënat e përgjithshme të aktorëve të shoqërisë civile

Në konceptimet e pedagogjisë bashkëkohore dhe më gjërë, arsimimi i fëmijve në rastin e studimit të nxënësve të shkollës së mesme nuk është vetëm një çështje shkollore, por edhe e shoqërisë në tërësi. Paisja vetëm në shkollë me disa njohuri nuk përmbush aftësimin e njeriut për jetën, e cila shtrun përpara qytetarëve kërkesa të shumta. Prandaj, gjithnjë e më shumë si nga shkolla dhe komuniteti, apo shoqëria në tërësi vihet theksi tek krijimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të rinjve për jetën nëpërmjet gërshetimit të edukimit formal me atë joformal.

Janë dhënë shumë përcaktime mbi kompetencën. Autori (Boulter, 2004) thekson se "një karakteristikë themelore e personave, që u mundëson atyre për të ofruar performancë superiore në një punë të caktuar, rol apo situatë" është përgjegjësia dhe profesionalizmi.

Kjo është një detyrë, që e ka marrë përsipër ta kryejë shoqëria civile që ka në fokus ndërthurjen e mënyrave të ndryshme të edukimit formal me atë joformal. Organizatat që u bënë objekt studimi pasqyrohen në tabelën 30, ku paraqitet shpërndarja e aktorëve të shoqërisë civile për kampionim, sipas institucionit ku punojnë, pozitës që kanë, viteve të përvojës në atë institucion dhe qytetit ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Tabela 30: Të intervistuarit sipas përfaqësimit të tyre në institucionet joformale

N r	Inicialet e të intervistuarëve	Institucioni	Pozita	Vite eksperiencë	Qyteti
1	L. I	Qendra Rinore	Menaxhere	16 vite	Gjilan
2	B. S.	Qendra e Aftësisimit Profesional-QAP	Drejtore	13 vite	Gjilan
3	N. I	OJQ- Aksioni kundër dhunës dhe Ndërtimit të Paqes ANP	Drejtore	14 vite	Gjilan
4	S. Sh.	Info Tech Academy	Menaxher	11 vite	Gjilan
5	E. K.	Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtarë (QKBN);	Drejtore	10 vite	Gjilan
6	J.V	OJQ “Labyrinth”	Menaxher	8 vite	Gjilan
7	A.	OJQ-“Aponia”	Drejtuese	1 vit	Gjilan
8	F.M	Qendra e gjuhëve të huaja	Drejtuese	10 vite	Gjilan
9	E.K	OJQ -Green Art Center-(GAC)	Koordinatorë	1 vit	Gjilan
10	M. B	Zyra për të Rinjtë	Koordinatorë	4 vite	Preshevë
11	Sh. L.	Qendra për Arsim	Koordinatorë	3 vite	Preshevë

Sikurse evidentohet nga tabela më lartë janë mbajtur parasysh kriteret e përzgjedhjes së kampionit me këtë subjekt, sikurse edhe me subjektet e tjera, me synimin që të jenë përfaqësues për studimin në fjalë, që do të mundësonte që krahas analizës përshkruese të të dhënave të bëhej edhe një analizë më e detajuar për të evidentuar problematikën e kësaj dukurie- ndërthurjes së mënyrave të edukimit formal me atë joformal. Mbi këtë bazë të evidentohen avantazhet dhe disavantazhet që ka ndërveprimi dhe të mund të bëhen përgjithësimet përkatëse mbi shtrirjen e kësaj dukurie në një rrafsh më të gjerë, që do të përfshinte arsimimin në Kosovë.

Përzgjedhja e kampionit

Përzgjedhja e kampionit u bë në përshtatje me qëllimin e studimit, duke respektuar kriteret dhe fazat e marrjes së kampionit. Procesi i përzgjedhjes së disa individëve u bë në mënyrë të atillë që individët të kenë një probabilitet të lartë në përfaqësimin e grupit, prej të cilit u përzgjedhën edhe analizat, me qëllim që të përmbushin supozimet e procedurave të shumta statistikore, për të qenë tipike, duke përgjithësuar realisht karakteristikat e tyre për çështjet e objektit të studimit. Sikurse përcakton Field, një kampion është “më i vogël, por përfaqësues i popullatës nga është marrë për të përcaktuar të vërtetat në lidhje me atë popullatë” (Field, 2005).

Në përzgjedhjen e kampionit u mbajt parasysh literatura që përcakton kornizën e kampionimit, ku përfshihen një set elementesh mbi popullatën, sikurse janë njohuritë bazë mbi targetimin e popullatës, apo të grupit të madh nga duhet tërhequr kampioni për të përcaktuar gjetjet. Subjektet e kampionit u përzgjedhën në mënyrë që të gjithë anëtarët e popullatës të kishin një mundësi të barabartë dhe të pavarur për të qenë të përzgjedhur. Sipas Soëll (2001), përzgjedhja rastësore është një teknikë e mirë pasi siguron një kampion përfaqësues të popullatës së synuar dhe parashikon bazat e kërkuesit për të hyrë në procesin e përzgjedhjes. Arsyeja kryesore e kësaj është se çdo anëtar i popullatës ka shanse të barabarta për të qenë i përzgjedhur dhe për të qenë pjesë e kampionit.

Matthews dhe Ross (2010), pohojnë se kampioni i rastësishëm mund të përfshijë ose jo raste me karakteristika të caktuara në të njëjtat përpjestime siç gjenden në popullatë. Mbështetur në këtë koncept, në përzgjedhjen e 6 shkollave u morën parasysh disa karakteristika. Karakteristika e parë ishte shkollat e mesme profesionale dhe gjimnazet e zonës urbane, karakteristika e dytë ishte numri më i madh i nxënësve dhe mësimdhënësve në këto shkolla dhe afërsia e shkollave.

Përzgjedhja e nxënësve në shkolla u bë duke u bazuar në parimin e numrit të rastësisë, ku sipas Muratit, “procedura e zgjedhjes së njërive (nxënësve) në kampion gjendet duke e pjesëtuar numrin e popullatës (P) me numrin e kampionit, pra P/p ose psh. $3000:300=10$. Kjo do të thotë se prej popullatës (P) e cila është 3000 duhet të zgjidhet çdo i dhjeti nxënës... sipas listave duhet të zgjidhen çdo i dhjeti individ dhe kjo bëhet sipas parimit të gjasës apo rastësisë duke filluar nga numri, psh. 4, 14, 24 etj” (Murati, 2004:143). Gjithashtu edhe përzgjedhja e mësimdhënësve u bë sipas listës së mësimdhënësve në shkolla, në varësi të numrit të mësimdhënësve.

Në përzgjedhjen e kampionit u respektuan kërkesat e studimit. Për shkak të një pjesëmarrjeje më të gjërë dhe gjithpërfshirëse të popullatës në hulumtim, ju referuam kërkesave të vërtetuara shkencore se “nëse synojmë që kërkimi të realizohet në kampion prej 300 nxënësish (njësi) nga popullata (P) 3000, përqindja e përfshirjes së popullatës gjegjësisht madhësia e kampionit është $p:P=300:3000=10.0\%$ ” (Murati, 2004 :143). Po ashtu, Gay I. R. & Airasian, P. (2003) mendojnë se nëse madhësia e popullatës është mbi 500 atëherë është e përshtatshme që madhësia e kampionit të jetë 400.

Duke u nisur nga fakti se studimi është përqëndruar edhe në kërkimin dhe interpretimin e qëndrimeve të drejtuesve të institucioneve joformale, kemi përzgjedhur një kampion të qëllimshëm për këtë studim. “Në këto qasje kampionimi, synimi nuk është që të krijohet një kampion që të jetë statistikisht përfaqësues i një popullate. Përkundrazi, njerëzit ose rastet zgjidhen me qëllim që t’i japin studiuesit mundësinë për të eksploruar pyetjet e studimit” (Matthews, B & Ross, L, 2010:167).

Intervista me drejtues të institucioneve joformale

Për mbledhjen e të dhënave të dëshiruara, përveç metodës sasimore u përdor edhe metoda cilësore nëpërmjet intervistës gjysmë të strukturuar me drejtues të institucioneve joformale. Intervista gjysmë e strukturuar përmbante pyetje thelbësore që kishin të bënin me rolin e arsimit joformal në shoqërinë e sotme, programet edukative që ofrohen në qendrat apo institucionet joformale, mbi zbatimin e metodave joformale në ato formale, ndërthurjen e edukimit joformal dhe formal, mundësinë e trajtimit të elementeve joformale në atë formale si dhe rreth interesimit të kuadrit arsimor për rëndësinë e trajnimeve në zhvillimin e tyre profesional. Gjithashtu, pjesë e intervistës ishte edhe bashkëstudimi në mes dy sistemeve të arsimit dhe hapat e mëtejshëm, të cilët duhet ndërmarrë që qëndrimi mbi arsimin joformal të ndryshojë, si dhe mënyrat e mundshme të inkorporimit të elementeve të edukimit joformal në atë formal dhe ngritja e vetëdijes për një zbatim më të mirë të edukimit joformal në atë formal.

Për të mbledhur të dhënat e studimit, nëpërmjet elementeve të metodës cilësore u realizuan gjithsej 11 intervista gjysmë të strukturuar me drejtues të institucioneve, që ofrojnë edukim joformal; në mesin e tyre 9 drejtues të institucioneve jo formale në qytetin e Gjilanit dhe 2 drejtues të institucioneve joformale të qytetit të Preshevës. Brenda konceptit intervista gjysmë të strukturuar, si një teknikë e para planifikimit pjesor të pyetjeve u fokusua tek intervistat ballë për ballë. Fillimisht, atyre iu shpërndanë pyetjet e parapërgatitura dhe u udhëzuan për kohën, vendin dhe mënyrën e intervistës. Po ashtu, u kërkua që të dhënat e intervistave t'i bazonin edhe në dokumentacionin përkatës që u respektua nga ana e tyre, duke krijuar mundësinë për një veprimtari produktive. Krahas efikasitetit që të krijon kjo mënyrë e intervistës me subjektet përkatëse, u mbajt parasysh edhe fakti që intervista të ishte sa më e kontrolluar, pasi mund të kalohet caku i përmbajtjes së një pyetjeje; kjo edhe për faktin se problematika e edukimit joformal dhe bashkërendimi me shkollën e mesme është shumë e gjerë. Të gjitha intervistat u shqyrtuan dhe u bë përmbledhja dhe analiza e të gjitha përgjigjeve, ku shumica prej tyre paraqiten me fjalë më poshtë.

Përmbajtja e intervistave

U përdorën intervistat personale, si biseda verbale me të intervistuarit, me synim mbledhjen e informacionit të duhur për qëllimin e studimit. Fillimisht, në rolin e moderatorit, duke respektuar rregullat e kërkimit shkencor, u kërkua gatishmëria e tyre, duke i stimuluar për të dhënë përgjigje efikase. Pas një hyrjeje të shkurtër mbi rëndësinë dhe legjitimitetin e studimit u adresuan pyetjet e parapërgatitura, duke u lënë edhe kohën e nevojshme për përqëndrim.

U kërkua leje për regjistrimin e intervistës. U mbajtën shënime dhe u shqyrtua fakti nëse ata thoshin gjëra më interesante kur aparati i regjistrimit është i fikur. Gjithmonë, duke respektuar rregullin etik, të ndjerit qetë të të intervistuarve, shfaqja e interesit ndaj shpjegimeve të tyre. Nëpërmjet interpretimit të lëndës u kërkuan detaje mbi çështjet në studim, pa kaluar nga njëra pikë në tjetrën. Në përfundim të bisedës u falënderuan, duke u garantuar dhe një herë se gjithçka që u diskutua do të mbetej konfidenciale dhe do të përdorej vetëm për efekt studimi.

Mbi bazën e problematikës së pyetjeve u krijua hapësira për intervista gjysmë të strukturuar. Pra, mbi bazën e përgjigjeve dhe të një plani të menduar që më parë do të adresohen pyetje shtesë, për të saktësuar dhe detajuar problematikën.

Përmbajtja e intervistave, sikurse edhe e pyetësorëve, fokusohet në ndërthurjen e edukimit formal dhe joformal, mbështetur në problematikën dhe literaturën përkatëse. Më konkretisht ajo mbështetet në literaturën: "Arsimi joformal në Europë" Beograd, 2005, Grupa "Hajde që të..." Group "Let's...", në "Të mësuarit informal dhe joformal-analiza dhe perspektiva" Ese për diskutim, 2011, Giz, e autores Babette Loeëen, pastaj në "Arsimin joformal-fuqia e paparë e shoqërisë", Beograd, 2003. Disa pyetje janë marrë në librin e studiuesit Kovacevic, S. (2012) "Aktivitetet e organizatave ndërkombëtare në zbatimin e arsimit joformal në Malin e Zi". Paraprakisht është kontaktuar autori, për t'ju kërkuar leja e përdorimit të disa pyetjeve nga studimi i tij, me ç'rast është lejuar përdorimi i pyetjeve për intervistën.

3.9. Besueshmëria dhe vlefshmëria e kërkimit

Hulumtimi shkencor, ndryshe nga perceptimi kërkon zbatimin e kriterëve shkencorë, të cilat nuk janë qëllim në vetvete, por mundësojnë që kërkimi të jetë njëkohësisht edhe i besueshëm edhe i vlefshëm (Schaefer, R, Lamm, R, 1992:40). Që studimi të kishte shkallë të lartë besueshmërie intervistat u realizuan me *voice-recorder*, të cilat u hodhën në CD. Për të pasur një shkallë të lartë besueshmërie të intervistuarve u janë drejtuar pyetje të ngjashme, të cilat mundësojnë gjykim më të saktë mbi vërtetësinë e përgjigjeve të tyre. Duke vazhduar logjikën e vlefshmërisë së studimit, më poshtë autorët e sipërcituar nënvizojnë se “besueshmëria i referohet qëndrueshmërisë së përgjigjeve që ata japin” (Schaefer, R., Lamm, R., 1992: 40).

Po ashtu, studimi i përmbahet kriterëve të vlefshmërisë. Kjo nënkupton se u vlen institucioneve, subjekteve përkatëse, grupeve të interesuara....e lidhur dhe kushtëzuar me faktin që kampioni i zgjedhur të ishte përfaqësues i popullatës së zgjedhur për studimin e çështjes në fjalë. Ashtu, sikurse evidentohet, kampioni i përzgjedhur ishte përfaqësues pasi zotëronte shumicën e karakteristikave bazë të popullatës. Kjo edhe për faktin se përzgjedhja e kampionit u parapri nga vrojtime dhe pilotime, gjithnjë duke ndjekur logjikën e autorëve se “vlefshmëria i referohet faktit që kampioni është përfaqësues i fenomenit në studim” (Schaefer, R, Lamm, R., 1992: 40).

3.10. Kufizimet e studimit

Sikurse evidentohet, në studim u ndoqën të gjitha procedurat lehtësuese, që respondentëve t’u krijoheshin hapësirat e nevojshme për gjykim. Por, gjatë përgatitjes së studimit u has edhe në disa vështirësi e pengesa. Kështu, subjektet e intervistuar ndjeheshin më komod në biseda të lira, se sa kur ndodheshin para mjetit të regjistrimit. Në rastin e dytë ata ngurrnin për të shprehur mendimet pasi kishin ndonjë rezervë mbi veprimtaritë institucionale, programet dhe agjendat e përgatitjes qytetare të të rinjve. Me gjithë

konsideratat për stafet e institucioneve të edukimit formal dhe joformal, të cilët më ndihmuan në dhënien e informacioneve të nevojshme, kur vinte problemi për të evidentuar mangësitë institucionale për problematikën e edukimit joformal, vërehej një farë hezitimi. Mungesa e kërkimeve empirike dhe literaturës në vendin tonë, mund të konsiderohet, gjithashtu, si një kufizim për këtë studim.

Një vështirësi tjetër që është hasur në realizimin e këtij studimi ishte konstruktimi i pyetësorëve, që ka kërkuar një përkushtim të madh dhe kohë të gjatë, dhe që ka kërkuar shfletim të literaturës që ka të bëjë me fushën respektive. Po ashtu edhe procedura e mbledhjes së të dhënave ka qenë mjaft e vështirë, sepse disa pyetësorë për prindër që u janë dhënë nxënësve që t'i bartin në shtëpi për t'i plotësuar nuk janë kthyer. Vështirësi tjetër ka qenë marrja e dëshmive nga ana e disa koordinatorëve të institucioneve joformale, me rastin e realizimit të intervistave, ku më është dashur një kohë dhe përpjekje e vazhdueshme e kontaktit nëpërmjet telefonit për të ardhur deri te këto dëshmi.

Në kufizimet e studimit mund të veçojmë, gjithashtu, se disa mësimdhënës kanë pranuar të marrin pjesë jo me dëshirë në plotësimin e pyetësorëve. Për të kapërcyer këtë vështirësi, u desh ndjekja hap pas hapi, në terren, e problematikës, duke u dhënë orientime shpjeguese dhe të detajuara. Kjo përbën edhe një arsye më shumë për kryerjen e formave të tjera të vjeljes së informacionit.

Nga pikëpamja metodologjike studimi kufizohet në një varg të dhënash: ai shtrihet në shkollat e mesme të përgjithshme të dy qyteteve; është i limituar nga pikëpamja e përzgjedhjes së kampionit (532, 96, 317, 11) pjesëmarrës), sipas subjekteve përkatëse, ndërsa edukimi joformal përmban më shumë se 5-6 treguesit bazë që janë marrë në studim.

Kufizim vërehet edhe përsa i përket vlefshmërisë së jashtme- përgjithësimi të rezultateve të studimit përtej grupeve të marrë në analizë apo të vlefshmërisë së brendshme, që nënkupton diferencat midis pjesëtarëve të grupeve të marra si kampion. (Fraenkel, J. R., & Wallen, N. E., 2000).

3.11. Çështje etike

Etika si shkenca e moralit përbën një koncept të gjërë, që përfshin orientimin nga e mira e dobishmëria e studimit, duke respektuar parimet e së drejtës dhe privatësisë së çdo individi, përfshi këtu edhe ata që marrin pjesë me dëshirë në studim. Studimi përbën një sfidë për hulumtuesin dhe është i prirur nga efikasiteti i studimit, por kjo duke respektuar gjithmonë kriteret etike. Etika e studimit përbën një kërkesë të studimit dhe respektimi i saj mundëson trajtimin normal të çështjes në studim. Etika, si shkenca e moralit mund të konceptohet si "një grup i parimeve dhe rregullave të sjelljes morale" (Morroë& Richards, 1996 : 90).

Sikurse vënë në dukje Graham & Fitzgerald, "si e tillë ajo kap edhe fushën e kërkimit" (Graham & Fitzgerald 2010, : 134.). Veçori e kërkimit shkencor është se: "procesi etik mund të shihet si një proces i marrjes në pyetje, duke vepruar dhe reflektuar, dhe jo një zbatim i drejtpërdrejtë i rregullave të përgjithshme të sjelljes" (Gallagher, 2009, : 26), që rrit kujdesin e hulumtuesit për të siguruar një proces të rregullt etik si gjatë marrjes së të dhënave ashtu edhe në fazën e interpretimit, ruajtjes dhe publikimit të tyre.

Sikurse vë në dukje Alderson, etika hulumtuese "ndihmon kërkuesin që të jetë i vetëdijshëm për problemet e fshehta dhe pyetjet në hulumtim, për mënyrat që kanë të bëjnë me to dhe për faktin se nuk do të japë një përgjigje të thjeshtë " (Alderson, 2005:29).

Etika hulumtuese nuk mund të kufizohet, thjesht dhe vetëm tek marrja leje pranë institucioneve apo subjekteve përkatëse. Ajo përfshin qëllimin e hulumtimit; përfitimet; privatësinë dhe konfidencialitetin; përzgjedhjen e kampionit, përfshirjen dhe veçimin nga e popullata e zgjedhur me aspektet pozitive dhe mangësitë, që ka pjesa që përfaqëson të tërën. Etika hulumtuese përfshin: (1) shqyrtimin dhe rishikimin e qëllimeve kërkimore dhe metodat e zbatuara; (2) informacionin e marrë nga subjektet- objekt studimi, që në këtë hulumtim janë: nxënës të shkollave të mesme, prindërit dhe mësuesit e tyre apo subjektet e shoqërisë civile, që trajtojnë arsimin joformal; (3) pëlqimin e subjekteve të trajtuara si kampion; (4) ruajtjen nga hulumtuesi e shpërndarjen; (5) ndikimin që ka rezultati i studimit tek subjektet si dhe (6) politikën dhe reformat arsimore dhe shoqëria në tërësi.

Etika e studimit ka instrumentet e veta, ku bëjnë pjesë udhëzimet, kodet etike, komisionet, bordet etike, të cilat ndërtohen mbi bazën e standardeve që monitorojnë përputhshmërinë e propozimeve kërkimore dhe mundësojnë realizimin efikas të hulumtimit. Në studim mbahen në vëmendje gjithashtu standardet kërkimore të monitorimit, sikurse trajtohen në studimin e Alderson & Morrow, (2004). Etika shprehet në të gjithë hapat e studimit, në koherencën dhe kontekstin e paraqitjes së problematikës, në aspektet e identifikimit dhe përshkrimit të çështjes; në identifikimin dhe evidentimin e fakteve dhe vlerave të studimit; në përcaktimin e gjetjeve dhe zgjidhjet e mundshme dhe në justifikimin e përfundimeve.

Etika, si shkencë e moralit, ashtu si vetë morali është në evoluim. Kjo ndodh edhe me etikën e studimit. Etika e studimit zhvillohet sipas një konteksti të caktuar socio-historik, duke ndjekur problematikën më të re të zhvillimit. Një ndër studiuesit më në zë të çështjeve etike të studimit, Trussell thekson se "çështjet etike në hulumtime janë vazhdimisht në evolim, duke reflektuar ndryshimet epistemologjike të paradigmeve dhe praktikave metodologjike brenda një konteksti të caktuar socio-historik" (Trussell, 2008: 164).

Në problematikën etike, ashtu si edhe në problematikat e tjera, studimi mbështetet në literaturën, kryesisht atë të kohëve të fundit, në lidhje me çështjet etike të hulumtimeve për të rinj, sikurse janë edhe nxënësit e shkollës së mesme që janë objekt studimi. Posaçërisht, studimi në problematikën etike i referohet hulumtimeve të Alderson & Morrow, 2011; Hill, 2005; Farrell, 2005, Belmont (1974).

Përveç kësaj, etika përfshin metodat, procedurat që duhen ndjekur në analizën e problemit në mënyrë holistike, duke respektuar principet kryesore të studimit dhe të drejtave të njerëzve që janë bërë objekt studimi. Belmont (1974) evidenton tre parimet themelore etike që duhen respektuar në kërkimet që lidhen me njerëzit, të cilat janë: respektimi i personave objekt studimi; përfitimet e studimit dhe drejtësia në trajtimin dhe vlerësimin e problemit.

Individët, që marrin pjesë në studim kanë individualitetin dhe autonominë e tyre, çka duhet respektuar. Respektimi reciprok i të drejtës së hulumtuesit me të drejtat e individit që i kërkohet informacion mbi problematikën përkatëse është kusht për ecurinë e studimit.

Duke qenë se në studimet në shkencat sociale studiuesi është pjesë e studimit, duhet që nga njëra anë hulumtuesi të sigurojë objektivitetin e studimit, ndërsa nga ana tjetër nuk duhet të cënojë të drejtën e të anketuarve apo të intervistuarve që të marrin pjesë në studim; nuk duhet të detyrohen në asnjë mënyrë dhe duhet t'u sigurohet një mjedis i përshtatshëm komunikimi që të shprehen lirshëm për problematikën që është objekt studimi, duke respektuar pëlqimin e të rinjve për të marrë pjesë në studim, sikurse vënë në dukje studiues të kësaj fushe në studimet e tyre, p.sh. Alderson & Morrow, 2004; Cocks, 2006; Morrow & Richards, 1996.

Po ashtu hulumtuesi si pjesë e kërkimit shkencor duhet të përlllogaritë dhe të ndjekë me objektivitet përfitimet e studimit që mundëson marrjen e përfitimeve të mundshme, duke iu përmbajtur me objektivitet shkencor parashikimeve, parashkrimeve, nëpërmjet planifikimit, hartimit dhe zbatimit të studimit.

Drejtësia në zbatimin e studimit evidentohet kur ruhen raporte të drejta midis kërkuesit dhe kampionit të studimit; kur vendoset një barazi në anët e peshores, pa rënduar, paragjykuar apo emocionuar as njërin palë dhe as tjetrën. Kjo është kërkesë edhe e objektivitet shkencor, që mundëson bërjen e një hulumtimi të natyrshëm si çështje për studim. E drejta e nxënësve në përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive për të shprehur pikëpamjet e tyre është e njohur nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Të drejtat e tyre përfshijnë edhe fushën e etikës, sikurse edhe fushat e tjera të veprimtarisë së tyre, fakte që trajtohen në studimet e Porter, Hampshire & Bourdillon(2009), Bell, (2008), Robson, etj.

Problematika e gjërë e etikës hulumtuese është përmbledhur dhe trajtuar në një doracak praktik nga Alderson dhe Morroë (2004, 2011). Për më tej problematika është grupuar në katër kategori, sikurse evidenton Hill, e cila përmban problematikën si më poshtë:

“Përfshirja e fëmijëve apo të rinjve në hulumtim; respektimi i pëlqimit dhe zgjedhjes së tyre; evitimi i dëmit apo ankthit të mundshëm; ruajtja e privatësisë dhe konfidencialitetit”(Hill, 2005: 65.),

Etika e përzgjedhjes dhe komunikimit lidhet në mënyrë integrale me metodologjinë e studimit. Kjo sepse, aspekti konceptual i problematikës dhe ai praktik i bazuar në prova dhe

fakte lidhen dhe realizohen nëpërmjet metodologjisë kërkimore, duke ndjekur hapat dhe procedurat efikase për arritjen e përfundimeve të drejta dhe të vlefshme. Zgjedhjet metodologjike dhe etike të studimit kryhen jo vetëm konform procedurave të studimit, por edhe mbajnë në vëmendje interesat dhe prirjet e të rinjve objekt studimi. Ato sikurse evidentojnë Munford & Sanders, (2004), “zhvillohen në përshtatje me natyrën dhe statusin e fëmijës”. Përdorimi i mjeteve dhe teknikave të gabuara dëmton hulumtimin ashtu sikurse përdorimi i instrumenteve joefikase sikurse vënë në dukje Thomas & O’Kane, (1998), dhe e kundërta” rrit mundësitë për një produkt efikas, duke përfshirë edhe etikën e komunikimit”.

Trajtimi i kujdesshëm i të rinjve pjesëmarrës në studim është trajtuar nga një varg autorësh Hill, Davis, Prout & Tisdall(2004); Masson(2004); Miller (2000); Poëll & Smith(2009), etj. Ruajtja e të rinjve lidhur me informacionin që japin nuk shihet si një problematikë më vete, por e lidhur me të drejtën e tyre për t’u shprehur mbi problematikën që i shqetëson dhe bëhet objekt studimi, sikurse evidentohet në studimet e Poëll & Smith (2009), Graham & Fitzgerald (2010) etj.

Këto fakte lidhen me konfidencialitetin e të dhënave dhe autonominë e secilit për të trajtuar me pëlqim problematikën shkollore, për të mos abuzuar me të drejtën e të rinjve për t’u shprehur, që ndihmon edhe zhvillimin e tyre si qytetar aktiv, por ndihmon edhe studimin. Më e rëndësishme, kjo ndihmon edhe në trajtimin e drejtë dhe vënien në rrugën e zgjidhjes së problematikës shkollore, duke trajtuar problematikën administrative, qëndrimet subjektive, që në disa raste përpiqen të ruajnë gjendjen konkrete që mund të jetë problematike.

Për mbledhjen e të dhënave sasiore, paraprakisht u përgatit një kërkesë me shkrim drejtuar DKA-të në Gjilanit dhe Preshevës, në të cilën kërkohet leje për qasje në hulumtim në shkolla të mesme. Pas marrjes së lejes u kontaktua me drejtues të shkollave, në të cilat do të realizohej studimi, ku u njoftuan mbi qëllimin e këtij studimi, mbi përfshirjen e mësimeve, nxënësve dhe prindërve për mënyrën e realizimit të studimit.

Për sa i përket mbledhjes së të dhënave cilësore, paraprakisht, u kontaktuan me telefon me drejtues të institucioneve joformale, që u informuan lidhur me qëllimin e intervistës dhe marrjen e pëlqimit të tyre për t'u intervistuar. Guida për intervistë me drejtues të institucioneve joformale, paraprakisht u konstruktua. Nga pikëpamja metodologjike pyetjet u përcaktuan, por biseda nuk u kufizua duke ju përmbajtur pyetjeve strikt, por u zbatuan edhe elemente të një interviste gjysmë të strukturuar, me çka mundësohej bërja e pyetjeve pas pyetjesh, çka është edhe në natyrën e metodës së kërkimit cilësor, ku kërkuesi është pjesë e studimit dhe në mënyrë objektive synon të vjelë të dhëna të detajuara në funksion të studimit.

Realizimi i intervistës u zhvillua në formën e një bisede të lirë, në të cilën rëndësi të veçantë iu kushtua motivimit të të intervistuarve dhe krijimit të kushteve të përfitimit të një besimi reciprok, me synimin për të pasur të dhëna sa më të plota për studimin, dhe që intervistuesit të ndjeheshin mirë, pasi po trajtonin një çështje arsimore që i kishin kushtuar jetën e tyre profesionale dhe qytetare në misionin fisnik të mësimdhënies.

Pas një hyrjeje të shkurtër mbi rëndësinë dhe legjitimitetin e studimit u dorëzua protokoll i pyetjeve të përgatitura paraprakisht duke u lënë një kohë për përqëndrim. Mbi bazën e problematikës së pyetjeve u krijua hapësirë për intervista gjysmë të strukturuar. Kështu, mbi bazën e përgjigjeve dhe të një plani të menduar që më parë, të intervistuarve ju adresuan pyetje shtesë, për të saktësuar dhe detajuar problematikën e studimit. U është kërkuar leje për regjistrimin e intervistës.

U bë kujdes dhe u dhanë shpjegimet përkatëse që të intervistuarit të krijonin bindjen se informacionet e dhëna nga intervista nuk do të keqpërdoren për qëllime të tjera por vetëm për qëllimin e këtij studimi. Të gjitha përgjigjet e të intervistuarve janë incizuar dhe janë mbajtur shënime. Në përfundim të intervistës u shprehën falënderimet, duke u garantuar dhe njëherë se gjithçka që është diskutuar do të jetë konfidenciale dhe do të përdoret vetëm për efekt studimi. Përgjigjet e të intervistuarve më pas përfunduan në formularin e protokollit, pra është bërë transkriptimi i intervistës duke u fokusuar tek problematika dhe detajmi i saj, në rëndësinë që ka marrëdhënia cilësore midis shkollës dhe institucioneve

joformale, për formimin e nxënësve si qytetarë, problematikën individuale, sociale dhe profesionale. Intervistat u realizuan në vendndodhjet e qendrave përkatëse, përkatësisht në zyrat e drejtuesve të këtyre institucioneve joformale.

KAPITULLI IV: ANALIZA E TË DHËNAVE

Problematika e studimit është e gjërë dhe e ndërtuar sipas sistemit kaskad, që evidenton të gjitha përgjigjet që kanë dhënë respondentët, me çka mundsohet përdorimi i metodave deduktive, kalimin koherent nga formulimi i temës deri në adresimin e pyetjeve dhe induktive, që mundëson kalimin koherent nga pohimet rreth pyetjeve deri në testimin e hipotezave. Zbatimi i qasjes së kombinuar krijon mundësinë për të trajtuar të dhëna në aspektin sasior dhe cilësor. Studimi bazohet në të dhënat kategorike nominale, ordinale dhe metrike.

Nga ana e tyre të dhënat nominale, klasifikimi i objekteve, ndahen në klasa apo kategori, ku janë përcaktuar gjashtë kategori, klasa, ndarje apo faktorë në këtë studim. Ndërsa, kur trajtohen shkallët e preferencës, p.sh, sipas shkallës Likert, kategoritë ndahen sipas shkallës së të kuptuarit apo të pëlqyerit. Të dhënat diskrete dalin nga procesi i numërimit, ndërsa të dhënat e vazhduara shprehin një korrelacion, rankim dhe mundësojnë trajtimin e dukurive në fleksibilitetin e tyre. Të dhënat deskriptive shprehen me përqindje, ndërsa të dhënat inferenciale nëpërmjet testit binom *Chi-square*.

Krahas analizës me metodën deskriptive, e cila përdoret për të treguar se si ndikojnë faktorët e matshëm dhe të pamatshëm në ecurinë e një dukurie, në analizën e regresit studiohet në aspektin sasior edhe masa apo shkalla e ndikimit të faktorëve. Kështu në studim, nëse marrim si variabël të pavarur ndërveprimin midis faktorëve të ndërveprimit të EF me EJF, të detajuar në gjashtë faktorët përkatës, që janë variabla të varur si aftësitë akademike të nxënësve dhe aftësimin për jetën në aspektet individuale, sociale dhe profesionale, atëherë do të mund të shqyrtohen një varg rrethanash që trajtojnë këtë marrëdhënie.

Kështu, bërja e analizës statistikore të *marrëdhënieve midis variablave* do të mund të shpjegohej në mënyra të ndryshme, të tilla si: marrëdhënie në mes të variablave, ku mund të evidentohet prania apo mungesa e një marrëdhënie që mundëson pranimin apo refuzimin e hipotezës. Studimi rreket të provojë nëse ka një marrëdhënie midis ndërveprimit të EF

me EJT, në gjashtë faktorët e përcaktuar në studim dhe rritjes së aftësive, kompetencave të nxënësit të shkollës së mesme për jetën. Interes ka gjithashtu edhe drejtimi i marrëdhënieve. Kjo tregon se përmirësimi i marrëdhënieve ndërinstitutionale shkon në sensin pozitiv të zhvillimit të aftësive të rinjve.

Një element tjetër në studimin e kësaj dukurie përbën forca e marrëdhënies që tregon se cilësia e ndërveprimit të formave të edukimit forcon aftësitë dhe kënaqësitë e rinjve për të mësuar në lidhje me jetën dhe gjatë gjithë saj. Po ashtu, rëndësi ka edhe lloji i marrëdhënies, që tregon se ka mënyra të ndryshme, në të cilat variablat e pavaruri dhe të varur mund të ndajnë lidhjen, p. sh marrëdhënien lineare apo jolineare.

Chi *Square* përdoret kur të dy variablat maten me një shkallë nominale. Ajo mund të aplikohet në *intervalin ose ritmin* e të dhënave që janë kategorizuar në një numër të vogël të grupeve. *Chi-square* është shuma e diferencës në katror midis të dhënave të vërejtura (o) dhe atyre të pritshme (e). Devijimi (d), del nga përlogaritja e diferencës midis të dhënave reale që janë marrë me të dhënat e pritshme. Kjo analizë bëhet për të gjitha kategoritë e mundshme, sikurse janë në këtë studim gjashtë kategoritë e përcaktuar si variabla të pavarura. Testi chi-square bëhet përgjithësisht për të evidentuar atë që studiuesit e konsiderojnë hipoteza zero. Pra, nëse qëndrojnë apo jo kundrejt hipotezave të studimit. Hipoteza zero (H_0) do të thotë se nuk ka ndonjë dallim të qenësishëm midis rezultatit të pritshëm dhe atij të vëzhguar. ”Me anë të këtij testi konstatohet ekzistenca dhe korelacioni midis dy variablave, midis dy dukurive, të cilat kryqëzohen ose që janë paraqitur në shpërndarjen bivariate”(Murati, 2004: 464).

Formula e llogaritjes së chi-square është: $\chi^2 = \sum (f_v - f_t)^2 / f_t$, ...frekuencat e vërejtura(f_v) dhe frekuencat teorike(f_t)... gjendet dallimi midis frekuencave të vërejtura dhe atyre teorike($f_v - f_t$), dallimi ngrihet në katror $(f_v - f_t)^2$ dhe shuma e fituar pjesëtohet me frekuencën teorike ” (Murati, 2004: 464).

Kjo metodë supozon se vërtetimet provohen rastësisht nga popullata. Të gjitha vërtetimet janë të pavarura, një individ mund të shfaqet vetëm një herë në një bazë të dhënash dhe nuk ka mbivendosje kategorish. Nga kjo metodë nuk bëhen supozime në lidhje me formën e

shpërndarjes dhe as për homogjenitetin e variancës, përputhjen, që u pa më lartë tek Cronbach's Alpha. Frekuencat e vërejtura, pothuajse gjithmonë ndryshojnë nga frekuencat e pritshme për shkak të gabimit të kampionimit. Chi square mundëson për t'i dhënë përgjigje pyetjes se a janë këto dallime të konsiderueshme, apo ato janë për shkak të rastësisë?

Përcaktimi i shkallës së lirisë (df).

Shkalla e lirisë mund të llogaritet si numri i kategorive të problemit minus një (-1); do të thotë se një rasti me dy kategori i korrespondon një shkallë lirie, e kështu me radhë. Kështu duke iu referuar një tabele *chi-square* të shpërndarjes, sikurse Tabelës 31 dhe duke përdorur shkallët e duhura të “lirisë”, gjendet vlera më e përafërt për *chi-square*, e llogaritur në tabelë. Prej kësaj mund të përcaktohet vlera e përafërt e p (probabilitetit) lidhur me *chi-square*-n dhe shkallën e lirisë. Kështu *Pearson Chi-Square* përdoret si test statistikor për të dhënat e frekuencave. ”Koeficienti *Pearson*ose siç quhet koeficienti r është indikator që përdoret në statistikë për të konstatuar marrëdhënien midis dyvariablave, dy fenomeneve, dy problemeve që janë objekt i kërkimit”(Murati,2004:455).Magnituda e *Pearson Chi-Square*, sikurse sqarohet edhe më lart, pasqyron sasinë e mospërputhjes midis frekuencave të vëzhguara dhe frekuencave të pritshme.

Të dhënat analizohen në rrafshin e përshkrimit të dukurive, të përmbajtjes së edukimit dhe përgjithësimi i të dhënave në disa shkolla, si dhe të shtrirjes së kësaj dukurie në një masë më të gjerë. Përgjigjet e pyetjeve vijnë në mënyrë të përmbledhur në tabela e grafikë, për të cilat bëhen shpjegimet përkatëse si në rrafshin e analizës deskriptive ashtu edhe inferenciale.

Evidentimi i vlerave qytetare, që formësohen tek nxënësit e shkollave si objekt studimi, krijon një hapësirë për ta shtrirë fenomenin edhe për shkollat e mesme të Kosovës, fakt që mund të gjykohet mbi bazën e respektimit të kriterëve të shtrirjes së dukurisë.

Problematika e studimit është shumë e gjerë, prandaj është përdorur analiza e faktorëve, si metoda e reduktimit të të dhënave, duke u fokusuar në problematikën si më poshtë.

- Motivimi i nxënësve të shkollave të mesme për të mësuar me mënyra të ndryshme, brenda dhe jashtë procesit mësimor;
- Cilësia e mësimdhënies dhe nxënies, efikasiteti i të mësuarit ndikon si në nivelin akademik, po edhe përbën një element bazë për të përdorur koncepte dhe metodologji bashkëkohore, që i shërbejnë kultivimit të kompetencave të nxënësve të shkollave të mesme për jetën, në funksion të përdorimit të njohurive, aftësive, shprehive e qëndrimeve në çdo rrethanë jetësore e që realizohet nëpërmjet kujdesit dhe përkrahjes së të gjitha fashave të nxënësve dhe trajtimit të procesit mësimor- edukativ me koncepte dhe metodologji bashkëkohore të përgatitjes për jetën;
- Përshtatja me format e ndryshme të edukimit, formal, joformal dhe informal si dhe trajtimi komplementar i mënyrave të edukimit për integrimin efikas të shkollës me institucionet joformale, që ndjekin problematikën e zhvillimit arsimor dhe profesional;
- Formësimi i konstruksionit individual dhe social të nxënësit të shkollës së mesme për të superuar mëdyshjet që individi ka me veten dhe për t'u përshtatur në shoqëri në të gjitha segmentet e saj, që nga familja, arsimimi, edukimi nëpërmjet punës; përshtatja me kulturën institucionale, ndjekja e problematikës shoqërore, kombëtare dhe më gjerë në kushtet e globalizmit;
- Sendërtimi i vlerave qytetare dhe profesionale për të qenë qytetar të angazhuar, për t'u përshtatur kudo, kurdoherë, duke mbajtur qëndrime aktive në punë dhe jetë;
- Bashkëstudimi ndërinstitutional që umundëson nxënësve dhe mësimdhënësve përfitim të njohurive të reja dhe shkathtësive të cilat u ndihmojnë në jetë.

Pjesa më e madhe e subjekteve që morën pjesë në studim, nxënës, mësues e prindër u shprehën se janë dakord apo plotësisht dakord, fakt që evidentohet nga përgjigjet e pyetjeve që ju adresuan dhe analiza konkrete që bëhet rreth tyre, në problematikën e studimit në vijim.

Trajtimi i kategorive është në funksion të evidentimit të punës që bëhet si efekt i ndërveprimit institucional, formal dhe joformal dhe sensibilizimi i faktorëve dhe aktorëve për rritjen e efikasitetit të edukimit ndërveprues në rrafshet formale dhe joformale.

Duke iu përmbajtur analizës faktoriale, shqyrtimi i problematikës do të përvijojë duke u fokusuar tek variablat themelore, të cilat evidentohen gjatë hulumtimit. Kjo, për t'u fokusuar tek ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal për rritjen e nivelit akademik dhe konsolidimin qytetar me vlera individuale, sociale dhe profesionale. Në shqyrtimin e pohimeve rreth pyetjeve përdoret analiza faktoriale, që përbën një metodë reduktimi të pyetjeve dhe pohimeve për t'u fokusuar tek ato që vlerësohen si më thelbësore për studimin. Kjo bëhet duke u fokusuar në variablat e vëzhguara.

Pyetjet e anketave dhe skedat për intervistat ndahen në gjashtë dimensionë, sipas variablave të pavarur dhe të varur: (a) bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale; (b) edukimi komplementar dhe motivimi; (c) përkrahja në mësim për rritjen akademike; (d) konsolidimi i vlerave individuale dhe sociale; (e) konsolidimi i vlerave qytetare; (f) sendërtimi i vlerave profesionale.

4.1. Analiza statistikore e të dhënave sasore

Dallimet dhe krahasimi i qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve në varësi të variablave të varura.

Pyetja kërkimore: A ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në mesataret aritmetike të rezultateve të dala nga qëndrimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve në raport me variablat e varura: bashkëstudimi institucional, motivimi, përkrahja në mësim, individual dhe social, vlerat e punës tek nxënësi dhe ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal?

Hipoteza zero: Nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në mesataret aritmetike të rezultateve të dala nga qëndrimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve në raport me variablat e varura.

Hipoteza alternative: Ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në mesataret aritmetike të rezultateve të dala nga qëndrimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve në raport me variablat e varura.

Duke u mbështetur në analizën faktoriale të variancës kemi testuar rëndësinë e dallimeve në mes qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve në 6 variablat e varura, çka është konstatuar se ekzistojnë dallime të rëndësishme në mesataret e qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve. Nga kjo vërejmë se kemi qëndrime të ndryshme në shkallën e vlerësimit.

Tabela 31: Mesataret, devijimet standarde dhe variancat e qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve në 6 variablat.

Variablat	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve joformale	6.7784	2.7588	7.588	7.6508	2.45703	6.037
Edukimi komplementar dhe motivimi	7.6035	2.26341	5.123	7.5608	1.81681	3.301
Përkrahja në mësim për arritjen akademike	8.6764	2.70860	7.336	9.9048	2.60960	6.810
Zhvillimi personal dhe social	6.5860	2.38245	5.676	7.1105	2.39651	5.789

Vlerat e punës tek nxënësi	5.9446	2.06045	4.245	5.42857	1.598346	2.555
Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	7.3236	2.54611	6.483	8.1958	2.29680	5.275

Mbështetur në pyetjen kërkimore se: A ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në mesataret aritmetike të rezultateve të dala nga qëndrimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve të dy vendeve në raport me variablat e varura ? është bërë analizë e të dhënave sipas variablave të varur.

Variabli 1. Bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale (nxënës)

Niveli i parë i analizës kishte të bënte me ekzistencën e dallimeve të rëndësishme dhe krahasimin e qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve mbi trajtimin komplementar dhe shkallën e bashkëstudimit institucional. Shkalla bashkëstudimi institucional është shprehur nëpërmjet tri kategorive: bashkëstudimin e shkollës me organizatat që ofrojnë edukim joformal në ofrim të ligjeratave me tema që janë parësore për nxënësit. Duke analizuar frekuencat dhe përqindjet mbi bazën e vlerësimit të përshkallëzuar që kanë dhënë nxënësit e dy vendeve në lidhje me këtë kategori shohim se kemi një përqindje më të lartë në shkallët e vlerësimit 5- plotësisht pajtohem dhe 4-pajtohem të nxënësve të shkollave të Gjilanit 74.20 % në krahasim me nxënësit e shkollave të Preshevës 63.5 %, gjersa përqindje të ulët në shkallët e vlerësimit 1- nuk pajtohem aspak dhe 2- nuk pajtohem kemi të nxënësve të shkollave të Gjilanit 11.95% në krahasim me nxënësit e shkollave të Preshevës 22.44% .

Analiza e frekuencave dhe përqindjes së vlerësimit të nxënësve në lidhje me institucionet joformale dhe shkollat punojnë në realizim të projekteve të përbashkëta dhe fushatave vetëdijësuese për nxënës, tregojnë se gjithashtu kemi një përqindje më të lartë në shkallët e vlerësimit 5-plotësisht pajohem dhe 4- pajtohem të nxënësve të shkollave të Gjilanit 59.18% në krahasim me nxënës të shkollave të Preshevës 39.67 %. Sa i përket përqindjes së nxënësve të dy vendeve në shkallët e vlerësimit 1- nuk pajtohem aspak dhe 2- nuk pajtohem, kemi 16.61 % e nxënësve të shkollave të Gjilanit dhe 25.92 % të nxënësve të shkollave të Preshevës.

Në lidhje me bashkëstudimin në mes institucioneve joformale dhe shkollave në ofrim të mundësive për të marrë pjesë në aktivitete dhe seksione të ndryshme shkollore dhe jashtëshkollore, analiza e frekuencave dhe përqindjes tregon se kemi një përqindje prej 5.79% më të lartë (68.21 %) të nxënësve të shkollave të Gjilanit në krahasim me nxënës të shkollave të Preshevës (62.42 %), në shkallët e vlerësimit 5- plotësisht pajohem dhe 4- pajtohem. Në shkallët e vlerësimit 1- nuk pajtohem aspak dhe 2- nuk pajtohem, kemi një përqindje më të lartë të vlerësimit të nxënësve të Gjilanit (16.6%) në krahasim me nxënës të shkollave të Preshevës (11.1 %).

Vlerat e sigma-s për të gjithë treguesit e këtij Variabli ishin $p=.000$; $p=.000$; $p=.002$ $p=0.05$, gjë që konfirmon se ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në rezultatet e qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve në këtë variabël.

Tabela32: Vlerat e mesatares aritmetike dhe devijimit standard të variablit të parë

FA1	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale	6.7784	2.7588	7.588	7.6508	2.45703	6.037

Nga analiza krahasuese, rezulton se nxënësit e shkollave të Gjilanit vlerësojnë bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale (MA=6.7784, DS=2.7588 dhe V=7.588) me një vlerë mesatare 0.8724 më të ulët se nxënësit e shkollave të Preshevës (MA=7.6508, DS= 2.45703 dhe V= 6.037).

Në përgjithësi mund të themi se nxënësit e shkollave të Preshevës kanë vlerësuar më lart bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale se nxënësit e shkollave të Gjilanit.

Variabli 2. Edukimi komplementar dhe motivimi

Duke u mbështetur në metodën joparametrike testi-t, vlerat e sigma-s për të gjithë treguesit e analizuar të këtij variabli kishin vlera më të vogla se se niveli i rëndësisë, për ”orët e mësimit plotësues më ndihmojnë që të pasuroj dhe përsos dijet e mia” vlera e $p = .000$; për treguesin ”shkolla lavdëron rregullisht suksesin e arritur në aktivitete jashtëmësimore” vlera e $p = .000$ dhe për treguesin ”së bashku me mësimdhënësin marr pjesë në përpilimin e programeve të aktiviteteve jashtëmësimore në shkollë” vlera e $p = 0.011 < p = 0.05$, çka konfirmon se kemi dallime të rëndësishme në qëndrimet ndaj ndikimit të edukimit komplementar në motivim. Mbështetur në analizat dhe krahasimet e vlerave mesatare dhe devijimeve standarde është konstatuar dallim i rëndësishëm në mesataret e qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve në të gjitha kategoritë e këtij variabli.

Tabela33: Paraqitja e mesatares dhe devijimit standard të variablit të dytë

FA2	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Edukimi komplementar dhe motivimi	7.6035	2.26341	5.123	7.5608	1.81681	3.301

Nga analiza krahasuese, rezulton se nxënësit e shkollave të Gjilanit vlerësojnë edukimin komplementar dhe motivimin (MA= 7.6035, DS=2.26341 dhe V=5.123) me një vlerë

mesatare 0.0427 më të lartë se nxënësit e shkollave të Preshevës (MA=7.5608, DS=1.81681 dhe V= 3.301).

Në përgjithësi mund të themi se nxënësit e dy vendeve kanë qëndrime pozitive të përafërta ndaj edukimit komplementar dhe motivimit.

Variabli 3. Përkrahja në mësim për rritjen akademike

Për të analizuar të dhënat e këtij variabli është ngritur nënhipoteza H_a : Ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në rezultatet e qëndrimeve të nxënësve për përkrahjen në mësim për rritjen akademike të nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve të Gjilanit dhe atyre të Preshevës. Duke u mbështetur në metodën joparametrike testi-t vlerat e sigma-s për të gjithë treguesit e analizuar të këtij variabli kishin vlera më të vogla se se niveli i rëndësisë $p=0.05$, për në shkollë na mësojnë se si të nxëmë, na trajtojnë teknika të ndryshme të të nxënësve, vlera e $p= .000$; për treguesin "mësimdhënësit, jashtë procesit mësimor, nëpërmjet mësimin plotësues i ndihmojnë nxënësit që të përparojnë" vlera e $p= .000$ dhe për treguesin "nxënësve të talentuar u janë mundësuar forma të posaçme të punës jashtë procesit të rregullt mësimor nëpërmjet mësimin shtesë, seksioneve, punë hulumtuese " vlera e $p= 0.000$ $<p=0.05$, çka konfirmon se kemi dallime të rëndësishme në qëndrimet ndaj përkrahjes në mësim për rritjen akademike.

Mbështetur në analizat dhe krahasimet e vlerave mesatare dhe devijimeve standarde është konstatuar dallim i rëndësishëm në mesataret e qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve në të gjitha kategoritë e këtij variabli.

Nga analiza krahasuese, rezulton se nxënësit e shkollave të Gjilanit vlerësojnë edukimin komplementar dhe motivimin (MA= 8.6764, DS=2.70860 dhe V= 7.336) me një vlerë mesatare 1.2284 më të ulët se nxënësit e shkollave të Preshevës (MA=9.9048, DS=2.60960 dhe V= 6.810).

Tabela 34: Vlera e mesatares aritmetike dhe devijimit standard për variablin e tretë

	Gjilan	Preshevë
--	--------	----------

FA3	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Përkrahja në mësim për rritje akademike	8.6764	2.70860	7.336	9.9048	2.60960	6.810

Shikuar në përgjithësi, nxënësit e shkollave të Gjilanit kanë një mendim më pak pozitiv ndaj përkrahjes në mësim se sa nxënësit e Preshevës.

Variabli 4. Zhvillimi personal dhe social

Në kuadër të nivelit zhvillimi personal dhe social është konstatuar dallim i rëndësishëm statistikor në qëndrimet e nxënësve të Gjilanit dhe Preshevës në të gjitha kategoritë e këtij variabli, me vlera të $p = .000$, $p = .000$ dhe $p = .000$. Analiza e të dhënave të hulumtimit tregon se ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në qëndrimet e nxënësve të Gjilanit dhe nxënësve të Preshevës. Bazuar në vlerat e mesatareve dhe devijimit standard ($MA=7.1058$, $DS=2.39899$ dhe $V=5.755$) për nxënësit e Preshevës, të cilët kanë vlerësuar më lart me vlerë 0.5198 se sa nxënësit e Gjilanit me ($MA=6.5860$, $DS=2.38245$ dhe $V=5.676$). Pra, mund të themi se në këtë fushë tregojnë një nivel më të lartë 0.51 të vlerësimit nxënësit e Preshevës ndaj nxënësve të Gjilanit.

Tabela35: Vlerat e mesatareve dhe devijimit standard për variablin e katërt

FA4	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Zhvillimi personal dhe social	6.5860	2.38245	5.676	7.1058	2.39890	5.755

Nga analiza krahasuese, rezulton se nxënësit e shkollave të Gjilanit vlerësojnë *zhvillimin individual dhe social* ($MA=6.5860$, $DS=2.38245$ dhe $V=5.676$) me një vlerë mesatare

0.5198 më të ulët se nxënësit e shkollave të Preshevës (MA=7.1058, DS= 2.39890 dhe V= 5.755).

Në përgjithësi mund të themi se nxënësit e shkollave të Gjilanit kanë një mendim më pak pozitiv ndaj zhvillimit individual dhe social se sa nxënësit e Preshevës.

Variabli 5. Vlerat e punës tek nxënësi

Në këtëvariabël përfshihen tre kategori tek të cilat është vërejtur dallim i rëndësishëm në qëndrimet e nxënësve të dy vendeve. Analiza e të dhënave të hulumtimit tregon se ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në qëndrimet e nxënësve të Gjilanit dhe nxënësve të Preshevës, bazuar në vlerat e sigma-s ($p = .023$, $p = 0.012$ dhe $p = 0.007$ $\alpha < 0.05$) dhe vlera të (MA=5.94461, DS= 2.060452 dhe V=4.245) për nxënësit e Gjilanit, dhe (MA= 5.42857, DS= 1.59834 dhe V= 2.555) për nxënësit e Preshevës në lidhje me variablin e pestë që ka të bëjë me vlerat e punës tek nxënësi.

Nga analiza krahasuese rezulton se nxënësit e shkollave të Gjilanit vlerësojnë *zhvillimin individual dhe social* (MA= 5.94461, DS=2.060452 dhe V= 4.245) me një vlerë mesatare 0.5160 më të lartë se nxënësit e shkollave të Preshevës (MA=5.42857, DS= 1.59834 dhe V= 2.555).

Në përgjithësi mund të konkludojmë se janë të dukshme dallimet në vlerësimet e qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve. Pra, nxënësit e shkollave të Gjilanit kanë vlerësuar më lart vlerat e punës tek nxënësit, se sa nxënësit e Preshevës.

Tabela 36: Vlerat e mesatareve aritmetike dhe devijimit standard të variablit të pestë

FA5	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Vlerat e punës tek nxënësi	5.94461	2.060452	4.245	5.42857	1.59834	2.555

Variabli 6.Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional.

Kur kemi të bëjmë me ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional, gjithashtu kemi dallime të rëndësishme në qëndrimet e nxënësve të dy vendeve me vlera $p=.000$; $p=.000$ dhe $p=.001$.

Tabela37: Vlerat e mesatareve aritmetike dhe devijimit standard tëvariablit të gjashtë

FA6	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	7.3236	2.54611	6.483	8.1958	2.29680	5.275

Nga analiza krahasuese, rezulton se nxënësit e shkollave të Gjilanit vlerësojnë *Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional* ($MA=7.3236$, $DS=2.54611$ dhe $V=6.483$) me një vlerë mesatare 0.8724 më të ulët se nxënësit e shkollave të Preshevës ($MA=8.1958$, $DS=2.29680$ dhe $V=5.275$).

Shikuar në përgjithësi, nxënësit e shkollave të Gjilanit kanë një mendim më pak pozitiv ndaj ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional se sa nxënësit e Preshevës.

Përmbledhja e të dhënave të dala nga analiza e vlerësimeve të nxënësve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar të edukimit në rrafshin formal dhe joformal

Krahasimi i të dhënave të dala nga vlerësimet e nxënësve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar në rrafshin formal dhe joformal në gjashtëvariablat përkatës tregojnë se nxënësit e dy vendeve kanë qëndrime pozitive, pra vlerësojnë lart trajtimin

komplementar të dy formave të edukimit. Megjithatë, në të gjitha variablat e matura ekzistonin dallime të rëndësishme statistikore, mirëpo këto dallime nuk ishin shumë të theksuara.

Kështu dallim më i theksuar vërehet tek variabli i tretë me vlerë 1.2284 dhe variabli i parë dhe i gjashtë 0.8724, ndërsa më pak i theksuar tek variabli i dytë 0.0427. Nëse shikojmë dhe analizojmë linjën e vlerave të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve për të gjitha variablat, vërejmë se dallimet janë të vogla. Kështu nxënësit e Preshevës kanë vlerësuar më lart me vlera të shtuara të mesatareve aritmetike 0.8724, 1.2284, 0.519 dhe 0.8724 në katër variablat (FA1, FA3, FA4 dhe FA6), se nxënësit e shkollave të Gjilanit ku nëvariablin FA2 dhe FA3 nxënësit e Gjilanit kanë vlerësuar më lart me vlerë të shtuar të mesatareve aritmetike 0.0427 dhe 0.5160.

Por, shikuar në përgjithësi nxënësit e dy vendeve kanë qëndrime pozitive rreth ndërveprimit të dy formave të edukimit dhe efektit që ka kjo linjë e dy formave të edukimit në përgatitjen e nxënësve me vlera qytetare.

- Nxënësit e shkollave të Preshevës vlerësojnë bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin e tyre me vlerë mesatare 0.8724 më të lartë se nxënësit e shkollave të Gjilanit
- Motivimin për të mësuarit akademik, nxënësit e shkollave të Gjilanit e vlerësojnë me vlerë mesatare 0.0427 më të lartë se nxënësit e shkollave të Preshevës. Megjithatë tek ky variabël kemi qëndrime të përafërta të nxënësve të dy vendeve.
- Përkrahjen në mësim për rritje akademike, nxënësit e shkollave të Preshevës e vlerësojnë më lart me vlerë 1.2284 se nxënësit e shkollave të Gjilanit.
- Zhvillimin individual dhe social, nxënësit e shkollave të Preshevës e vlerësojnë më lart se sa nxënësit e shkollave të Gjilanit me vlerë 0.5198.
- Vlerat qytetare tek nxënësi, i kanë vlerësuar me vlerë 0.5160 më të lartë nxënësit e shkollave të Gjilanit se sa nxënësit e shkollave të Preshevës.

- Ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional, për një vlerë më të lartë prej 0.8724 e kanë vlerësuar nxënësit e shkollave të Preshevës se sa nxënësit e shkollave të Gjilanit.

Konstatimi i rëndësisë statistikore e dallimeve në mes qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve dhe analiza e vlerave të mesatareve aritmetike në gjashtë variablat e varura të përcaktuara, tregon se kemi dallime në qëndrimet e nxënësve të dy vendeve, mirëpo këto dallime nuk janë aq të theksuara. Megjithatë nxënësit e dy vendeve janë të vetëdijshëm se ndërveprimi i dy formave të edukimit kanë efekt të konsiderueshëm në përgatitjen e tyre për jetën.

Tabela 38: Vlerat e shtuara të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të nxënësve për të gjitha variablat

Variablat	Vlerat e shtuara të mesatareve aritmetike
Bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve joformale	0.8724
Motivimi për të mësuarit akademik	0.0427
Përkrahja në mësim për rritje akademike	1.2284
Zhvillimi individual dhe social	0.5198
Vlerat qytetare tek nxënësi	0.5160
Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	0.8724

Dallimet dhe krahasimi i qëndrimeve të mësimeve të dy vendeve në varësi të variablave të varura.

Njëra ndër pyetjet e hulumtimit kishte të bënte se a ekzistojnë dallime të rëndësishme në qëndrimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve të dy vendeve në varësi me 6 variablat e varur. Për të konstatuar ekzistencën apo jotë dallimeve të rëndësishme

statistikore dhe krahasimin e qëndrimeve të mësimdhënësve të dy vendeve është bërë analiza e variancës në 6 variablat përkatës të dalë nga pyetësi imësimdhënësve.

Variabli 1. Bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin profesional të mësimdhënësve

Variablii parë ka të bëjë me “bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin profesional të mësimdhënësve” përmban tri kategori si: institucionet joformale dhe shkollat punojnë në realizim të projekteve të përbashkëta dhe fushatave vetëdijësuese për nxënës dhe në zhvillimin profesional të mësimdhënësve; bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim profesional; shkolla në bashkëpunim me institucionet joformale kanë ofruar trajnime dhe seminare të akredituara në drejtim të zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

Analiza e të dhënave të këtij variabli është testuar nëpërmjet analizës së variancës ku është testuar rëndësia e dallimeve ndërmjet qëndrimeve të mësimdhënësve të Gjilanit dhe mësimdhënësve të Preshevës, çka është konstatuar se ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në mesataret e qëndrimeve të mësimdhënësve të dy vendeve me vlerë të sigma-s $p=.000 < p=0.05$.

Nga analiza krahasuese, rezulton se mësimdhënësit e shkollave të Gjilanit vlerësojnë bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin profesional të mësimdhënësve (MA= 4.6154, DS=1.53590 dhe V=2.359) me një vlerë mesatare 1.5437 më të ulët se nxënësit e shkollave të Preshevës (MA=6.1591, DS= 2.23027 dhe V= 4.974).

Tabela39: Vlerat e mesatares dhe devijimit standard të variablit një të mësimdhënësve

FA1	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca

Bashkëstudimi i shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin profesional të mësimeve	4.6154	1.53590	2.359	6.1591	2.23027	4.974
---	--------	---------	-------	--------	---------	-------

Variabli 2. Motivimi për të mësuarit akademik

Variabli i dytë ka si tregues motivimi për të mësuarit akademik i cili përfshin këto kategori: i nxis nxënësit që në mënyrë të pavarur të arrijnë njohuri dhe shkathtësi plotësuese; i lavdëroj dhe shpërblej arritjet e njohurive dhe shkathtësive plotësuese që promovojnë të mësuarit në mënyrë të pavarur dhe përdor forma, metoda dhe teknika të ndryshme pune gjatë procesit mësimor, sepse nxënësit kanë stil, aftësi dhe interesa të ndryshme të mësimnxënies. Vlerat $p=.012$ $p=.001$ dhe $p = .000 < \alpha = 0.05$ tregojnë se kemi dallim të rëndësishëm statistikor në variablin e dytë motivimi për të mësuarit akademik.

Nga analiza krahasuese vlerave të mesatareve aritmetike dhe devijimit standard, rezulton se mësimeve të shkollave të Gjilanit vlerësojnëse motivimi për të mësuarit akademik ($MA= 5.4423$, $DS=1.37789$ dhe $V= 1.899$) me një vlerë mesatare 0.4423 më të lartë se mësimeve të shkollave të Preshevës ($MA=5.0000$, $DS= 1.14119$ dhe $V= 1.302$).

Tabela 40: Vlerat e mesatareve dhe devijimit standard për variablin dy të mësimeve

FA2	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Motivimi për të mësuarit akademik	5.4423	1.37789	1.899	5.0000	1.14119	1.302

Shikuar në përgjithësi, mësime dhënësit e shkollave të Gjilanit kanë një mendim më pozitiv ndaj motivimit dhe edukimit komplementar se sa mësime dhënësit e Preshevës.

Variabli 3. Përkrahja në mësime për rritje akademike

Në variablin e tretë si tregues kemi përkrahjen në mësime për rritje akademike që përmban dy kategori: mësime dhënësit jashtë procesit mësues, nëpërmjet mësimit plotësues indihmojnë nxënësit që të përparojnë; i përkrah dhe indihmojnë nxënësit që të organizojnë aktivitete të ndryshme kulturore, artistike, sportive dhe aktivitete të ngjajshme. Mbështetur në vlerat e $p = 0.023$ dhe $p = 0.000$ dhe të mesatareve aritmetike të dy kategorive të këtij variabli, rezulton se në variablin e tretë që ka të bëjë me përkrahjen në mësime ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në qëndrimet e mësime dhënëseve.

Nga analiza krahasuese, rezulton se mësime dhënësit e shkollave të Gjilanit vlerësojnë përkrahjen në mësime për rritje akademike (MA= 3.5577, DS=.95821 dhe V= .918) me një vlerë mesatare 0.1941 më të lartë se nxënësit e shkollave të Preshevës (MA=3.3636, DS= .96668 dhe V= .934).

Tabela 41: Vlerat e mesatareve dhe devijimit standard për variablin e tretë të mësime dhënëseve

FA3	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Përkrahja në mësime për rritje akademike	3.5577	.95821	.918	3.3636	.96668	.934

Shikuar në përgjithësi, mësime dhënësit e shkollave të Gjilanit dhe të Preshevës kanë qëndrime pozitive menjë dallim jo shumë të theksuar ndaj përkrahjes në mësime për rritje akademike.

Variabli 4. Zhvillimi individual dhe social

Variabli i katërt përbëhet nga treguesi zhvillimi individual dhe social që ka këto kategori: nxënës të cilët zbulojnë dhe zhvillojnë talentet e tyre duke marrë pjesë në aktivitete jashtëmësimore që u ofrohen; nëpërmjet arsimit joformal kam zhvilluar shkathtësi komunikative dhe të punës me individin.

Në këto faktorë përfshihen dy kategori tek të cilat është vërejtur dallim i rëndësishëm në qëndrimet e mësimit të dy vendeve me vlerat e sigma-s ($p = .000$ dhe $p = 0.012$ $\alpha < 0.05$).

Nga analiza krahasuese, rezulton se mësimit të shkollave të Gjilanit vlerësojnë zhvillimin individual dhe social (MA= 2.7692, DS=1.00226 dhe V= 1.005) me një vlerë mesatare 0.299 më të ulët se mësimit të shkollave të Preshevës (MA=3.0682, DS=.94985 dhe V=.902).

Tabela 42: Vlerat e mesatare dhe devijimit standard për variablin e katërt të mësimit

FA4	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Zhvillimi individual dhe social	2.7692	1.00226	1.005	3.0682	.94985	.902

Shikuar në përgjithësi vlerat e mesatare të qëndrimeve të mësimit të shkollave të Preshevës dallojnë nga ato të mësimit të Preshevës.

Variabli 5. Vlerat qytetare tek nxënësi

Treguesi vlerat qytetare tek nxënësi i takon variablit të pestë në të cilin përfshihen kategoritë: nxënës të respektojnë mendimin e të tjerëve dhe tek nxënësit nxënës solidaritetin dhe kujdesjen për njëri tjetrin, veçanërisht në rastet të shfaqjes etnike, racore,

fetare dhe paragjytimeve gjinore. Në kuadër të këtij variabli është konstatuar dallim i rëndësishëm statistikor me $p = .000 < \alpha = 0.05$ në qëndrimet e mësimeve të dy vendeve.

Tabela 43: Vlera e mesatare dhe devijimit standard të variablit të pestë të mësimeve

FA5	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Vlerat qytetare tek nxënësi	4.2308	.89914	.808	3.7727	.93668	.877

Nga analiza krahasuese e të dhënave, rezulton se mësimeve të shkollave të Gjilanit vlerësojnë *vlerat qytetare tek nxënësit* (MA= 4.2308, DS=.89914 dhe V= .808) me një vlerë mesatare 0.4581 më të lartë se mësimeve të shkollave të Preshevës (MA=3.7727, DS= .93668 dhe V= .877).

Shikuar në përgjithësi mësimeve të shkollave të Gjilanit kanë një mendim më pozitiv ndaj vlerave qytetare tek nxënësit se mësimeve të shkollave të Preshevës, çka dallimet flasin për një nivel të ndryshëm të qëndrimeve të mësimeve të dy vendeve.

Pra, mund të themi se edhe mësimeve të Gjilanit dhe të Preshevës edhe përkundër dallimit të vogël që ekziston në vlerësimin e tyre punojnë në nxitje të arritjeve të vlerave qytetare tek nxënësit çka është me rëndësi se në edukimin global vlera qytetare përbën njërin nga kompetencat kyçe të cilën individi duhet ta arrijë gjatë jetës së tij.

Variabli 6. Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional

Në variablin e gjashtë, i cili është ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional ka 12 kategori. Në variablin e gjashtë i cili ka të bëjë me ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe

formimin profesional, janë konstatuar se ekzistojnë dallime të rëndësishme në qëndrimet e mësimeve të dy vendeve, me vlera të $p=.001$, $p=.000$, $p=.012$, $p=.002$, $p=.000$, $p=.014$, $p=.001$, $p=.000$, $p=.033$, $p=.000$, $p=.015$, $p=.004 < \alpha=0.05$ për të gjithë kategoritë e këtij Variabli.

Nga këto të dhëna mund të themi se mësimeve të Preshevës kanë qëndrim më pozitiv ndaj edukimit joformal dhe janë të vetëdijshëm se edukimi joformal ka ndikuar në zhvillimin e shkathtësive të mësimeve të cilët kanë mund të marrin nëpërmjet trajnimeve,seminareve të ndryshme.Gjithashtu, mësimeve të Preshevës janë më optimist dhe të vetëdijshëm, se mësimeve të Gjilanit se nëpërmjet edukimit joformal kanë zhvilluar shkathtësi të atilla që shpien në krijimin e një atmosfere pozitive dhe motivuese për mësim dhe punë të pavarur të nxënësve.

Mund të themi se mësimeve të dy vendeve janë të vetëdijshëm se zbatimi i metodave të ndryshme të punës me individin në klasë kontribuon zhvillim të kompetencave individuale dhe profesionale të mësimeve dhe zhvillimit të nxënësve,çka mundëson krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për mësim dhe të nxënësve aktiv.

Mësimeve të dy vendeve janë të vetëdijshëm se përdorimi i metodave grupore gjatë mësimdhënies ka një efekt pozitiv në zhvillimin e komunikimit,bisedës dhe shkëmbim të përvojave çka kontribuon në zhvillimin social të nxënësve.Po ashtu, vlen të theksohet se mësimeve në përgjithësi janë të vetëdijshëm mbi përparësitë që sjellin trajnimet e sidomos në zhvillimin e aftësive bashkëpunuese,shkathtësive të caktuara dhe në arritjen e kompetencave shoqërore.

Mësimeve të dy vendeve kanë një qëndrim pozitiv dhe janë të vetëdijshëm se trajnimet që organizohen në kuadër të edukimit joformal në drejtim të zhvillimit të tyre dhe formimit profesional kontribuojnë produktivitet më të lartë dhe i motivojnë më shumë mësimeve për punën e tyre edukativo-arsimore.

Megjithatë kemi qëndrime të përafërta në mes mësimeve të dy vendeve çka konsiston se mësimeve të dy vendeve kanë qëndrime pozitive përse përket ndikimit të

ndërthurrjes së edukimit formal dhe joformal në rritjen e performancës dhe zhvillimit profesional të tyre, kur dihet se zhvillimi profesional është një proces në të cilin përfshihen përvojat formale dhe joformale të mësimdhënësve, nëpërmjet të cilit mësimdhënësit zhvillojnë dhe përparojnë njohuritë e tyre, arrijnë njohuri shtesë, fitojnë shkathtësi të nevojshme për punën e tyre edukative drejt arritjeve të kompetencave profesionale me qëllim që të kemi cilësi të mësimdhënies në shkolla.

Mësimdhënësit e dy vendeve kanë qëndrime të njëjta dhe janë të vetëdijshëm për ndikimin që ka lidhja e edukimit formal dhe joformal në rritjen e motivimit dhe arritjen e kompetencave individuale dhe profesionale të mësimdhënësve. Motivimi i mësimdhënësve është një aspekt i rëndësishëm të cilin duhet ta ketë çdo mësimdhënësi në mënyrë që të mund të kombinojë njohuritë, shkathtësitë e tij për të arritur sukses në mësim dhe në arritje dhe zhvillim të kompetencave individuale dhe profesionale të nevojshme që të jenë të suksesshëm në punë dhe shoqëri. Përforsimi i njohurive, arritja e aftësive dhe zhvillimi i shkathtësive të ndryshme nëpërmjet dy formave të edukimit mundësojnë një përgatitje dhe zhvillim më të mirë në formimin profesional dhe në jetë.

Të gjithë mësimdhënësit ishin të mendimit se elementet e edukimit joformal mund të trajtohen në edukimin formal, e si elemente veçojnë punën në grup, punën e bazuar me projekte, zbatimin e metodave dhe teknikave të punës, të cilët mund të arrihen nëpërmjet zhvillimit profesional të mësimdhënësve, trajnimeve dhe seminareve të vazhdueshme për mësimdhënësit.

Në bazë të analizës krahasuese konkludojmë se mësimdhënësit e shkollave të Preshevës me $MA = 3.8409$, $DS = 1.25648$ dhe $V = 1.579$, vlerësojnë më lart me një vlerë 0.14 të shtuar nga mësimdhënësit e Gjilanit me $MA = 3.6923$, $DS = 1.27631$ dhe $V = 1.629$.

Tabela 44: Vlera e mesatares dhe devijimit standard për FA6 të mësimdhënësve

FA6	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca

Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	3.6923	1.27631	1.629	3.8409	1.25648	1.579
--	--------	---------	-------	--------	---------	-------

Në përgjithësi mund të konstatojmë se vlerat e mesatareve aritmetike flasin se dallime në qëndrimet e mësimdhënësve të dy vendeve ekzistojnë, por ato dallime nuk janë shumë të theksuara, çka tregon se mësimdhënësit e dy vendeve kanë qëndrime të përafërta dhe kanë vlerësuar lart, pra pajtohen me mendimin se ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal ndikon në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional.

Përmbledhja e të dhënave të dalta nga vlerësimet e mësimdhënësve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar të edukimit në rrafshin formal dhe joformal

Të dhënat e përftuara nga krahasimi i vlerësimeve të mësimdhënësve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar në rrafshin formal dhe joformal në gjashtëvariablat përkatës tregojnë se mësimdhënësit e dy vendeve kanë qëndrime pozitive, pra vlerësojnë lart trajtimin komplementar të dy formave të edukimit. Megjithatë, në të gjitha variablat e matura ekzistonin dallime të rëndësishme statistikore, mirëpo këto dallime nuk ishin shumë të theksuara. Kështu dallimi më i theksuar vërehet tek variabli i parë me vlerë 1.5437 dhe variabli i pestë 0.4581 ndërsa më pak i theksuar tek variabli i gjashtë 0.14. Nëse shikojmë dhe analizojmë linjën e vlerave të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të mësimdhënësve të dy vendeve për të gjitha variablat, vërejmë se qëndrimet respektivisht vlerësimet e mësimdhënësve të dy vendeve përputhen, çka flet se ekziston mendimi pozitiv dhe vetëdijësues i mësimdhënësve se ndërveprimi i dy formave të edukimit ka një efekt të konsiderueshëm në përgatitjen e nxënësve me vlera qytetare dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

- Mësimdhënësit e shkollave të Preshevës vlerësojnë bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin profesional të mësimdhënësve me vlerë mesatare 1.54 më të lartë se mësimdhënësit e shkollave të Gjilanit.
- Motivimin për të mësuarit akademik, mësimdhënësit e shkollave të Gjilanit e vlerësojnë me vlerë mesatare 0.44 më të lartë se mësimdhënësit e shkollave të Preshevës.
- Përkrahjen në mësim për rritje akademike, mësimdhënësit e shkollave të Gjilanit e vlerësojnë më lart me vlerë 0.19 se mësimdhënësit e shkollave të Preshevës.
- Zhvillimin individual dhe social, mësimdhënësit e shkollave të Preshevës e vlerësojnë më lart se sa mësimdhënësit e shkollave të Gjilanit me vlerë 0.29.
- Vlerat qytetare tek nxënësi i kanë vlerësuar me vlerë 0.45 më të lartë mësimdhënësit e shkollave të Gjilanit se sa mësimdhënësit e shkollave të Preshevës.
- Ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional, për një vlerë më të lartë prej 0.14 e kanë vlerësuar mësimdhënësit e shkollave të Preshevës se sa mësimdhënësit e shkollave të Gjilanit.

Analiza e konstatimit të rëndësisë statistikore të dallimeve të qëndrimeve të mësimdhënësve të dy vendeve në gjashtë variablat e përcaktur tregon se kemi vlerësime respektivisht qëndrime të njejta, pra në përgjithësi mësimdhënësit e dy vendeve ndërveprimin e dy formave të edukimit e shohin në masë të madhe si të efektshëm në përgatitjen e nxënësve dhe mësimdhënësve për tu përshtatur kërkesave të shoqërisë globale të edukimit.

Tabela 45: Vlerat e shtuara të mesatareve të qëndrimeve të mësimdhënësve për të gjitha variablat

Variablat	Vlerat e shtuara të mesatareve aritmetike
Bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve joformale në zhvillimin profesional të mësimdhënësve	1.54
Motivimi për të mësuarit akademik	0.44
Përkrahja në mësim për rritje akademike	0.19

Zhvillimi individual dhe social	0.29
Vlerat qytetare tek nxënësi	0.45
Ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal nëzhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional	0.14

Dallimet dhe krahasimi i qëndrimeve të prindërve të dy vendeve sipas variablave

Për të konstatuar ekzistencën apo jo të dallimeve të rëndësishme statistikore dhe krahasimin e qëndrimeve të prindërve të dy vendeve është bërë analiza e variancës në 6 variablat përkatës të dalë nga pyetësi i prindërve.

Variabli 1. Komunikimi i shkollës me prindër

Variablii parë ka të bëjë me “komunikimin e shkollës me prindër” përmban katër kategori si: shkolla është në kontakt të përhershëm me mua si prind; shkolla nxit dhe është e hapur për bashkëpunim me prindër; shkolla kërkon mendimin dhe përkrahjen e prindërve për aktivitetet jashtëmësimore; si prind jam i përfshirë në aktivitete të ndryshme në shkollë.

Analiza e të dhënave të këtij variabli është testuar nëpërmjet analizës së variancës ku është testuar rëndësia e dallimeve ndërmjet qëndrimeve të prindërve të Gjilanit dhe prindërve të Preshevës, çka është konstatuar se ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në mesataret e qëndrimeve të prindërve të dy vendeve me vlerë të sigma-s në përgjithësi $p=.003 < p=0.05$. Gjithashtu vërejmë edhe vlera të sigma-s më të mëdha se $\alpha=0.05$.

Nga analiza krahasuese e vlerave të mesatareve aritmetike, rezulton se prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit vlerësojnë komunikimin e shkollës me prindër me $MA=7.9167$, $DS=2.85454$ dhe $V=8.148$ me një vlerë mesatare 0.6859 më të lartë se prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës $MA=7.2308$, $DS=2.55422$ dhe $V=6.524$.

Tabela 46: Vlera e mesatareve aritmetike dhe devijimit standard në qëndrimet e prindërve dhe FA1

FA1	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Komunikimi i shkollës me prindër	7.9167	2.85454	8.148	7.2308	2.55422	6.524

Në përgjithësi mund të themi se prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit kanë vlerësuar më lart komunikimin e shkollës me prindër, çka len të kuptohet se shkollat e Gjilanit komunikojnë dhe janë të hapur për të bashkëpunuar me prindërit.

Variabli 2. Cilësia e arritjeve shkollore

Variablii dytë ka të bëjë me cilësinë e arritjeve shkollore dhe përbëhet nga tre kategori: njohuritë e arritura në shkollëmundësojnëqë fëmija im të paraqitet më mirë në jetën e sotme dhe të ardhme private dhe profesionale, fëmija im shfrytëzon njohuritë shkollore në situatë të përditshme jetësore dhe fëmija im është aftësuar që të lidhë njohuritë e arritura në lëndë të ndryshme. Në bazë të analizave të variancës janë konstatuar dallime të rëndësishme statistikore me vlera të $p=.001$, $p=0.003$ dhe $p=0.000 < \alpha=0.05$.

Analiza krahasuese e vlerave të mesatareve aritmetike dhe devijimit standard, tregon se prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës vlerësojnë ciësinë e arritjeve shkollore me $MA= 5.7231$, $DS=1.40876$ dhe $V=1.985$ me një vlerë mesatare 0.5287 më të lartë se prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit $MA=5.1944$, $DS= 1.77350$ dhe $V= 3.145$.

Tabela 47: Vlera e mesatares dhe devijimit standard për variablin dy të prindërve

FA2	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Cilësia e arritjeve shkollore	5.1944	1.77350	3.145	5.7231	1.40876	1.985

Në përgjithësi mund të themi se qëndrimet e prindërve të nxënësve të shkollave të Gjilanit dhe Preshevës kryesisht përputhen .

Variabli 3.Kujdesi ndaj nxënësve

Duke ikrahasuar të dhënat nga qëndrimet e prindërve të dy vendeve tek kategoritë e variablit të tretë që ka të bëjë me kujdesin ndaj nxënësve është konstatuar dallim i rëndësishëm statistikor me vlera të $p=0.000$, $p=0.004 < \alpha = 0.05$, $p= 0.021$.

Prindërit pajtohen se në shkollë respektohet besueshmëria e informacioneve të fëmijëve të tyre çka është e një rëndësie të veçantë.

Në përgjithësi mund të themi se dallimi më i theksuar në vlerësimet e prindërve të nxënësve të dy vendeve është shprehur në kategorinë e parë,gjersa në dy kategoritë tjera kemi dallime të vogla apo mund të themi se kemi qëndrime të përafërta në mes prindërve të nxënësve të dy vendeve.

Nga analiza krahasuese, rezulton se prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit vlerësojnë kujdesin ndaj nxënësve me $MA= 6.1111$, $DS=1.95862$ dhe $V=3.836$ me një vlerë mesatare 0.3111 më të lartë se prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës $MA=5.8000$, $DS= 1.82174$ dhe $V= 3.319$.

Tabela 48: Vlera e mesatare dhe devijimit standard për variablin e tretë për prindër

FA3	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Kujdesi ndaj nxënësve	6.1111	1.95862	3.836	5.8000	1.82174	3.319

Në përgjithësi mund të themi se prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit kanë një qëndrim më pozitiv se sa prindërit e nxënësve të Preshevës.

Variabli 4. Zhvillimi i shkathtësive jetësore

Në analizën e mëtejshme në variablin e katërt në të cilin përfshihen tre kategori: në shkollë nxënësit zhvillojnë mirë shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme jetësore; në këtë shkollë nxënësit mësojnë se si në mënyrë cilësore dhe të kulturuar të komunikojnë me njerëz dhe në këtë shkollë nxënësit mund të mësojnë se si të bashkëpunojnë me njerëz të tjerë, janë konstatuar dallime të rëndësishme statistikore ($p=0.002$, $p=0.000$ dhe $p=0.21$).

Në përgjithësi mund të themi se dallim më të theksuar në vlerësimet e prindërve të nxënësve të dy vendeve është shprehur në kategorinë e tretë, gjersa në dy kategoritë tjera kemi dallime të vogla në qëndrimet e prindërve të nxënësve të dy vendeve.

Nga analiza krahasuese, rezulton se prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit vlerësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore me $MA=6.5635$, $DS=1.96380$ dhe $V=3.857$ me një vlerë mesatare 0.698 më të ulët se vlera mesatare e qëndrimeve të prindërve të nxënësve të shkollave të Preshevës $MA=7.2615$, $DS=1.97070$ dhe $V=3.884$.

Tabela 49: Vlera e mesatare dhe devijimit standard për variablin katër të prindërve

	Gjilan	Preshevë
--	--------	----------

FA4	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Zhvillimi i shkathtësive jetësore	6.5635	1.96380	3.857	7.2615	1.97070	3.884

Në përgjithësi mund të themi se prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës vlerësojnë më lart zhvillimin e shkathtësive jetësore se sa prindërit e nxënësve të Gjilanit.

Variabli 5. Etika

Variablii pestë ka të bëjë me etikën e shkollës, i cili përbëhet prej tre kategorive: në shkollë kultivohet bashkëstudimi dhe konsiderata reciproke; të punësuarit në shkollë ndaj meje siprind sillen me konsideratë dhe shkolla të gjithë nxënësve u ofron mundësi të barabarta dhe nxit ndjenjën e drejtësisë. Në këtë variabël analiza e variancës ka treguar se ekziston dallim i rëndësishëm statistikor. Analiza e mesatareve aritmetike në të gjitha kategoritë e këtij variabli tregon se ekzistojnë dallime në mesataret aritmetike të qëndrimeve të prindërve të dy vendeve.

Në përfundim mund të themi se prindërit e nxënësve të Gjilanit kanë vlerësuar më lart se prindërit e nxënësve të Preshevës, por të dhënat flasin për dallime jo shumë të theksuara në mes qëndrimeve të tyre. Në përgjithësi mund të themi se dallim më të theksuar në vlerësimet e prindërve të nxënësve të dy vendeve është shprehur në kategorinë e tretë, gjersa në kategorinë e parë kemi pothuajse qëndrime të përafërta në mes prindërve të nxënësve të dy vendeve.

Nga analiza krahasuese rezulton se prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit vlerësojnë etikën e shkollës me $MA = 5.9960$, $DS = 1.92384$ dhe $V = 3.701$ me një vlerë mesatare 0.396 më të ulët se vlera mesatare e qëndrimeve të prindërve të nxënësve të shkollave të Preshevës $MA = 5.6000$, $DS = 1.68449$ dhe $V = 2.838$.

Tabela 50: Vlera e mesatare dhe devijimit standard për variablin e pestë për prindër

FA5	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Etika	5.9960	1.92384	3.701	5.6000	1.68449	2.838

Analiza e të dhënave flet se variablin etika, prindërit e nxënësve të Gjilani e kanë vlerësuar më lart, çka le të kuptohet se prindërit janë të kënaqur me punën e shkollës në lidhje me kultivimin e një fryme bashkëpunuese, konsiderate reciproke dhe të ofrimit të mundësive të barabarta për të gjithë, gjë që është e një rëndësie të veçantë për prindërit të ndiejnë veten të pranuar dhe të barabartë në shkollë.

Variabli 6. Dobitë e ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal

Në variablin e gjashtë që ka të bëjë me dobitë e ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal përfshihen dy kategori: njohuritë e marra me mënyra të tjera jashtëshkollore i ndihmojnë fëmijës tim që të pasurojë dhe përsosë njohuritë e tij dhe pjesëmarrja e fëmijës tim në aktivitete dhe projekte të ndryshme që organizohen në shkollë nëpërmjet institucioneve joformale janë një mundësi e mirë për zhvillimin individual dhe shoqëror të tij. Nga analiza e të dhënave nga ky variabël janë konstatuar dallime të rëndësishme statistikore në mes mesatareve aritmetike në qëndrimet e prindërve të nxënësve të dy vendeve, vlerat e sigma-s sillen nga $p=.000$, $p=.038$ $\alpha < 0.05$

Nga analiza krahasuese rezulton se prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit vlerësojnë komunikimin e shkollës me prindër me $MA= 2.9127$, $DS=1.27195$ dhe $V=1.618$ me një vlerë mesatare 0.4819 më të lartë se prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës $MA=2.4308$, $DS=.82858$ dhe $V=.687$.

Tabela 51: Vlera e mesatares dhe devijimit standard për variablin e gjashtë për prindër

FA6	Gjilan			Preshevë		
	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca	Mesatarja	Devijimi standard	Varianca
Komunikimi i shkollës me prindër	2.9127	1.272195	1.618	2.4308	.82858	.687

Në përgjithësi mund të themi se edhe përkundër dallimeve në qëndrimet e prindërve të nxënësve të dy vendeve kemi një qëndrim pozitiv dhe vetëdijësues të dyanshëm në lidhje me përfitimet që sjell ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal.

Përmbledhja e të dhënave nga vlerësimet e prindërve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar të edukimit në rrafshin formal dhe joformal

Të dhënat e përfituara nga krahasimi i vlerësimeve të prindërve të nxënësve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar në rrafshin formal dhe joformal në gjashtë variablat përkatës tregojnë se prindërit e dy vendeve kanë qëndrime pozitive përse i përket trajtimit komplementar të dy formave të edukimit. Megjithatë, në të gjitha variablat e matura ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore, mirëpo këto dallime nuk janë shumë të theksuara. Mund të themi se dallim më të theksuar në qëndrimet e prindërve të nxënësve vërehet tek variablii katërt me vlerë 0.698 dhe variablii parë 0.6859 ndërsa më pak i theksuar tek variablii tretë 0.311.

Nëse shikojmë dhe analizojmë linjën e vlerave të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të prindërve të nxënësve të dy vendeve për të gjitha variablat vërejmë se prindërit e nxënësve të Gjilanit respektivisht vlerësojnë më lart se e prindërit e nxënësve të Preshevës, çka flet se megjithatë ekziston mendimi pozitiv dhe vetëdijësues i prindërve se ndërveprimi i dy

formave të edukimit ka një efekt të konsiderueshëm në përgatitjen e nxënësve me vlera qytetare dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

- Prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit vlerësojnë komunikimin e shkollës me prindër me vlerë mesatare 0.68 më të lartë se prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës.
- Cilësinë e arritjeve shkollore, prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës e vlerësojnë me vlerë mesatare 0.52 më të lartë se prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit.
- Kujdesin ndaj nxënësve, prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit e vlerësojnë më lartë me vlerë 0.31 se prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës. Çka vlen të konstatohet se dallimet në qëndrimet e prindërve të nxënësve të dy vendeve në këtë variabël janë më pakë të theksuara se në variablate tjerë.
- Zhvillimin e shkathtësive jetësore, prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës e vlerësojnë më lart se sa prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit me vlerë 0.69. Në këtë variabël ekziston dallim më i theksuar në krahasim me variablat e tjerë.
- Etikën e shkollës e kanë vlerësuar me vlerë 0.39 më të lartë prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit se sa prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës.
- Dobitë e ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal, për një vlerë më të lartë prej 0.48 e kanë vlerësuar prindërit e nxënësve të shkollave të Gjilanit se prindërit e nxënësve të shkollave të Preshevës.

Analiza e konstatimit të rëndësisë statistikore të dallimeve të qëndrimeve të prindërve të nxënësve të dy vendeve në gjashtë variablat e përcaktur tregon se prindërit e nxënësve të Gjilanit prej gjashtë variablave, katër prej tyre kanë vlerësuar më lart se prindërit e nxënësve të Preshevës. Në përgjithësi vlen të theksohet se prindërit e nxënësve të dy vendeve ndërveprimin e dy formave të edukimit e shohin si të efektshëm në përgatitjen e nxënësve dhe të një bashkëstudimi dhe krijimi të një besimi ndaj institucioneve të rrafshin formal ashtu edhe në atë joformal.

Tabela 52: Vlerat e shtuara të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të prindërve për të gjitha variablat

Variablat	Vlerat e shtuara të mesatareve aritmetike
Komunikimi i shkollës me prindër	0.68
Cilësia e arritjeve shkollore	0.52
Kujdesi ndaj nxënësve	0.31
Zhvillimi i shkathtësive jetësore	0.69
Etika	0.39
Dobitë e ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal	0.48

Marrëdhënia ndërmjet faktorëve në vlerësimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve

Pyetja kërkimore: A ekziston lidhje e rëndësishme statistikore ndërmjet variablave në vlerësimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve?

Hipoteza zero: Nuk ekziston lidhje e rëndësishme statistikore ndërmjet variablave në qëndrimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve.

Hipoteza alternative: Ekziston lidhje e rëndësishme statistikore ndërmjet variablave në qëndrimet e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve.

Marrëdhënia ndërmjet variablave në vlerësimet e nxënësve të Gjilanit

Për të konstatuar ekzistencën e marrëdhënieve të rëndësishme statistikore ndërmjet variablave në qëndrimet e nxënësve të Gjilanit është llogaritur koeficienti i korelacionit Pearson (r). Në bazë të analizës së rezultateve në të gjithë variablat është konstatuar lidhje e rëndësishme statistikore. Nga të dhënat e variablit të parë bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablit dy që ka të bëjë me edukimin komplementar dhe motivimin është konstatuar lidhje e rëndësishme statistikore e lartë me vlerë të $r = .617$, $p = .001$. Nga kjo mund të themi se nxënësit e Gjilanit kanë vlerësuar lart të dy variablat dhe se

ata mendojnë se bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve joformale ndikon në motivimin e nxënësve për të mësuar.

Njëkorelacion tjetër i rëndësishëm statistikor i lartë është konstatuar në mes variablit të dytë motivimit dhe variablit të tretë që ka të bëjë me përkrahjen në mësim për rritje akademike me vlerë të $r = .450$, $p = .000$. Nga kjo mund të themi se nxënësit kanë vlerësuar lart të dy variablat, çka nënkupton se nxënësit vlerësojnë lart përkrahjen e nxënësve në mësim nga ana e mësimdhënësve si dhe ndikimin e saj në motivimin e tyre për mësim.

Me analizën e mëtejshme e të dhënave tregon se në mes variablit të tretë që ka të bëjë me përkrahjen në mësim për rritje akademike dhe variablit të katërt zhvillimi individual dhe social, poashtu ekziston një marrëdhënie e rëndësishme statistikore e lartë me vlerë të $r = .382$, $p = .023$. Nxënësit vlerësojnë të dy variablat dhe pajtohen se përkrahja në mësim që u bëhet nxënësve ndihmon në zhvillimin individual dhe social të tyre.

Ndërmjet variablit të dytë edukimit komplementar dhe motivimit dhe variablit të katërt zhvillimit individual dhe social ekziston një lidhje e rëndësishme statistikore me vlerë negative $r = -.182$, $p = .000$. Koeficienti negativ i korelacionit tregon se nxënësit e Preshevës e shohin edukimin komplementar dhe motivimin si të rëndësishëm, mirëpo motivimi i tyre për të mësuar nëpërmjet dy formave të edukimit e shohin si pak të rëndësishme dhe ndikues në zhvillimin e tyre personal dhe social.

Lidhje e rëndësishme statistikore e ulët është konstatuar ndërmjet variablit të parë bashkëstudimit të shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablit të tretë përkrahja në mësim për rritjen akademike me vlerë të $r = .236$, $p = .000$. Pra nxënësit e Gjilanit mendojnë se bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve joformale mund të ndikojnë në përkrahjen e nxënësve për të mësuar.

Një lidhje tjetër e rëndësishme statistikore e ulët është vërejtur edhe në mes variablit të katërt zhvillimit individual dhe social dhe variablit të pestë vlerat qytetare tek nxënësit me vlerë të $r = .261$, $p = .000$. Nxënësit e Gjilanit mendojnë se zhvillimi individual dhe social i tyre mundëson në arritjen e vlerave qytetare të tyre.

Lidhje e rëndësishme statistikore negative është vërejtur ndërmjet variablit të dytë edukimi komplementar dhe motivimi dhe variablit të pestë vlerat qytetaretek nxënësi me vlerë të $r = -.398$, $p = .001$. Vlera negative e korelacionit tregon se edukimin komplementar dhe motivimin nxënësit e shohin sitë rëndësishëm, mirëpo përfitimin e vlerave qytetare nuk e shohin si rrjedhojë e motivimit të tyre për të mësuar.

Gjithashtu është vërejtur një lidhje e rëndësishme statistikore e ulët ndërmjet variablit të parë bashkëstudimit të shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablit të gjashtë ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional $r = -.235$, $p = .000$, çka nënkupton se nxënësit e Gjilanit bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale dhe ndërveprimin e edukimit formal e shohin në zhvillimin e shkathtësive të tyre dhe në formimin profesional.

Tabela 53: Vlerat e koeficientit të korelacionit ndërmjet variablave të nxënësve të Gjilanit

Variablat		FA2	FA3	FA4	FA5	FA6
FA1	Pearson Correlation	.617**	.236**	-.156*	0.73	-.235**
	Sig.(2-tailed)	.001	.000	.028	.363	.000
FA2	Pearson Correlation		.450**	-.035	-.398**	.139
	Sig.(2-tailed)		.000	.632	.001	.083
FA3	Pearson Correlation			.382**	-.182*	.014
	Sig.(2-tailed)			.023	.000	.854
FA4	Pearson Correlation				.261**	-.079
	Sig.(2-tailed)				.000	.353
FA5	Pearson Correlation					.117*
	Sig.(2-tailed)					.131
FA6	Pearson Correlation					
	Sig.(2-tailed)					

Marrëdhënia ndërmjet variablave në vlerësimet e nxënësve të Preshevës

Në bazë të analizës së të dhënave të koeficientit të korelacionit të Pearson në qëndrimet e nxënësve të Preshevës është konstatuar marrëdhënie e rëndësishme statistikore e lartë ndërmjet variablilit të parë bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablilit dy që ka të bëjë me edukimin komplementar dhe motivimin me vlerë të $r = .658$, $p = .000$. Nga kjo mund të themi se nxënësit e Preshevës kanë vlerësuar lart të dy variablat dhe se ata mendojnë se bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve joformale ndikon dukshëm në motivimin e nxënësve për të mësuar.

Një korelacion tjetër i rëndësishëm statistikor i lartë është konstatuar në mes variablilit të dytë motivimit dhe variablilit të tretë që ka të bëjë me përkrahjen në mësim për rritje akademike me vlerë të $r = .371$, $p = .000$. Nga kjo mund të themi se nxënësit kanë vlerësuar lart të dy variablat, çka nënkupton se nxënësit pajtohen se motivimi i tyre për të mësuar është i ndikuar nga përkrahja që u bëhet atyre në mësim për rritje akademike.

Ndërmjet variablilit të tretë përkrahja në mësim për rritje akademike dhe variablilit të katërt zhvillimit individual dhe social është konstatuar një lidhje e rëndësishme statistikore e lartë me $r = .372$, $p = .002$. Nga analiza e të dhënave të këtyre dy faktorëve tregon se nxënësit e Preshevës kanë vlerësuar lart të dy variablat dhe se pajtohen me mendimin se përkrahja në mësim ndikon dukshëm në zhvillimin individual dhe social të tyre.

Një korelacion i rëndësishëm statistikor i ulët është konstatuar ndërmjet variablilit të dytë motivimit dhe variablilit të pestë vlerat qytetare të nxënësit me $r = .158$, $P = .000$. Kjo tregon se nxënësit mendojnë se motivimi i tyre mund të ndikojë në arritjen e vlerave qytetare të tyre.

Në kuadër të analizës së të dhënave rezulton se ndërmjet variablilit të dytë motivimit dhe variablilit të katërt zhvillimit individual dhe social ekziston lidhje e rëndësishme statistikore e ulët $r = .173$, $p = .000$, çka mund të themi se nxënësit e Preshevës motivimin e shohin si mundësi të mirë në zhvillimin e tyre individual dhe social.

Gjithashtu është konstatuar lidhje e rëndësishme statistikore e me vlerë negative ndërmjet variablit të parë bashkëstudimit të shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablit të katërt zhvillimit individual dhe social me $r = .243$, $p = .023$ dhe me variablin e gjashtë ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional me $r = .236$, $p = .000$.

Nga kjo mund të përfundojmë se nxënësit e Preshevës bashkëstudimin e shkollës dhe institucioneve joformale e shohin si njëmundësi të mirë në zhvillimin e tyre individual e social dhe në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional.

Ndërmjet variablit të tretë përkrahja në mësim për rritjen akademike dhe variablit të pestë vlerat qytetare të nxënësve ekziston lidhje statistikore e rëndësishme me vlerë negative $r = -.550$, $p = .003$. Koeficienti negativ i korelacionit tregon se sa më shumë të kenë përkrahje në mësim aq më pak e rëndësishme dhe ndikuese është në përfitimin e vlerave qytetare tek nxënësit.

Tabela 54: Vlerat e koeficientit të korelacionit ndërmjet faktorëve të nxënësve të Preshevës

Variablat		FA2	FA3	FA4	FA5	FA6
FA1	Pearson Correlation	.658**	-.020	.243**	.070	.236**
	Sig.(2-tailed)	.000	.628	.023	.208	.000
FA2	Pearson Correlation		.371**	.173*	.158*	-.073
	Sig.(2-tailed)		.000	.000	.000	.351
FA3	Pearson Correlation			.372**	-.550**	.041
	Sig.(2-tailed)			.002	.003	.462
FA4	Pearson Correlation				.171*	.198*
	Sig.(2-tailed)				.011	.018
FA5	Pearson Correlation					.159*
	Sig.(2-tailed)					.090

FA6	Pearson Correlation					
	Sig.(2-tailed)					

Përmbledhja e të dhënave të dala nga marrëdhënia në mes variablave në vlerësimet e nxënësve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar të edukimit në rrafshin formal dhe joformal

Krahasimi i të dhënave të dala nga marrëdhënia në mes variablave mbi trajtimin komplementar në rrafshin formal dhe joformal, të vlerësimeve të nxënësve të dy vendeve tregojnë se në të gjitha variablat e matura ekzistojnë lidhje të rëndësishme statistikore. Duke analizuar dhe krahasuar linjën e vlerave të koeficientit të korelacionit të Parson të qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve për të gjitha variablat, themi se :

- Në bazë të koeficientit të korelacionit Pearson nga vlerësimet e nxënësve të Gjilanit është vërejtur një lidhje e rëndësishme statistikore më e lartë ndërmjet variablit të parë bashkëstudimit të shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablit të dytë edukimit komplementar dhe motivimit me $r = .617$ dhe $p = .001$. Gjithashtu edhe në qëndrimet e nxënësve të Preshevës është vërejtur korelacion i lartë ndërmjet variablit të parë bashkëstudimit të shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablit të dytë edukimit komplementar dhe motivimit me vlerë të $r = .658$ dhe $p = .000$. Pra, mund të themi se edhe nxënësit e Gjilanit edhe nxënësit e Preshevës janë të mendimit se bashkëstudimii shkollës dhe institucioneve jo formale ndikojnë dukshëm në motivimin e tyre për të mësuar.
- Lidhje e rëndësishme statistikore e lartë në mes variablit të dytë motivimit dhe variablit të tretë që ka të bëjë me përkrahjen në mësim për rritje akademike është vërejtur në vlerësimet e nxënësve të dy vendeve. Kështu vlera e koeficientit të korelacionit Pearson të vlerësimeve të nxënësve të Gjilanit është $r = .450$ dhe $p =$

.000 dhe vlera e koeficientit të korelacionit Pearson të vlerësimeve të nxënësve të Preshevës është $r = .371$, $p = .000$.

- Gjithashtu një lidhje e rëndësishme statistikore e lartë është vërejtur edhe ndërmjet variablit të tretë përkrahja në mësim për rritje akademike dhe variablit të katërt zhvillimit individual dhe social në vlerësimet e nxënësve të dy vendeve. Kështu vlera e koeficientit të korelacionit Pearson të vlerësimeve të nxënësve të Gjilanit $r = .382$, $p = .023$ dhe vlera e koeficientit të korelacionit të vlerësimeve të nxënësve të Preshevës $r = .372$, $p = .002$ janë të përafërsisht të njëjta dhe mund të themi se nxënësit e të dy vendeve kanë vlerësuar lart ndikimin e këtyre dy variablave.
- Në bazë të koeficientit të korelacionit Pearson është konstatuar lidhje e rëndësishme statistikore me vlerë negative në vlerësimet e nxënësve të Gjilanit në mes variablit të dytë edukimi komplementar dhe motivimi dhe variablit të pestë vlerat qytetare tek nxënësi me vlerë të $r = -.398$, $p = .001$, gjersa tek vlerësimet e nxënësve të Preshevës është konstatuar një lidhje e ulët në mes këtyre dy faktorëve me $r = .158$, $p = .000$.
- Lidhje e rëndësishme statistikore negative e lartë nga vlerësimet e nxënësve të Preshevës është vërtetuar ndërmjet variablit të tretë përkrahja në mësim për rritjen akademike dhe variablit të pestë vlerat qytetare të nxënësve me $r = -.550$, $p = .003$, kurse tek vlerësimet e nxënësve të Gjilanit kemi një lidhje të rëndësishme statistikore negative më të ulët $r = -.182$, $p = .000$. Vlerat negative të korelacionit tregojnë se nxënësit e dy vendeve përfitimin e vlerave qytetare nuk e shohin si rrjedhojë e përkrahjes në mësim.
- Lidhje e rëndësishme e ulët është konstatuar në mes variablit të parë bashkëstudimit të shkollës me institucionet joformale dhe variablit të tretë përkrahja në mësim për rritjen akademike me $r = .236$, $p = .000$ të qëndrimeve të nxënësve të Gjilanit, kurse lidhje e rëndësishme statistikore në mes këtyre dy variablave në qëndrimet e nxënësve të Preshevës nuk është konstatuar ku kemi vlerë të $r = -.020$, $p = .628$.
- Gjithashtu lidhje e rëndësishme e ulët në vlerësimet e nxënësve të Preshevës është konstatuar në mes variablit të dytë motivimit dhe variablit të pestë vlerat qytetare të nxënësve me $r = .158$, $p = .000$, gjersa tek vlerësimet e nxënësve të Gjilanit ndërmjet këtyre dy variablave kemi vlerë negative të lartë $r = -.398$, $p = .001$.

- Analiza e mëtejshme e korelacionit tregon se në vlerësimet e nxënësve të Gjilanit ndërmjet variablilit të parë bashkëstudimii shkollës me institucionet joformale dhe variablilit të katërt zhvillimit individual dhe social ekziston lidhje e rëndësishme statistikore e ulët me vlerë negative $r = -.156$, $p = .028$, kurse tek vlerësimet e nxënësve të Preshevës për këta dy variabla kemi njëkorelacion të rëndësishëm të ulët por me vlerë pozitive $r = .243$, $p = .023$.

Në përgjithësi mund të themi se marrëdhëniet ndërmjet variablave nga vlerësimet e nxënësve të dy vendeve tregojnë për korelacion statistikor të rëndësishëm.

Lidhja në mes variablave në vlerësimet e mësimdhënësve të dy vendeve

Marrëdhënia ndërmjet variablave në vlerësimet e mësimdhënësve të Gjilanit

Në bazë të koeficientit tëkorelacionit Pearson në qëndrimet e mësimdhënësve të Gjilanit në kuadër të gjashtëvariablave përkatës është vërtetuar një korelacion i rëndësishëm statistikor i lartë ndërmjet variablave. Kështu ndërmjet variablilit të parë bashkëstudimit të shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablilit të dytë motivimit është vërtetuar një lidhje e lartë me vlera të $r = .717$, $p = .004$, çka tregon se ma i madh të jetë bashkstudimii shkollës me institucionet joformale, aq më shumë nxënësit janë të motivuar për mësim.

Një lidhje statistikore e rëndësishme më e lartë është vërtetuar ndërmjet variablilit të parë bashkëstudimit të shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablilit të gjashtë ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional $r = .854$, $p = .005$. Këto të dhëna tregojnë se mësimdhënësit e Gjilanit e vlerësojnë lart bashkëpunimin e këtyre dy llojeve të institucioneve të edukimit dhe se një bashkëpunim i këtillë ndikon dukshëm në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional të tyre.

Analiza e mëtejshme tregon se kemi një lidhje të lartë statistikore edhe në mes variablilit të parë bashkëstudimit të shkollës dhe institucioneve joformale dhe variablilit të katër zhvillimit personal dhe social me vlerë të $r = .506$, $p = .000$, çka flet se mësimdhënësit bashkëpunimin e shkollës me institucionet joformale e shohin si mënyrë shumë e mirë e me interes të veçantë për zhvillimin personal dhe social të tyre.

Mbështetur në koeficientin e korelacionit Pearson edhe ndërmjet variablit të dytë motivimit dhe variablit të tretë përkrahjes në mësim është konstatuar lidhje e rëndësishme statistikore e lartë me vlerët $r = .456$, $p = .000$. Mësimdhënësit e Gjilanit pajtohen me mendimin se motivimi i nxënësve varet dukshëm nga përkrahja që u bëhet atyre për të mësuar.

Njëkorelacion statistikor i rëndësishëm i lartë është konstatuar edhe ndërmjet variablit të dytë motivimit dhe variablit të gjashtë ndërveprimit i edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin profesional me vlerë të $r = .667$, $p = .000$, çka mund të themi se mësimdhënësit e shohin motivimin si burim që rrjedh nga ndërveprimi i dy formave të edukimit në zhvillimin e shkathtësive dhe formimin e tyre profesional.

Likelihood Ratio	.482	4	.975
Linear-by-Linear Association	.028	1	.866
N of Valid Cases	317		
a.2 cells (20.0 %) have expected count less than 5.The minimum expected count is 2.35.			

Symmetric Measures

	Value	Asymp. Std.Error ^a	Approx.T ^b	Approx.Sig
Interval by interval Pearson's R	-.009	.056	-.168	.866 ^c
Ordinal by Ordinal Spearman Correlation	-.010	.056	-.173	.862 ^c
N of valid Cases	317			
a. Not assuming the null hypothesis b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis c. based on normal approximation				

Marrëdhënia ndërmjet gjinisë së prindërve dhe cilësisë së arritjeve shkollore

Në kuadër të marrëdhënies ndërmjet variablit gjinia e prindërve dhe variablit të varur cilësia e arritjeve shkollore është konstatuar se nuk ekziston lidhje e rëndësishme statistikore respektivisht nuk ekzistojnë ndryshime ndërmjet gjinisë së prindërve dhe cilësisë së arritjeve shkollore që janë statistikisht domethënëse me vlerë të $\chi^2=2.850^a$, $df = 4$, $Sig. = .583 > p = 0.05$, edhe pse prindërit e gjinisë mashkullore me 31.54 % priren në vlerësimet e tyre plotësisht pajtohem dhe pajtohem se sa mësimdhënësit e gjinisë femrore me 27.75 %. Edhe në vlerësimet nuk pajtohem dhe aspak nuk pajtohem prindërit e gjinisë mashkullore priren në vlerësimet e tyre me 15.45 % ndaj prindërve të gjinisë femrore me 13.55 %. Megjithëse ka diferencë të vogël në përqindje në vlerësimet e prindërve të dy gjinive, kjo diferencë nuk është statistikisht domethënëse. Nga këto vlera mund të themi se variabli gjinia dhe cilësia e arritjeve shkollore nuk varen nga njëri tjetri respektivisht nuk ekziston marrëdhënie e rëndësishme statistikore.

Tabela 72: Vlerat e Chi-Square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA2

FA2	Cilësia e arritjeve shkollore		
	Value	Df	Asymp.sig (2-sided)
Pearson Chi-Square	2.850 ^a	4	.583
Likelihood Ratio	3.266	4	.514
Linear-by-Linear Association	.287	1	.592
N of Valid Cases	317		
a. 4 cells (40.0 %) have expected count less than 5. The minimum expected count is .47			

Symmetric Measures

	Value	Asymp. Std.Error ^a	Approx.T ^b	Approx.Sig .
Interval by interval Pearson's R	.030	.056	.535	.593 ^c
Ordinal by Ordinal Spearman Correlation	.037	.056	.662	.509 ^c
N of valid Cases	317			
a. Not assuming the null hypothesis b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis c. based on normal approximation				

Marrëdhënia ndërmjet gjinisë së prindërve dhe kujdesit të nxënësve

Lidhja ndërmjet gjinisë së prindërve dhe kujdesit të nxënësve nuk është statistikisht domethënëse me vlerë të $\chi^2 = .839^a$, $df = 4$, $Sig. = .933 > p = 0.05$, edhe pse prindërit e gjinisë mashkullore me 40.68 % priren në vlerësimet e tyre se sa prindërit e gjinisë femrore me 35.32 % (plotësisht pajtohem dhe pajtohem) dhe nuk pajtohem dhe aspak nuk pajtohem me (3.14 % dhe 2.51 %). Pra kemi një përqindje minimale në vlerësimet e dy gjinive. Gjithashtu vërehet se një përqindje e barabartë e prindërve të dy gjinive janë të pavendosur 29 %. Diferenca ndërmjet gjinisë mashkullore dhe gjinisë femërore është 9.39 %, kjo diferencë nuk është statistikisht domethënëse. Nga këto vlera mund të themi se variabli kujdesi ndaj nxënësve nuk ndikohet nga variabli i pavarur gjinia e prindërve. Pra mund të themi se nuk ekziston marrëdhënie e rëndësishme statistikore ndërmjet këtyre dy variablave apo themi se variabla nuk varen nga njëri tjetri.

Tabela 73: Vlerat e Chi-Square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA3

FA3	Kujdesi ndaj nxënësve		
	Value	Df	Asymp.sig (2-sided)

Pearson Chi-Square	.839 ^a	4	.933
Likelihood Ratio	.839	4	.933
Linear-by-Linear Association	.029	1	.865
N of Valid Cases	317		
a. 2 cells (20.0 %) have expected count less than 5. The minimum expected count is .94			

Symmetric Measures

	Value	Asymp. Std. Error ^a	Approx. T ^b	Approx. Sig.
Interval by interval Pearson's R	.010	.056	.169	.866 ^c
Ordinal by Ordinal Spearman Correlation	.008	.056	.143	.887 ^c
N of valid Cases	317			
a. Not assuming the null hypothesis b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis c. based on normal approximation				

Marrëdhënia ndërmjet gjinisë së prindërve dhe zhvillimit të shkathtësive jetësore

Testi joparametrik Chi-square në eksplorimin e marrëdhënies ndërmjet gjinisë dhe zhvillimit të shkathtësive jetësore zbuloi se nuk kemi lidhje statistikore domethënëse respektivisht ndryshime ndërmjet gjinisë së prindërve dhe zhvillimit të shkathtësive jetësore, nuk janë statistikisht domethënëse edhe përkundër diferencës në përqindje të

vlerësimeve të prindërve të dy gjinive. Prindërit e gjinisë mashkullore prijnë në vlerësimet e tyre me një përqindje të vogël 38.80 % se sa prindërit e gjinisë femrore me 34.37 % (plotësisht pajtohem dhe pajtohem) gjersa 13.25 % e gjinisë mashkullore dhe 11.98 % të gjinisë femrore janë të pa vendosur. Vlerat e $\chi^2 = 4.677^a$, $df = 4$ dhe $Sig. = .322$ tregojnë se variabli zhvillimi i shkathtësive jetësore nuk është i ndikuar nga variabli gjinia e prindërve .

Tabela 74: Vlerat e Chi-Square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA4

FA4	Zhvillimi i shkathtësive jetësore		
	Value	Df	Asymp.sig (2-sided)
Pearson Chi-Square	4.677 ^a	4	.322
Likelihood Ratio	5.452	4	.244
Linear-by-Linear Association	2.432	1	.119
N of Valid Cases	317		
a.2 cells (20.0 %) have expected count less than 5.The minimum expected count is .94			

Symmetric Measures

	Value	Asymp. Std.Error ^a	Approx.T ^b	Approx.Sig
Interval by interval Pearson's R	-.088	.055	-1.563	.119 ^c
Ordinal by Ordinal Spearman Correlation	-.084	.056	-1.496	.136 ^c
N of valid Cases	317			

- a. Not assuming the null hypothesis
- b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis
- c. based on normal approximation

Marrëdhënia ndërmjet gjinisë së prindërve dhe etikës

Analiza e mëtejshme tregon se ndërmjet variablit gjinisë së prindërve dhe etikës së shkollës nuk ekziston lidhje e rëndësishme statistikore $\chi^2 = 5.875^a$, $df = 4$ dhe $sig. = .209$. Këto vlera tregojnë se nuk kemi të bëjmë me diferenca statistikore të rëndësishme përse i përket qëndrimeve të prindërve të këyre dy gjinive dhe se variablat vendi dhe etika e shkollës nuk varen nga njëri tjeri.

Tabela 75: Vlerat e Chi- Square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA5

FA5	Etika e shkollës		
	Value	Df	Asymp.sig (2-sided)
Pearson Chi-Square	5.875 ^a	4	.209
Likelihood Ratio	6.223	4	.183
Linear-by-Linear Association	2.395	1	.122
N of Valid Cases	317		
a. 2 cells (20.0 %) have expected count less than 5. The minimum expected count is .94			

Symmetric Measures

	Value	Asymp. Std. Error ^a	Approx. T ^b	Approx. Sig
				.

Interval by interval Pearson's R	-.087	.056	-1.551	.122 ^c
Ordinal by Ordinal Spearman Correlation	-.073	.056	-1.305	.193 ^c
N of valid Cases	317			
a. Not assuming the null hypothesis b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis c. based on normal approximation				

Marrëdhënia ndërmjet gjinisë së prindërve dhe ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal

Gjithashtu ndërmjet variablit gjinisë së prindërve dhe ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal nuk ekziston lidhje e rëndësishme statistikore me vlera të $\chi^2 = 7.122^a$, $df = 4$ dhe $sig. = .130$. Këto vlera tregojnë se nuk kemi të bëjmë me diferenca statistikore të rëndësishme përse i përket qëndrimeve të prindërve të këtyre dy gjinive dhe se variabli ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal nuk është i ndikuar nga variabli gjinia .

Tabela 76: Vlerat e Chi-square për lidhjen gjinore të prindërve dhe FA6

FA6	Ndërveprimi I edukimit formal dhe joformal		
	Value	Df	Asymp.sig (2-sided)
Pearson Chi-Square	7.122 ^a	4	.130
Likelihood Ratio	8.656	4	.070
Linear-by-Linear Association	.551	1	.458
N of Valid Cases	317		

a.5 cells (50.0 %) have expected count less than 5.The minimum expected count is 1.41

Symmetric Measures

	Value	Asymp. Std.Error ^a	Approx.T ^b	Approx.Sig .
Interval by interval Pearson's R	-.042	.056	-.742	.459 ^c
Ordinal by Ordinal Spearman Correlation	-.074	.056	-1.312	.191 ^c
N of valid Cases	317			
a. Not assuming the null hypothesis b. Using the asymptotic standard error assuming the null hypothesis c. based on normal approximation				

Përmbledhja e të dhënave nga marrëdhënia ndërmjet gjinisë së prindërve dhe variablave të varura.

Testi Chi-Square për marrëdhënien ndërmjet gjinisë së prindërve dhe variablave të varur me vlera të koeficientit të sigurisë Asymp.Sig(2-sides) për të gjithë variablat Sig.=.975; .583 ; .933; .322; .209; .130 > p= 0.05. Këto vlera flasin se nuk ekziston lidhje e rëndësishme statistikore ndërmjet variablit të pavarur gjinia dhe variablave të varur në qëndrimet e prindërve të dy gjinive, pra variablat e varur nuk janë të ndikuar nga variabli gjinia.

Rezultatet në lidhje me dallimet gjinore dhe eksperiencës në punë të mësimdhënësve dhe prindërve të dy vendeve në raport me variablat e varura

Pyetja kërkimore: A ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në rezultatet e variablave të varur të dalë nga qëndrimet e mësimdhënësve, prindërve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në raport me variablin e pavarur gjinia dhe eksperiencia në punë?

Hipoteza zero: Nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në qëndrimet e mësimdhënësve, prindërve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në raport me gjininë dhe eksperiencën në punë.

Hipoteza alternative: Ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në qëndrimet e mësimdhënësve, prindërve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në raport me gjininë dhe eksperiencën në punë.

Për të konstatuar ekzistencën e dallimeve gjinore në rezultatet e gjashtë variablave të dalë nga vlerësimet e mësimdhënësve është zbatuar analiza e variancës, ku është konstatuar se nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor gjinor. Në variablin e parë që kishte të bënte me bashkëstudimin institucional është konstatuar se nuk kemi dallime të rëndësishme statistikore në varësi të gjinisë së mësimdhënësve me vlera të $r = .089$, $\text{sig.} = .390 > p = 0.05$ dhe vlera të mesatareve aritmetike $MA_{\text{femra}} = 1.7292$, $DS = .76060$ dhe $MA_{\text{mashkull}} = 1.7334$, $DS = .72176$. Këto të dhëna flasin se mësimdhënësit e dy gjinive kanë mendime të njëjta në lidhje me bashkëstudimin institucional.

Për të eksploruar dallimin në mes dy gjinive të mësimdhënësve në variablin e dytë që ka të bëjë me motivimin, gjithashtu është bërë analiza e variancës. Vlerat e $r = -.102$, $\text{sig.} = .324$ dhe vlerat e mesatareve aritmetike $MA_{\text{femra}} = 1.2604$, $DS = .46441$ dhe $MA_{\text{mashkull}} = 1.2813$, $DS = .47469$. Të dhënat flasin se nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor gjinor në rezultatet e variablit në varësi të gjinisë dhe se mësimdhënësit e dy gjinive vlerësojnë lart motivimin e nxënësve për të mësuar, çka mendojnë se në masë të madhe, që të nxitet motivimi tek nxënësit për të mësuar duhet që nxënësit të nxiten që të zhvillojnë dhe përpunojnë idetë e tyre, nxiten nxënësit që të arrijnë njohuri dhe shkathtësi plotësuese në mënyrë të pavarur dhe të lavdërojnë dhe shpërblejnë arritjet e njohurive të tyre.

Në kuadër të variablit të tretë që ka të bëjë me përkrahjen në mësim për rritje akademike është konstatuar se nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor gjinor me vlerë të $r = -.116$, $\text{sig.} = .260$ dhe vlera të mesatareve aritmetike dhe të devijimit standard $MA_{\text{femër}} = 1.6667$, $DS = .51640$ dhe $MA_{\text{mashkull}} = 1.6563$ dhe $DS = .47745$. Këto të dhëna flasin se në mes rezultateve të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të mësimdhënësve nuk kemi dallime të vlefshme dhe se mësimdhënësit e dy gjinive vlerësojnë lart përkrahjen në mësim për arritje akademike.

Mësimdhënësit e dy gjinive në masë të madhe vlerësojnë punën e tyre sejashtë procesit mësimor i ndihmojnë nxënësit që të përparojnë dhe i përkrahin dhe i ndihmojnë nxënësve që të organizojnë aktivitete të ndryshme kulturore, artistike, sportive dhe aktivitete të ngjajshme.

Analiza e mëtejshme ka të bëjë me variablin e katërt zhvillimi individual dhe social, ku është konstatuar gjithashtu se nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor gjinor nga vlera e $MA_{\text{femër}} = 1.7292$, $DS = .49160$ dhe $MA_{\text{mashkull}} = 1.7396$, $DS = .60253$ dhe me vlerë të $r = .003$ dhe $\text{sig.} = .978$. Në bazë të këtyre të dhënave vijmë në përfundim se mësimdhënësit e dy gjinive kanë vlerësuar lart zhvillimin individual dhe social, ku në masë të madhe vlerësojnë punën e tyre që bëjnë sepse ata nxisin nxënësit që të zbulojnë dhe zhvillojnë talentet e tyre, duke marrë pjesë në aktivitete jashtë mësimore që u ofrohen dhe në këtë mënyrë nxënësit arrijnë të zhvillohen individualisht edhe të shoqërizohen.

Në variablin e pestë në lidhje me vlerat qytetare tek nxënësit nuk është konstatuar dallim i rëndësishëm gjinor. Vlerat për $MA_{\text{femër}} = 2.0000$, $DS = .50262$ dhe $MA_{\text{mashkull}} = 2.0208$, $DS = .50219$ dhe vlerat e koeficientit të Pearson $r = .074$, $\text{sig.} = .473$ tregojnë se mësimdhënësit e dy gjinive kanë vlerësuar lart variablin vlerat qytetare tek nxënësit. Mësimdhënësit në masë të madhe shprehen se për të arritur vlerat qytetare tek nxënësit si parakusht i rëndësishëm është nxitja e nxënësve të respektojnë mendimin e të tjerëve dhe nxitja e solidaritetit dhe kujdesit për njëri tjetrin.

Gjithashtu edhe në variablin e gjashtë që ka të bëjë me dobitë e ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal në zhvillimin e shkathtësive dhe formimit profesional nuk është

konstatuar dallim i rëndësishëm gjinor në rezultatet e këtij variabli me $MA_{femër} = 1.2604$, $DS = .46441$ dhe $MA_{mashkull} = 1.2813$, $DS = .47469$ dhe me $r = .076$, $sig. = .464$.

Tabela 77: Vlerat e mesatareve aritmetike ,devijimeve standarde dhe koeficientëve të korelacionit në lidhje me gjininë e mësimdhënësve dhe variablate

Variablat	Femër-33		Mashkull-63				
	MA	DS	MA	DS	R	df	Sig.
FA1 Bashkëstudimi institucional	1.7292	.76060	1.7334	.72176	.089	4	.390
FA2 Motivimi	1.2604	.46441	1.2813	.47469	-.102	2	.324
FA3 Përkrahja në mësim	1.6563	.47745	1.6667	.51640	-.116	2	.260
FA4 Zhvillimi individual dhe social	1.7396	.60253	1.7292	.49160	.003	2	.978
FA5 Vlerat qytetare	2.0000	.50262	2.0208	.50219	.074	2	.473
FA6 Dobitë e ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal	1.2604	.46441	1.2813	.47469	.076	2	.467

Rezultatet në lidhje me dallimet ndërmjet eksperiencës në punë të mësimdhënësve në raport me variablat e varura

Për të konstatuar dallimet në rezultatet e variablate në varësi nga variabli eksperiencia në punë jemi nisur nga vlerat e koeficientit të korelacionit Pearson. Në bazë të koeficientit Pearson është konstatuar se nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor në të gjithë variablat respektivisht në variablat e varura. Kështu për variablin e parë që ka të bëjë me bashkëstudimin e shkollës me institucionet joformale vlerat e $sig. = .184$ nuk është domethënëse për sa i përket diferencës ndërmjet grupit të mësimdhënësve sipas

eksperiencës në punë, çka flet se dallimet në mes eksperiencës në punë dhe bashkëstudimit të shkollës dhe institucioneve joformale statistikisht janë të pa pranueshme dhe se variabli eksperiencia në punë dhe bashkëstudimi institucional nuk varen nga njëri tjetri.

Në variablin e dytë në lidhje me motivimin gjithashtu nuk është vërejtur dallim i rëndësishëm statistikor, sig. = .373 ndërmjet grupeve me eksperiencë pune dhe se variabli motivimi nuk ndikohet nga eksperiencia në punë.

Gjithashtu edhe në variablin e tretë në lidhje me përkrahjen në mësim, në variablin e katërt zhvillimi individual dhe social, në variablin e pestë në lidhje me vlerat qytetare dhe në variablin e gjashtë që ka të bëjë me ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal vlerat e sig.sillen nga sig.= .128, sig. =.526, sig. = .120 dhe sig. = .09, çka flasin se nuk ekziston dallim i rëndësishëm ndërmjet variablit eksperiencia në punë dhe variablave përkatës, respektivisht variablat nuk varen njëri nga tjetri.

Rezultatet në lidhje me dallimet gjinore të prindërve të dy vendeve në raport me variablat e varura

Për të konstatuar ekzistencën e dallimeve gjinore në rezultatet e gjashtë variablave të dalë nga vlerësimet e prindërve është zbatuar analiza e variancës, ku është konstatuar se nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor gjinor. Në variablin e parë që kishte të bënte me komunikimin e shkollës është konstatuar se nuk kemi dallime të rëndësishme statistikore në varësi të gjinisë së prindërve me vlera të $r = -.009$, sig.= .886 $> p = 0.05$ dhe vlera të mesatareve aritmetike $MA_{femra} = 1.7956$, $DS = .80676$ dhe $MA_{meshkull} = 1.7571$, $DS = .773841$. Këto të dhëna flasin se prindërit e dy gjinive kanë mendime të njëjta në lidhje me bashkëpunimin e shkollës.

Në variablin e dytë në lidhje me cilësinë e arritjeve shkollore gjithashtu nuk është konstatuar dallim i rëndësishëm gjinor në rezultatet e mesatareve të qëndrimeve të prindërve. Vlera e $MA_{femër} = 2.1136$, $DS = .82660$ dhe $MA_{meshkull} = 2.21230$, $DS = .77583$ dhe $r = .030$, sig. = .593. Këto vlera flasin se prindërit e dy gjinive vlerësojnë njëloj cilësinë e arritjeve shkollore, pra nuk kemi dallime të vlefshme në qëndrimet e tyre.

Analiza e mëtejshme tregon se edhe në variablin e tretë kujdesi ndaj nxënësve nuk është vërejtur dallim i rëndësishëm statistikor gjinor në rezultatet e qëndrimeve të prindërve. Vlerat e $MA_{femër} = 1.8391$, $DS = .65795$ dhe $MA_{mashkull} = 1.8013$, $DS = .82000$ dhe $r = .010$, $sig. = .866$, çka flitet se prindërit e dy gjinive në masë të madhe vlerësojnë kujdesin ndaj nxënësit që u bëhet në shkolla.

Në kuadër të variablit të katërt zhvillimi i shkathtësive jetësore rezultatet e dala nga ky variabël konfirmojnë se nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor gjinor. Vlera e $MA_{femër} = 1.4385$, $DS = .70722$ dhe $MA_{mashkull} = 1.3754$, $DS = .63228$ dhe vlera e $r = -.088$, $sig. = .119$ tregojnë se prindërit e dy gjinive kanë qëndrime të njëjta në lidhje me zhvillimin e shkathtësive jetësore që formojnë fëmijët e tyre në shkolla.

Në variablin e pestë që ka të bëjë me etikën e shkollës nuk është konstatuar dallim i rëndësishëm gjinor në qëndrimet e prindërve të dy vendeve. Vlerat e $MA_{femër} = 2.1388$, $DS = .79534$ dhe $MA_{mashkull} = 2.1420$, $DS = .76434$ dhe $r = -.087$, $sig. = .122$ tregojnë se prindërit e dy gjinive kanë vlerësuar njëllëj këtë variabël.

Gjithashtu edhe në variablin e gjashtë në lidhje me ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal nuk është konstatuar dallim i rëndësishëm gjinor, sepse vlerat e $MA_{femër} = 2.1483$, $DS = .83065$ dhe $MA_{mashkull} = 2.2713$, $DS = .77269$ dhe $r = -.042$, $sig. = .459$ tregojnë se dy gjinitë e prindërve kanë qëndrime të njëjta në lidhje me ndërveprimin e edukimit formal dhe joformal.

Tabela 78: Vlerat e mesatareve, devijimeve standarde dhe korelacionit në lidhje me gjininë e prindërve dhe variablave

Variablat	Femër		Mashkull				
	MA	DS	MA	DS	R	df	Sig.
FA1 Komunikimi I shkollës	1.7956	.80670	1.7571	.773841	-.009	2	.886
FA2 Cilësia e arritjeve shkollore	2.1136	.82660	2.21230	.77583	.030	2	.593

FA3 Kujdesi ndaj nxënësve	1.8391	.65795	1.8013	.82000	.010	2	.866
FA4 Zhvillimi i shkathtësive jetësore	1.4385	.70722	1.3754	.63228	-.088	2	.119
FA5 Etika	2.1388	.79534	2.1420	.76434	-.087	2	.122
FA6 Dobitë e ndërveprimit të edukimit formal dhe joformal	2.1483	.83065	2.2713	.77269	-.042	2	.459

Rezultatet nga analiza cilësore e të dhënave të përfituara nga përfaqësuesit e shoqërisë civile

4.2 Rezultatet e analizës cilësore

Për mbledhjen e të dhënave të dëshiruara, përveç metodës sasore u përdor edhe metoda cilësore nëpërmjet intervistës gjysmë të strukturuar me drejtues të institucioneve joformale. Intervista gjysmë e strukturuar përmbante pyetje thelbësore që kishin të bënin me rolin e arsimit joformal në shoqërinë e sotme, programet edukative që ofrohen në qendrat apo institucionet joformale, mbi zbatimin e metodave joformale në ato formale, ndërthurjen e edukimit joformal dhe formal, mundësinë e trajtimit të elementeve joformale në ato formale, rreth interesimit të kuadrit arsimor për rëndësinë e trajnimeve në zhvillimin e tyre profesional. Gjithashtu pjesë e intervistës ishte edhe bashkëstudimi në mes dy sistemeve të arsimit dhe hapat e mëtejshëm të cilat duhet ndërmerren që qëndrimi mbi arsimin joformal të ndryshojë, si dhe mënyrat e mundshme të inkorporimit të elementeve të edukimit joformal në atë formal dhe ngritja e vetëdijës për një zbatim më të mirë të edukimit

joformal në atë formal. Të gjitha intervistat u shqyrtuan dhe u bë përmbledhja dhe analiza e të gjitha përgjigjeve.

Bashkëstudimi institucional

Bashkëstudimi ndërmjet institucioneve formale dhe joformale është një aspekt i rëndësishëm në edukimin e nxënësve të shkollave të mesme dhe përgatitjen e tyre për jetën. Në përgjithësi drejtuesit e institucioneve joformale të dy gjinive të cilët u intervistuan në lidhje me bashkëpunimin e shkollës dhe institucioneve joformale u shprehën se ekziston një bashkëpunim ndërmjet institucioneve të dy formave të edukimit, i cilishihet në sferën e aftësimin profesional, organizim dhe realizim të trajnimeve për mësimdhënës, aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta dhe fushatave vetëdijësuese dhe promovuese.

Mirëpo, drejtuesit e institucioneve të gjinisë femrore 36.36 % kishin rezervat e tyre në lidhje me bashkëpunimin institucional, sepse ato mendojnë se bashkëpuniminë mes institucioneve duhet të jetë i vazhdueshëm e jo bashkëpunimi të ndodhë rrallë. Përfaqësues të shoqërisë civile të gjinisë femrore janë shprehur se një bashkëpunim i mirfilltë nuk ekziston, por megjithatë ka lëvizje në këtë drejtim.

Njëra nga drejtueset theksoi se: *“Kemi pasur një projekt të përbashkët ku kanë marrë pjesë nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit në disa shkolla” Edukimi publik mbi dhunën në shkolla” ku nxënësit kanë përfituar shumë sepse është rritur bashkëpunimi në mes nxënësve, kanë fituar shkathtësi të nevojshme për të kontrolluar sjelljet e tyre .*

Drejtuesit e intervistaur të institucioneve joformale të gjinisë mashkullore mbi bashkëpunimin institucional kishin qëndrime më pozitive dhe mendonin se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve joformale dhe formale ekziston.

Drejtuesit e institucioneve joformale të cilët kishin eksperiencë pune më të gjatë në këtë sektor u shprehen se bashkëpunimi shkollave dhe institucioneve joformale vërehet sidomos në ofrimin e programeve trajnuese për mësimdhënës. *“Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve formale dhe joformale ekziston sidomos në implementimin e trajnimeve të*

ndryshme që janë ofruar në bashkëpunim me MASHT-in për mësimdhënësit në drejtim të zhvillimit profesional të tyre” (Drejtues i Qendrës Kosovare për Bashkëpunim ndërkombëtarë-10 vite eksperiencë pune).

Gjithashtu edhe drejtuesit e institucioneve joformale të Preshevës janë shprehur se bashkëpunimi i shkollave dhe institucioneve joformale është duke u fuqizuar dita ditës edhe pse ky bashkëpunim varet në masë të madhe nga projektet të cilat i fitojnë nga institucionet e larta të Serbisë. Mbështetur në opinionet e drejtuesve të institucioneve joformale mbi bashkëpunimin e shkollave dhe institucioneve joformale, mund të përfundojmë se drejtuesit e institucioneve joformale të gjinisë mashkullore kanë qëndrime më pozitive përsa i përket bashkëpunimit të dy sektorëve të arsimit.

“Kemi pasur bashkëpunim me rastin e ofrimeve të trajnimeve nga qendra jonë për mësimdhënësit e shkollave ku kemi pasur një pjesëmarrje të mësimdhënësve në këto trajnime, disa aktivitete që kemi zhvilluar në shkolla me nxënës “ (Drejtues i Qendrës për Arsim , Preshevë-3 vite eksperiencë pune).

Në lidhje me efikasitetin e lidhjes në mes shkollës dhe institucioneve joformale të gjithë të intervistuarit u shprehen gati në të njëjtën mënyrë se lidhja e shkollës me institucionet joformale do të mund të bëhej më efikase duke organizuar takime të përbashkëta, në përpilim të programeve të përbashkëta, në shkëmbim të përvojave, në realizim të aktiviteteve të përbashkëta, në trajnim të vazhdueshëm të mësimdhënësve, etj.

Një nga drejtuesit e gjinisë mashkullore u shpreh se *“ një lidhje efikase do të mund të krijohej nëse mësimdhënësit e shkollave do të frekuentonin në mënyrë efikase agjencitë, të marrin pjesë në punët që organizohen nga institucionet joformale, kështu ata do të mund të fitonin shumë, në drejtim të arritjes së shkathtësive praktike, të cilat do të mund të barteshin në shkolla”*.

Gjithashtu një drejtuese e intervistuar e gjinisë femrore theksoi se *“ që të kemi një bashkëpunim të mirfilltë në mes këtyre dy institucioneve të edukimit duhet që në shkolla tu*

krijohet një hapësirë e veçantë për përfaqësues të institucioneve joformale në mënyrë që të veprojnë së bashku.”

Gjithashtu edhe drejtuesit e intervistuar nga Presheva kishin mendime të njëjta se që të kemi një lidhje efikase në mes dy sektorëve të edukimit duhet që të dy sektorët të përpilojnë plane dhe programe të përbashkëta, të ketë një senzibilizim më të madh mbi edukimin joformal, të organizohen më shumë aktivitete jashtëmësimore dhe projekte të përbashkëta.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të dy gjinive kishin mendime të njëjta se një bashkëpunim i mirëfilltë në mes institucioneve joformale dhe shkollave në shkëmbim të përvojave praktike do të ndikonte direkt në arritje të kompetencave profesionale dhe individuale tek nxënësit e shkollave të mesme p.sh.*nxënësit fitojnë aftësi dhe shkathtësi të ndryshme, marrin njohuri të cilat i shfrytëzojnë në jetën e përditshme, formohen si individë dhe profesionalisht kështu janë të përgatitur për jetën e tyre.*

Motivimi

Një aspekt tjetër tejet i rëndësishëm që është parashtruar kishte të bënte me motivimin e të rinjve në këtë sektor. Të gjithë të intervistuarit kishin qëndrime gati se të njëjta se organizatat e tyre ndihmojnë të rinjve që të shprehin idetë e tyre, si dhe potencialin që posedojnë të mund ta shfrytëzojnë në çdo aspekt të jetës. Gjithashtu ata theksojnë se qendrat e tyre u krijojnë hapësirë të rinjve që të përfshihen në projekte të përbashkëta, nxitin motivimin e të rinjve për punë vullnetare, mbështesin dhe nxitin të rinjtë të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme, kështu ata motivohen më shumë dhe krijohet një atmosferë shoqëruese.

Një drejtuese e një qendre të gjuhëve të huaja në Gjilan thekson se: *“Rëndësia e kësaj qendre qëndron në insistimin e pjesëmarrësve në punë individuale, grupore dhe ekipore. Në këtë qendër të rinjtë arrijnë njohuri të nevojshme për jetën, mësojnë gjuhë të reja dhe përvetësojnë gjuhët të cilët i mësojnë edhe në shkollë, janë më të motivuar për mësim. Këtu të rinjtë arrijnë kompetencat kryesore të komunikimit në gjuhë të huaja”.*

Vlerat qytetare

Kur është fjala për punën e bërë në arritjet e vlerave qytetare të pjesmarrësve në këto institucione aktorët e shoqërisë civile të dy gjinive janë shprehur se institucionet ku ata veprojnë luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave qytetare. Kështu dy koordinatorë të gjinisë femërore theksojnë se : *“Qendra jonë krijon hapësirë për përfshirjen e të gjithë komuniteteve dhe grupmohave të ndryshme duke ofruar programe që kanë të bëjnë me promovimin e kulturave dhe vlerave demokratike, në ndërtimin e paqes, tolerancës dhe programet kundër dhunës.”* (drejtuese e Qendrës Rinore në Gjilan).

“Qendra jon luan një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e komunitetit mbi rëndësinë e mbrojtjes së ambientit, punon në vetëdijësimin e qytetarëve, nxënësve dhe mësime dhënëseve mbi reduktimin e mbeturinave dhe zhvillon aktivitete mjedisore të përbashkëta me nxënësit dhe mësime dhënësit e shkollave” (koordinatorë e OJQ-Green Art Center).

Zhvillimi individual dhe social

Institucionet joformale nëpërmjet programeve dhe aktiviteteve të ndryshme që ofrojnë për të gjithë grupmoshat e ndryshme janë një mundësi e mirë që të gjithë të zhvillohen edhe në aspektin individual edhe në atë social. Të intervistuarit e dy gjinive mendojnë se nëpërmjet edukimit joformal të gjithë individët e sidomos të rinjtë aftësohen në mënyrë individuale dhe sociale e kjo është një aspekt shumë i rëndësishëm i përgatitjes për jetën. Një drejtues i gjinisë femërore u shpreh *“tek të rinjtë mundësohet ngritja e kapaciteteve, krijohet një rrjet social në mes të nacionaliteteve të ndryshme, aftësohen për të përpiluar dhe realizuar projekte ”.*

Edhe përfaqësues të shoqërisë civile të gjinisë mashkullore janë dakord me mendimin se këto institucione mundësojnë që të rinjtë të zhvillohen në të gjitha aspektet. *“Organizatë për edukim nga teknologjia informative dhe gjuhëve ofron trajnime dhe aftësim në fushën e teknologjisë informative dhe të gjuhës angleze, ku të rinjtë por edhe të grupmohave të ndryshme aftësohen dhe përfitojnë njohuri të nevojshme për gjatë gjithë jetës”* (Info Tech Academy-11 vite përvoj pune).

Roli i edukimit joformal

Për sa i përket rolit të edukimit joformal në shoqërinë e globalizimit përfaqësuesit e shoqërisë civile me eksperiencë pune më të gjatë në këtë sektorë, rolin e edukimit joformal e përshkruajnë si tejet ndikues në përgatitjen e të rinjve për punë, në aftësimin dhe zhvillimin e tyre profesional, të rinjtë përfitojnë njohuri, përvoja të reja dhe aftësi të ndryshme që shpesh i aplikojnë në jetën e përditshme. “ *Edukimi jo formal luan një rol të rëndësishëm përgatitor dhe aftësues në shoqërinë e sotme. Nëpërmjet këtij edukimi të rinjtë kanë një qasje kreative dhe inovative. Ata arrijnë të përfshihen në trajnime, në realizimin e projekteve të ndryshme ku aftësohen dhe përfitojnë përvoja të ndryshme kështu që përmirësojnë shkathtësitë e tyre dhe janë të aftë për punë*” (drejtues i Qendrës Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtarë- me eksperiencë pune prej 10 vitesh).

Ndërthurja e edukimit formal dhe joformal

Në analizën e mëtejme të të dhënave cilësore në këtë studim jemi munduar të marrim opinionet e aktorëve të shoqërisë civile mbi ndërthurjen e edukimit joformal në atë formal. Në bazë të rezultateve mund të themi se përfaqësuesit e shoqërisë civile edhe te gjinisë femrore edhe të gjinisë mashkullore ndërthurjen e dy formave të edukimit e shohin në realizim të projekteve të përbashkëta, trajnimet e ndryshme për mësimdhënës si dhe seminare të ndryshme si për nxënës ashtu edhe për mësimdhënës, shkëmbim të përvojave, fushatave vetëdijësuese, në punën e përbashkët të dy sektorëve, në përpilimin e programeve dhe planeve të përbashkëta dhe organizim të aktiviteteve.

“Përfshirjen e edukimit jo formal në atë formal ne e shohim në shkëmbim të përvojave, në realizim të projekteve të përbashkëta, fushatave vetëdijësuese, ku nxënësit do të japin kontributin e tyre, kështu që tek ata do të rritet ndjenja e vetëbesimit dhe interesimi i tyre do të rritej më shumë”(kordinatore e gjinisë femrore).

“Sipas meje ndërthurjen në mes këtyre dy sistemeve e shoh në punën e përbashkët të këtyre dy sektorëve, në përpilimin e planeve dhe programeve të përbashkëta, organizimin e aktiviteteve” (koordinator i gjinisë mashkullore).

“Ndërthurja e edukimit formal dhe joformal mund të realizohet duke krijuar një partneritet në mes shkollës dhe organizatave që ofrojnë edukim joformal, organizim të seminareve me një qasje të përbashkët ku do të kishte për qëllim sensibilizimin e rëndësisë së arsimit joformal, pastaj organizimi i konferencave me tema rreth arsimit joformal ku pjesëmarrës do të ishin aktorë relevant të shkollave të vendeve të ndryshme ku do të mund të shkëmbejnë përvoja të ndryshme në këtë aspekt “(koordinatori pranë qendrës për të Rinjtë-Preshevë).

Një aspekt tjetër që u parashtrua kishte të bënte në aspektin global mbi ndikimin e aktiviteteve të organizatave ndërkombëtare në ngritjen e shkallës së zbatimit të edukimit joformal në institucionet arsimore.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile të gjinisë mashkullore kanë patur qëndrime më pak pozitive se sa të gjinisë femrore të cilët ishin më optimiste në qëndrimet e tyre.

Ja si u shprehën të intervistuarit e gjinisë mashkullore:

“Aktivitete që janë zhvilluar nga këto organizata sipas mendimit tim nuk kanë ndikuar mjaftueshëm, gjithashtu institucionet e larta nuk kanë punuar sa duhet në këtë drejtim. Jo edhe aq sepse interesimi i institucioneve të larta nuk ka qenë i madh për të ngritur shkallën e zbatimit të këtij sektori nëpër shkolla “.

Të intervistuarit e gjinisë femrore:

“Unë mendoj se kanë ndikuar, por mënyra e ofrimit dhe zbatimit të aktiviteteve nga ana e organizatorëve dhe mënyra e përzgjedhjes së pjesëmarrësve ka qenë shkaku që të mos ket ndikuar sa duhet.”

Përfaqësuesit e shoqërisë civile mendojnë se hap i rëndësishëm që duhet ndërmarrë që qëndrimi mbi arsimin joformal të ndryshojë është forcimi i një bashkëpunimi i mirfillt në mesmes dy sektorëve të arsimit e iniciuar nga institucionet e larta, informim më i mirë, në përpilimin e programeve të përbashkëta.

Të intervistuarit e gjinisë femrore

“Të hartohen programe të përbashkëta që të realizojnë aktivitete të ndryshme në mes dy palëve. Një informim ma i mirë, bashkëpunim dhe krijim i një besimi të ndërsjelltë. Më shumë promovim të vlerave të këtij edukimi “.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile mendojnë se mënyra më e mirë që elementet e edukimit joformal në të ardhmen të inkorporohen në rrjedhat e arsimit formal dhe të ngrihet vetëdija mbi arsimin në të mirë të zbatimit të arsimit joformal është që të bëhen takime më të shpeshta, të informohet i tërë komuniteti mbi përfitimet që sjellë ky sektor, të realizohen projekte të përbashkëta, duke shkëmbyer përvoja me vende të ndryshme të zhvilluara.

“Mënyra më e mirë është të bëhen takime të përbashkëta në mes institucioneve formale dhe jo formale, të ketë oferta të shumta nga institucionet jo formale për nxënësit në realizim të projekteve dhe fushatave vetëdijësuese, kështu që do të ngrihet vetëdija e të gjithëve për një ndërthurje në mes këtyre dy institucioneve” (koordinatorë i Zyrës për të Rinjët-Preshevë)

Të intervistuarit e gjinisë femrore

“Duke hartuar plane të përbashkëta dhe realizuar aktivitete,projekte dhe duke i dhënë rëndësi të madhe informimit” (OJQ-Aponia). “Përfshirja e elementeve të arsimit joformal në atë formal mund të bëhet në atë mënyrë që të organizohen konferenca,takime, në të cilat do të diskutohet rreth rëndësisë së arsimit joformal dhe lidhjen e tij me arsimin formal,ilat do të ishin përfitimet nga kjo ndërthurje. Pastaj,seminaret,trajnimet dhe projektet e ndryshme që organizohen,nga këto ka shumë përfitime si shkathtësitë për punë të pavarur, punë ekipore, pjesëmarrje aktive,kreativitet,të gjitha këto do të mund të zbatohen në shkolla dhe tek nxënësit do të nxitnin një interesim më të madh dhe nxënësit do të motivohen më shumë” (Qendra Rinore Gjilan).

Ndërthurja e edukimit joformal në atë formal

Koordinatorët e qendrave të cilët ofrojnë edukim jo formal ndërthurjen e këtyre dy llojeve të edukimit e shohin në realizim të projekteve të përbashkëta, trajnimet e ndryshme për mësimdhënës si dhe seminare të ndryshme si për nxënës ashtu edhe për mësimdhënës,

shkëmbim të përvojave, fushatave vetëdijësuese, në punën e përbashkët të dy sektorëve, në përpilimin e programeve dhe planeve të përbashkëta dhe organizim të aktiviteteve.

“Ndërthurjen e edukimit jo formal në atë formal e shohim në realizim të projekteve të përbashkëta, trajnimet e ndryshme për mësimdhënës si dhe seminare të ndryshme si për nxënës ashtu edhe për mësimdhënës “(Koordinator i Qendrës për Arsim-Preshevë).

“Përfshirjen e edukimit jo formal në atë formal ne e shohim në shkëmbim të përvojave, në realizim të projekteve të përbashkëta, fushatave vetëdijësuese, ku nxënësit do të japin kontributin e tyre, kështu që tek ata do të rritet ndjenja e vetëbesimit dhe interesimi i tyre do të rritej më shumë”(koordinatore e Qendrës së gjuhëve të huaja).

“Ndërthurja e edukimit formal dhe joformal mund të realizohet duke krijuar një partneritet në mes shkollës dhe organizatave që ofrojnë edukim joformal, organizim të seminareve me një qasje të përbashkët ku do të kishte për qëllim sensibilizimin e rëndësisë së arsimit joformal, pastaj organizimi i konferencave me tema rreth arsimit joformal ku pjesëmarrës do të ishin aktorë relevant të shkollave të vendeve të ndryshme ku do të mund të shkëmbejnë përvoja të ndryshme në këtë aspekt”(koordinatorë i Zyrës për të Rinjtë).

Në përgjithësi mund të themi se përfaqësuesit e shoqërisë civile në lidhje me bashkëpunimin institucional janë të mendimit se ekziston bashkëpunim në mes shkollave dhe institucioneve joformale, mirëpo ky bashkëpunim duhet që më tej të fuqizohet. Po ashtu në lidhje me rolin e edukimit joformal përfaqësuesit e shoqërisë civile mendojnë se edukimi joformal luan një rol të veçantë në edukimin e të rinjve dhe përgatitjen e tyre për jetën. Ndërveprimin e dy formave të edukimit aktorët e edukimit joformal e shohin në përpilimin e programeve të përbashkëta të dy sektorëve të arsimit, në një informim më të mirë të komunitetit mbi rëndësinë e edukimit joformal dhe ndërveprimin e këtij edukimi me edukimin formal. Të gjithë aktorët e shoqërisë civile janë të vetëdijshëm mbi efektin e konsiderueshëm që ka ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal në përgatitjen e të rinjve.

Për aktorët e shoqërisë civile arsimit jo-formal luan një rol të madh në edukimin e grupmoshave të ndryshme e sidomos të rinjve në përfitimin e shkathtësive dhe aftësive të cilat janë prioritare për t'u përgatitur për punë. Kjo ka përkruar me ngritjen cilësore të nxënësve dhe mësuesve.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile u shprehën se takime mbi rëndësinë e përfshirjes së edukimit joformal në atë formal nuk ka patur, por takime të tjera ka patur psh. në mes institucioneve joformale të cilat kanë qenë të akredituara nga MASHT-i dhe institucioneve arsimore për trajnime të mësimdhënësve, pastaj për mbajtjen e ndonjë debati në shkollë nga ana e institucioneve joformale me tema me interes të veçantë për nxënësit, etj.

“Ka pasur takime të ndryshme me bartësit e institucioneve arsimore në nivel vendi dhe ato komunale dhe janë diskutuar rreth programeve trajnuese dhe rëndësisë së tyre për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave, të cilat janë të akredituara nga MASHT_i dhe çdo pjesëmarrësi i lëshohet certifikata të nënshkruara nga MASHT_i” (Koordinatorë i Qendrës Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtarë).

Si përfundim vlen të theksohet se përfaqësuesit e shoqërisë civile vlerësojnë lart rolin e institucioneve të tyre në aftësimin, zhvillimin individual dhe social të rinjve dhe në përfitimin e shkathtësive të nevojshme për përgatitjen e të rinjve për jetën.

KAPITULLI V - DISKUTIME

Në këtë kapitull paraqiten diskutimet, gjetjet dhe interpretimet në lidhje me të dhënat e dalë nga studimi në bazë të pyetjeve kërkimore të parashtruara në këtë studim.

5.1. Diskutimete studimit në lidhje me dallimet statistikore të qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve në varësi të variablave të varur.

Niveli i lartë i besueshmërisë në korrelacionin midis edukimit komplementar- variablit të pavarur dhe variablave të varur përbën një kusht bazë edhe për analizën inferenciale për ta përgjithësuar, duke e shtrirë këtë dukuri edhe në shkollat e mesme të Kosovës. Në mënyrë më konkrete rezulton se: Trajtimi komplementar i edukimit ka një ndikim efikas në përgatitjen e nxënësve të shkollës së mesme për jetën. Programet, veprimtaritë e përbashkëta rrisin aftësitë dhe kompetencat e nxënësve për jetën në kushtet e globalizimit. Kovaçević (2012) thekson se “elementet e rëndësishme të arsimit joformal inkorporohen në vet sistemin e arsimit formal dhe me këtë e forcojnë dhe plotësojnë atë”(fq.331).

Trajtimi komplementar i edukimit i shërben jo vetëm përgatitjes së nxënësit të shkollës së mesme për jetën, por ka edhe një ndikim të ndjeshëm në rritjen e cilësisë akademike në shkollë. Kjo sepse nxënësi e kupton më mirë rëndësinë e të mësuarit për dije, ku rolin bazë në këtë proces e ka shkolla. Efikasiteti i edukimit komplementar është efikas në rrafshin individual të nxënësit. Kjo sepse nxënësi në këtë moshë kupton më mirë problematikën individuale dhe përgatitet në shkollë dhe jashtë saj për të qenë sfidant në jetë, duke shprehur individualitetin, personalitetin dhe karakterin e tij.

Efikasiteti i edukimit komplementar ka një rol të rëndësishëm edhe në përshtatjen e individit me mjedisin social kudo që ndodhet, si në mjediset e shkollës, në familje, në jetën komunitare, administrative, politike, etj. Trajtimi komplementar i edukimit i shërben edhe përgatitjes së nxënësit për tregun e punës. Nxënësi i shkollës së mesme merr kulturën e nevojshme për të konkurruar në kushtet aktuale të hapësirave që krijon tregu i punës.

Gjetjet e studimit tregojnë se ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në të gjithë variablat në qëndrimet e nxënësve, mësimeve dhe prindërve të dy vendeve. Krahasimi i të dhënave të dalë nga vlerësimet e nxënësve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar në rrafshin formal dhe joformal në gjashtë variablat përkatës tregojnë se nxënësit e dy vendeve kanë qëndrime pozitive, pra vlerësojnë lart trajtimin komplementar të dy formave të edukimit.

Megjithatë, në të gjitha variablat e matura ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore, mirëpo këto dallime nuk janë shumë të theksuara. Kështu dallim më i theksuar vërehet tek variablii tretë- përkrahja në mësim me vlerë 1.2284 dhe variabli i parë-bashkëstudimi institucional dhe i gjashtë- ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal me vlerë 0.8724, ndërsa më pak i theksuar tek variablii dytë- motivimi 0.0427. Një varg studiuesish në punimet e tyre kanë shpjeguar rëndësinë e bashkëstudimit institucional dhe produktin e këtij bashkëstudimi (Berger, Luckmann, 1999; Zuzevicite, 2008; Tereseviciene, 2008).

Lalić-Vučetić, (2010) motivimin e përshkruan si “orientim në arritjet e njohurive dhe shkathtësi në mësimdhënie”. Nëse shikojmë dhe analizojmë linjën e vlerave të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve për të gjitha variablat, vërejmë se dallimet janë të vogla. Kështu nxënësit e Preshevës kanë vlerësuar me vlera të shtuara të mesatareve aritmetike 0.8724, 1.2284, 0.519 dhe 0.8724 katër variablat (FA1, FA3, FA4 dhe FA6) më lart se nxënësit e shkollave të Gjilanit, ku në variablin FA2 dhe FA3 nxënësit e Gjilanit kanë vlerësuar më lart me vlerë të shtuar të mesatareve aritmetike 0.0427 dhe 0.5160. Por, shikuar në përgjithësi nxënësit e dy vendeve kanë qëndrime pozitive rreth ndërveprimi të dy formave të edukimit dhe efektit që ka kjo linjë e dy formave të edukimit në përgatitjen e nxënësve për jetën me vlera qytetare.

Konstatimi i rëndësisë statistikore e dallimeve në mes qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve dhe analiza e vlerave të mesatareve aritmetike në gjashtë variablat e varura të përcaktuara, tregon se kemi dallime në qëndrimet e nxënësve të dy vendeve, mirëpo këto dallime nuk janë aq të theksuara, megjithatë nxënësit e dy vendeve janë të vetëdijshëm se

ndërveprimi i dy formave të edukimit ka efekt të konsiderueshëm në përgatitjen e tyre për jetë.

Të dhënat e përftuara nga krahasimi i vlerësimeve të mësimdhënësve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar në rrafshin formal dhe joformal në gjashtë variablat përkatës tregojnë se mësimdhënësit e dy vendeve kanë qëndrime pozitive, pra vlerësojnë lart trajtimin komplementar të dy formave të edukimit. Prastalo (2010) thekson se: “Përftimi i njohurive dhe shkathtësive të nevojshme për jetën dhe punën arrihet nëpërmjet arsimit joformal, çka nxit zhvillimin personal, sepse me ndihmën e tij zhvillohen potencialet individuale”.

Megjithëse në të gjitha variablat e matura ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore, këto dallime nuk janë shumë të theksuara. Kështu dallim më i theksuar vërehet tek variablii parë bashkëstudimi institucional me vlerë 1.5437 dhe variabli i pestë vlerat qytetare 0.4581 ndërsa më pak i theksuar tek variabli i gjashtë ndërveprimi i edukimit formal dhe joformal 0.14.

Nëse shikojmë dhe analizojmë linjën e vlerave të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të mësimdhënësve të dy vendeve për të gjitha variablat, vërejmë se qëndrimet respektivisht vlerësimet e mësimdhënësve të dy vendeve përputhen ndërmjet tyre, çka flet se ekziston mendimi pozitiv dhe vetëdijësues i mësimdhënësve se ndërveprimi i dy formave të edukimit ka një efekt të konsiderueshëm në përgatitjen e nxënësve me vlera qytetare dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Analiza e konstatimit të rëndësisë statistikore të dallimeve të qëndrimeve të mësimdhënësve të dy vendeve në gjashtë variablat e përcaktur tregon se kemi vlerësime respektivisht qëndrime të njëjta, pra në përgjithësi mësimdhënësit e dy vendeve ndërveprimin e dy formave të edukimit e shohin në masë të madhe si të efektshëm në përgatitjen e nxënësve dhe mësimdhënësve për tu përshtatur kërkesave të shoqërisë globale të edukimit.

Gjithashtu edhe të dhënat e përftuara nga krahasimi i vlerësimeve të prindërve të nxënësve të dy vendeve në lidhje me trajtimin komplementar në rrafshin formal dhe joformal në gjashtëvariablat përkatës tregojnë se prindërit e dy vendeve kanë qëndrime pozitive, përsa i përket trajtimit komplementar të dy formave të edukimit. Hertzog (2002) thekson se:” bashkëpunimi rreth përvojave të ngjajshme, kuptimit dhe pritjeve të përbashkëta ndërton kolegjalitetin”.

Megjithëse në të gjitha variablat e matura ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore, këto dallime nuk janë shumë të theksuara. Mund të themi se dallim më të theksuar në qëndrimet e prindërve të nxënësve vërehet tek variabli i katërt me vlerë 0.698 dhe variabli i parë 0.6859 ndërsa më pak i theksuar tek variabli i tretë 0.311. Nëse shikojmë dhe analizojmë linjën e vlerave të mesatareve aritmetike të qëndrimeve të prindërve të nxënësve të dy vendeve për të gjitha variablat, vërejmë se prindërit e nxënësve të Gjilanit pajtohen, respektivisht vlerësojnë më lart se prindërit e nxënësve të Preshevës, çka flet se gjithashtu ekziston mendimi pozitiv dhe vetëdijësues i prindërve se ndërveprimi i dy formave të edukimit ka një efekt të konsiderueshëm në përgatitjen e nxënësve me vlera qytetare dhe zhvillimin profesional të mësimeve të tyre.

Analiza e konstatimit të rëndësishme statistikore të dallimeve të qëndrimeve të prindërve të nxënësve të dy vendeve në gjashtë variablat e përcaktuar tregon se prindërit e nxënësve të Gjilanit prej gjashtë variablave, katër prej tyre kanë vlerësuar më lart se prindërit e nxënësve të Preshevës. Në përgjithësi vlen të theksohet se prindërit e nxënësve dy vendeve ndërveprimin e dy formave të edukimit e shohin si të efektshëm në përgatitjen e nxënësve dhe të njëbashkëpunimi dhe krijimi të një besimi ndaj institucioneve në rrafshin formal ashtu edhe në atë joformal edhe pse kemi dallime në qëndrimet e tyre. Rezultatet e këtij studimi mbështesin studimin e Thompson (2001), i cili sugjeroi se arsimi joformal duhet të lidhet me arsimin formal për shkak të aftësisë që ka për të ndihmuar.

5.2. Diskutimet në lidhje me marrëdhënien ndërmjet variablave në vlerësimet e nxënësve, mësimit dhe prindërve të dy vendeve

Gjetjet e studimit tregojnë se ndërmjet variablave ekziston lidhje e rëndësishme statistikore të dalë nga vlerësimet e nxënësve, mësimit dhe prindërve të dy vendeve.

Krahasimi i të dhënave të dalë nga marrëdhënia ndërmjet variablave mbi trajtimin komplementar në rrafshin formal dhe joformal, të vlerësimeve të nxënësve të dy vendeve tregojnë se në të gjitha variablat e matura ekzistojnë lidhje të rëndësishme statistikore. Duke analizuar dhe krahasuar linjën e vlerave të koeficientit të korelacionit Pearson të qëndrimeve të nxënësve të dy vendeve, lidhje statistikore e rëndësishme është konstatuar në të dy vendet ndërmjet FA1 dhe FA2 në qëndrimet e nxënësve të Gjilanit dhe të Preshevës me vlera ($r = .617$, $p = .001$ dhe ($r = .658$, $p = .000$), ndërmjet variablave të FA2 dhe FA3 me vlera ($r = .450$, $p = .000$) dhe ($r = .371$, $p = .000$), pastaj ndërmjet FA3 dhe FA4 me vlera ($r = .382$, $p = .023$) dhe ($r = .372$, $p = .002$).

Lidhje e rëndësishme statistikore me vlerë negative ekziston ndërmjet FA3 dhe FA5 në qëndrimet e nxënësve të Preshevës ($r = -.550$, $p = .003$) edhe në qëndrimet e nxënësve të Gjilanit ($r = -.182$, $p = .000$) si dhe ndërmjet FA1 dhe FA4 me vlera ($r = -.243$, $p = .023$) për nxënësit e Preshevës dhe ($r = -.156$, $p = .028$) për nxënësit e Gjilanit. Gjithashtu kemi lidhje të rëndësishme statistikore me vlerë të ulët ndërmjet faktorëve FA2 dhe FA5 dhe FA1 dhe FA4.

Nëpërgjithësi mund të themi se lidhja e brendshme e të dhënave të variablave të dalë nga vlerësimet e nxënësve të dy vendeve tregonë ekziston korelacioni rëndësishëm statistikore në të gjitha variablat.

Vlerat e krahasuara të koeficientëve të korelacionit të dalë nga marrëdhënia në mes variablave mbi trajtimin komplementar në rrafshin formal dhe joformal, të vlerësimeve të mësimit dhe prindërve të dy vendeve tregojnë se në të gjitha variablat e matura ekzistojnë lidhje të rëndësishme statistikore. Duke analizuar dhe krahasuar linjën e vlerave të koeficientit të korelacionit Pearson të qëndrimeve të mësimit dhe prindërve të dy vendeve për të gjitha variablat,

mund të themi se: në qëndrimet e mësimdhënësve të dy vendeve kemi korelacion ndërmjet variablave të njëjtë.

Vlerat e përafërta të koeficientit të korelacionit tregojnë se mësimdhënësit e dy vendeve pajtohen se ndërveprimi i dy formave të edukimit në masë të madhe ndikon në zhvillimin dhe formimin profesional të mësimdhënësve.

Këtë pohim e mbështet Popović,(2010) ku thekson se “zhvillimi profesional ofron mundësi të arritjes së njohurive dhe shkathtësive me të cilat sigurohet bashkëpunimi cilësor dhe i suksesshëm”.

